



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 720 Akti

Nr. 725 Vendimi

Tiranë, më 15.12.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Etleda Çiftja	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 13.12.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Hektor Mushi**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Hektor Mushi, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Hektor Mushi është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
2. Z. Hektor Mushi, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtuar procesit të rivlerëimit, duke u shortuar në datën 15.12.2020, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Etleda Çiftja dhe Lulzim Hamitaj.
3. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 21.12.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerëimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Lulzim Hamitaj, të gjithë anëtarët të deklarojnë mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe të fillojë hetimi administrativ i thellë dhe i gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerëimit.
4. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerëimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), ish-DSIK, sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
5. Në datën 13.1.2021, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerëimit për fillimin e procesit të rivlerëimit, mbi përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektin informacion shtesë, sipas pyetësorit standard.
6. Në përgjigje, përmes postës elektronike², subjekti i rivlerëimit paraqiti në Komision dokumentet provuese lidhur me procesin e rivlerëimit dhe nuk ka deklaruar kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
7. Trupi gjykues, me vendimin e datës 15.11.2023, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerëimit Hektor Mushi, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerëimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerëimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 e 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerëimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

¹ Email, datë 13.1.2021, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerëimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

² Email datë 2.2.2021, “Re: Njoftim për fillimin e procesit të rivlerëimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

8. Në datën 15.11.2023, përmes postës elektronike³, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 e 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 30.11.2023.

9. Në datën 24.11.2023, përmes postës elektronike⁴, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni shtyrjen e afatit të dorëzimit të prapësimeve në lidhje me raportin dhe paraqitjen e provave deri në datë 11.12.2023.

10. Në përgjigje, Komisioni, përmes postës elektronike⁵, njoftoi subjektin e rivlerësimit për shtyrjen e afatit të dorëzimit të prapësimeve dhe provave brenda datës 7.12.2023.

11. Në datën 7.12.2023, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike⁶, paraqiti shpjegimet me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe dokumentacionin provues.

12. Më tej, Komisioni, me anë të postës elektronike⁷, njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore, lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 13.12.2023, ora 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

13. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Hektor Mushi, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

14. Në datën 13.12.2023 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit, shoqëruar nga av. E. K., me nr. licence ***, me deklaram në seancë, si dhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht.

15. Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

16. Z. Hektor Mushi dhe përfaqësuesi i tij ligjor, z. E. K., pasi dëgjuan relacionin, shprehën qëndrimin e tyre, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj subjektit.

17. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 13.12.2023, subjekti i rivlerësimit Hektor Mushi kërkoi konfirmimin në detyrë.

³ Email datë 15.11.2023, "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit administrativ kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit".

⁴ Email datë 24.11.2024, "Kërkesë".

⁵ Email datë 24.11.2023.

⁶ Email datë 7.12.2023, "Relacion shpjegues të subjektit të rivlerësimit Hektor Mushi".

⁷ Email datë 11.12.2023, "Ftesë për t'u paraqitur në seancën dëgjimore për procesin tuaj të rivlerësimit".

18. Seanca dëgjimore e datës 13.12.2023 u ndërpre, për të rifilluar në datën 15.12.2023, me shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Subjekti i rivlerësimit Hektor Mushi ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

21. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; (iii) KLP-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistem objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

22. Referuar vendimit nr. 2/2017⁸ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

23. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Hektor Mushi, i cili është bërë subjekt deklarues në këtë institucion në vitin 2003 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

⁸ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

24. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë për periudhën 2003 – 2016 dhe në datën 31.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* 2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se: (i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

25. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit e, në vijim, shpjegimet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

26. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Apartament banimi me sipërfaqe 92,3 m², me vlerë 2.000.000 lekë, në Pogradec

1.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Apartament banimi me vërtetim pronësie të ZVRPP-së Pogradec, në emër të Hektor A. Mushi, me sip. 92,3 m². Adresa: Lagjja Nr. ***, rr. “***”, kat i 6-të banimi (pa ashensor), Pogradec, z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***. Kontratë shitblerjeje datë 29.10.2004, nr. *** rep., nr. *** kol. me vlerë 2.000.000 lekë. Zotëroj 100%*”. Si burim të krijimit ka deklaruar: “*Një pjesë të dhuruara nga vëllai im A. (M.) P., të fituara nga puna e tij si emigrant në atë kohë në Gjermani dhe dhurata nga familjarët e mi, miq, të ftuar dhe familjarët e bashkëjetueses time. Këto dhurata në para më janë dhuruar me rastin e ceremonisë së martesës me bashkëjetuesen time I. B., zhvilluar në datën 21.12.2003. Gjithsej, në total 1.500.000 lekë. Pjesa tjetër prej 500.000 lekësh e pjesës së mbetur të çmimit të blerjes së banesës janë plotësuar nga kursimet e mia prej pagës si prokuror në atë kohë në Prokurorinë e Rrethit Pogradec (tri fatura të paguara nga im vëlla në emër të tij A. M. për blerjen e kësaj banese janë dorëzuar gjatë kontrollit periodik të pasurisë pranë*

ILDKPKI-së dhe ndodhen në dosjen time personale pranë këtij institucioni). Për vërtetimin e deklaramëve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁹.

1.2. Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament banimi me sip. 92,3 m², vlera 2.000.000 lekë, me pjesë takuese 100%, datë krijimi 2.11.2004. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003.

1.3. Në procesverbalin e datës 28.7.2011 të ILDKPKI-së¹⁰, subjektit të rivlerësimit i është bërë e ditur se në vitin 2004 asetet nuk mbulohen plotësisht me të ardhurat, duke rezultuar një mosmbulim në masën 1.109.506 lekë. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Burimet financiare për blerjen e këtij apartamenti janë siguruar nga të ardhurat e mia të mbledhura në formën e dhuratës martesore në raport 1/3 e vlerës dhe 2/3 është paguar nga vëllai im A. M., i cili aktualisht banon në Gjermani, dhe për vërtetimin e këtij fakti pranë firmës së ndërtimit “****” sh.p.k., me administrator M. H., janë të gjitha faturat e pagesës të kryera për blerjen e këtij apartamenti... të cilat janë dorëzuar në kontrollin paraardhës pranë ILDKPKI-së”*.

1.4. Në dokumentacionin e dorëzuar në ILDKPKI konstatohen 3 mandatarëketime të lëshuara nga shoqëria “****” sh.p.k., ku në cilësinë e kryellogaritarit ka nënshkruar shtetasi F. H.. Sipas mandatarëketimeve rezulton se shtetasi A. M. ka kryer këto arkëtime: (i) shuma 500.000 lekë sipas mandatarëkëtimimit nr. ***, datë 26.3.2003; (ii) shuma 500.000 lekë sipas mandatarëkëtimimit nr. ***, datë 27.5.2003; (iii) shuma 500.000 lekë sipas mandatarëkëtimimit nr. ***, datë 21.1.2004. Në këto mandate mungon nënshkrimi i personit që ka kryer derdhjen e shumave.

1.5. Në përgjigje të pyetësorit standard¹¹, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“[...] kam marrë dhuratë nga vëllai im A. P. (M.) vlerën prej 1.500.000 lekësh për blerjen e banesës... me adresë rruga “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, Pogradec. Kjo pronë është paguar nga vëllai im në tri këste... dhurata është bërë në fillim të vitit 2004, pas ceremonisë martesore me bashkëjetuesen I. B.... Burimi i kësaj dhurate janë të ardhurat nga kursimet e tim vëllai nga punësimi në Gjermani. Konkretisht, të ardhurat nga puna e tij korrik 1995 – 2003, taverna “****”, ***, Gjermani [...]”*.

1.6. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* 2017, administruar edhe nga ish-ZQRPP-ja¹², rezulton se ndërmjet shtetasit F. H., në cilësinë e shitësit, dhe subjektit, në cilësinë e blerësit, është lidhur kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 29.10.2004, në të cilën pasqyrohet se shitësi ka në pronësi të tij një banesë 7-katesh plus çati të shfrytëzueshme, me nr. pasurie ***, z. k. *** dhe nga kjo banesë deklaroi se i shet blerësit apartamentin me nr. pasurie ***, kati i gjashtë, i përbërë nga dy dhoma plus kuzhinë, me sipërfaqe të shfrytëzueshme 92,3 m², me vlerë totale 2.000.000 lekë, vlerë e cila i është paguar shitësit para redaktimit të kontratës jashtë zyrës noteriale.

Lidhur me çmimin e shitjes së apartamentit

1.7. Komisioni verifikoi të dhënat në tregun e lirë të apartamenteve në vitin 2004¹³, nga ku rezulton se kostoja e shitjes në qytetin e Pogradecit parashikohej 43.452 lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi. Për pasojë, çmimi i apartamentit të subjektit të rivlerësimit në tregun e lirë

⁹ Certifikatë për vërtetim pronësie datë 21.4.2005; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2004.

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 26.5.2023.

¹¹ Email datë 2.2.2021.

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 5.10.2017, e ZQRPP-së, administruar nga ILDKPKI-ja.

¹³ Udhëzimi nr. 1, datë 3.4.2004, i Këshillit të Ministrave.

vlerësohet në shumën 4.010.619 lekë¹⁴. Ndërsa kostoja mesatare e ndërtimit për vitin 2004 në qytetin e Pogradecit parashikohej në shumën 29.166 lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi e, për pasojë, kostoja e ndërtimit të apartamentit të subjektit të rivlerësimit përlllogaritet në shumën 2.692.021 lekë¹⁵.

1.8. Në kushtet kur çmimi i vendosur në kontratën e shitblerjes së apartamentit është dukshëm më i ulët në krahasim me çmimet në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin e Pogradecit (çmimi i tregut është dyfish më i lartë se çmimi i pasqyruar në kontratë), e për më tepër edhe nën koston e ndërtimit, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁶, i kërkoi subjektit të shpjegojë marrëdhënien e tij me shtetasin F. H., si dhe arsyet që ky shtetas e ka shitur apartamentin nën koston e ndërtimit.

1.9. Në përgjigje¹⁷, subjekti i rivlerësimit deklaroi se apartamenti është blerë në këtë vlerë për shkak të lidhjeve miqësore dhe familjare me shitësin F. H., lidhje të cilat shitësi i ka pasur edhe me babain e tij A. M. përpara se ai të emërohej prokuror në Pogradec. Gjithashtu, shpjegon se apartamenti ndodhet në katin e 6-të dhe pallati është pa ashensor, gjë e cila ka ulur edhe vlerën e blerjes. Në vijim, deklaroi se në apartament nuk ishin kryer një pjesë e punimeve të brendshme hidraulike, dyert e brendshme dhe punimet elektrike dhe investimet për kryerjet e këtyre punimeve janë kryer në vitet në vazhdim prej tij deri në vitin 2007, ku vlera e investimit nuk kalonte vlerën e detyrueshme për deklaram për secilin vit. Më pas shpjegon se për shkak të vendndodhjes, cilësisë së ndërtimit dhe faktit që pallati është pa ashensor, ky apartament nuk po mundet të shitet prej tij. Për vërtetimin e deklarameve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur disa kontrata shitblerjeje apartamentesh, me palë shitëse shtetasin F. H., në të njëjtin pallat ku ndodhet apartamenti i subjektit.

1.10. Nga shqyrtimi i kontratave të ngjashme të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, duke marrë në konsideratë deklaramin e tij që pallati është pa ashensor, konstatohet se apartamentet me sipërfaqe të përafërt apo më të mëdha se apartamenti i subjektit dhe në katet më të ulëta janë shitur me çmime më të ulëta se apartamenti i subjektit të rivlerësimit¹⁸. Në vijim, konstatohet se për apartamentin me nr. pasurie ***, me sip. 91,6 m², kati i gjashtë, që përkon ngjitur me apartamentin e subjektit¹⁹, çmimi i shitjes pasqyrohet në vlerën 1.500.000 lekë. Gjithashtu, rezulton se pasuria njësi (dyqan) me sip. 92,5 m², në vitin 2007 është shitur për një vlerë më të vogël se apartamenti i subjektit²⁰. Sa më sipër, duket se çmimet e shitjes së apartamenteve, të pasqyruara në kontratat e shitjes së paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nuk janë në harmoni me një logjikë ekonomike në raport me çmimet e tregut dhe/ose kostot e ndërtimit për sa i përket llojit të pasurisë (apartament, njësi), vendndodhjes së tyre dhe sipërfaqes. Për pasojë, duket se deklarami i subjektit të rivlerësimit se apartamenti është blerë në vlerën 2.000.000 lekë për shkak të lidhjeve miqësore të tij me shtetasin F. H., vendndodhjes në katin e 6-të dhe në kushtet kur pallati është pa ashensor, nuk mbështetet në dokumentacionin justifikues.

¹⁴ 92,3 m² x 43.452 lekë/m².

¹⁵ 92,3 m² x 29.166 lekë/m².

¹⁶ Email datë 27.7.2023.

¹⁷ Email datë 5.9.2023.

¹⁸ Në kontratën nr. ***, datë 1.9.2004, apartament me sip. 91,7 m², kati i katërt, çmimi 1.800.000 lekë; në kontratën nr. ***, datë 3.2.2004, apartament me sip. 109,6 m², kati i tretë, çmimi 1.700.000 lekë; në kontratën e datës 21.1.2004, apartament me sip. 112 m², kati i dytë, çmimi 1.500.000 lekë.

¹⁹ Kontratë nr. ***, datë 31.3.2004.

²⁰ Kontratë nr. ***, datë 3.4.2007, njësi me sip. 92,5 m², çmimi 1.800.000 lekë.

1.11. Në rastin konkret konstatohet se: (i) çmimi i vendosur në kontratën e shitblerjes së apartamentit është dukshëm më i ulët në krahasim me çmimet në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin e Pogradecit, në vitin 2004, e për më tepër edhe nën koston e ndërtimit; (ii) çmimet e shitjes së apartamenteve të pasqyruara në kontratat e shitjes të paraqitura nga subjekti nuk janë logjike, për sa i përket llojit të pasurisë (apartament, njësi), vendndodhjes së tyre dhe sipërfaqes; (iii) deklarimi i subjektit se apartamenti është blerë në vlerën 2.000.000 lekë për shkak të lidhjeve miqësore të tij me shtetasin F. H. dhe vlera e tij është e ulët për shkak se ndodhej në katin e 6-të dhe pallati është pa ashensor, nuk mbështetet në dokumentacionin e paraqitur. Për pasojë, duket se çmimi i shitjes i pasqyruar në kontratën e shitblerjes nr. *** është joreal.

1.12. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasin F. H. dhe shoqërinë “****” sh.p.k. dhe nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ishte në kushtet e konfliktit të interesit²¹.

Lidhur me shpenzimet e kryera për punimet dhe mobilimin e apartamentit

1.13. Në përgjigje të pyetësorit standard²², subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka banuar në këtë banesë, me adresë rruga “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, Pogradec, gjatë periudhës 2004 – 2007, së bashku me bashkëjetuesen e tij. Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar adresën: “****, rr. “****, Pogradec”²³.

1.14. FSHU-ja²⁴ informon se shtetasi Hektor Mushi sipas sistemit të faturimit nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë furnizimi me energji elektrike, ndërsa UK Pogradec²⁵ informon se shtetasi Hektor Mushi është abonent me nr. kontrate ***, datë 1.7.2005.

1.15. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1²⁶, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në apartament nuk ishin kryer një pjesë e punimeve të brendshme hidraulike, dyert e brendshme dhe punimet elektrike, dhe investimet për kryerjet e këtyre punimeve janë kryer në vitet në vazhdim prej tij deri në vitin 2007, ku vlera e investimit nuk kalonte vlerën e detyrueshme për deklarim për secilin vit.

1.16. Në vijim, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 2²⁷, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të deklarojë vlerën e këtyre punimeve, si dhe vlerën e mobilimit²⁸ të këtij apartamenti. Në

²¹ Shkresa nr. *** prot., datë 2.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të JP Korçë; shkresë nr. *** prot., datë 2.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të JP Elbasan.

²² Email datë 2.2.2021.

²³ Në DIPP-të e viteve 2005, 2006 dhe 2007 ka deklaruar adresën “L. “****”, pallati ***, h. ***, ap. ***, Elbasan”, çka përkon me adresën e gjendjes civile (nga informacioni i administruar nga DPGJC-ja me shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2023, nuk rezulton që subjekti të ketë ndryshuar zyrën e gjendjes gjendjen civile).

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2021.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 1.6.2023.

²⁶ Email datë 5.9.2023.

²⁷ Email datë 12.9.2023.

²⁸ Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se shpenzimet lidhur me mobilimin dhe punimet në apartamentin në Pogradec apo edhe apartamentin në Elbasan, ku aktualisht banon me familjen e tij, janë krijuar në vazhdimësi ndër vite që nga viti 2004 e në vazhdim prej tij dhe bashkëjetueses, nga të ardhurat e pagës, duke përfshirë këtu edhe kontributin familjar të secilit prej tyre. Më tej, subjekti ka sqaruar se është i disponueshëm për kryerjen e një verifikimi fizik, duke qenë se nuk është në gjendje të bëjë vetë një vlerësim ekonomik-financiar. Subjekti theksoi se vlera e investimeve në orendi apo mobilim është modeste dhe nuk e kalon kufirin vjetor të vlerës të deklarimit të detyrueshëm vjetor sipas formularit standard të ILDKPKI-së, e më tej shpjegoi se një pjesë e pajisjeve dhe mobilieve të apartamentit ku jeton aktualisht janë transferuar nga apartamenti i mëparshëm në Pogradec.

përgjigje²⁹, subjekti i rivlerësimit deklaroi se vlera totale e punimeve, përfshirë mobilimin dhe orenditë bazike, ka qenë 750.000 lekë (250.000 lekë për secilin nga vitet 2005, 2006 dhe 2007).

1.17. Nga krahasimi i deklarimeve të mësipërme vërehet se, nga njëra anë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka filluar të banojë në këtë apartament, së bashku me bashkëjetuesen e tij që prej vitit 2004, ndërsa, nga ana tjetër, ka deklaruar se në apartament nuk ishin kryer një pjesë e punimeve të brendshme hidraulike, dyert e brendshme dhe punimet elektrike. Komisioni vëren se lloji i punimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit janë punime të domosdoshme për krijimin e kushteve minimale për banim e, për pasojë, deklarimi i tij se vlera e punimeve/mobilimit është e shtrirë gjatë periudhës 2005 – 2007 nuk duket i besueshëm.

1.18. Gjithashtu, vërehet se, nëse çmimit të parashikuar në kontratë (2.000.000 lekë) i shtohet vlera e deklaruar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1 (750.000 lekë), rezulton një total prej 2.750.000 lekësh, shumë që i për afrohet pikërisht vlerës së kostos së ndërtimit (2.692.021 lekë), vlerë me të cilën subjekti i rivlerësimit u njoh në pyetësorin nr. 1.

1.19. Për më tepër, duke marrë parasysh sipërfaqen e apartamentit, duket jashtë logjikës së tregut shpenzimi i një vlere prej vetëm 750.000 lekësh për kryerjen e punimeve të domosdoshme për ta bërë apartamentin funksional, si dhe për mobilimin e nevojshëm për jetesë.

1.20. Sa më lart, Komisioni vëren se: (i) subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për të provuar vlerën e punimeve të deklaruara nga ana e tij; (ii) deklarimi i subjektit lidhur me vlerën e shpenzuar për punimet/mobilimin dhe periudhën në të cilën janë kryer këto punime nuk është i besueshëm; (iii) çmimi i kontratës së shitjes nuk duket real; (iv) deklarimi i subjektit se apartamenti ishte i papërfunduar dhe ka kryer punimeve të domosdoshme është bërë për herë të parë në përgjigje të pyetësorit nr. 1³⁰, pasi është njohur me koston e mesatare të ndërtimit në vitin 2004, në qytetin e Pogradecit.

1.21. Për pasojë, për efekt të analizës financiare, Komisioni paraqiti në zërin “Shpenzime për punime/mobilim apartamenti Pogradec” vlerën 2.010.619 lekë, si diferencë midis vlerës mesatare të apartamentit në tregun e lirë (4.010.619 lekë) dhe çmimit të paraqitur në kontratë (2.000.000 lekë).

Lidhur me cilësinë e vëllait të subjektit/A. P. (M.) në procesin e rivlerësimit

1.22. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në përbërjen e tij familjare edhe vëllain e tij/shtetasin A. P. (M.), i cili gjithashtu figuron në certifikatën familjare të dorëzuar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting* 2017.

1.23. Më tej, rezultoi se subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* 2017 deklarin e shtetasit A. P. (M.), në cilësinë e personit të lidhur, i cili është nënshkruar nga ky shtetas, por nuk përmban asnjë të dhënë.

1.24. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur letrën sqaruese të datës 24.1.2017 të vëllait të tij A. P. (M.), në të cilën ka deklaruar se: “[...] jetoj që nga korriku 1995 pothuajse pa ndërprerje në Gjermani. Në datën 8.4.2009, Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. ***, më miratoi lënien e shtetësisë shqiptare. Unë kam që nga prilli 2009 vetëm nënshitetesi gjermane. Megjithatë që nga viti 1995 jam ndarë nga trangu familjar në Shqipëri dhe që nga viti 2009 nuk e kam shtetësinë shqiptare, emri im figuron akoma në Gjendjen Civile Elbasan si pjesë e

²⁹ Email datë 18.9.2023.

³⁰ Email datë 5.9.2023.

trungut familjar dhe akoma me shtetësi shqiptare [...]”. Për të vërtetuar deklarinimin e vëllait të tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin provues³¹.

1.25. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në deklaratën *Vetting* 2017 rezulton se me Dekretin nr. ***, datë 8.4.2009, të Presidentit të Republikës³², shtetasit A. A. M. i është lejuar lënia e shtetësisë shqiptare dhe sipas certifikatës së datës 8.8.2009 këtij shtetasi i është miratuar shtetësia gjermane në datën 19.5.2009.

1.26. Me *email*-in e datës 24.1.2017, shtetasi A. M. i është drejtuar DPGJC-së, duke e vënë në dijeni për dekretin e lënies së shtetësisë shqiptare dhe për faktin se ka 8 vjet që nuk është bërë çregjistrimi në Gjendjen Civile Elbasan. Në përgjigje, DPGJC-ja ka bërë me dije se pas komunikimit me ZGJC-në Elbasan do të procedojë sipas rregullave.

1.27. Komisioni vëren se pika 13³³ e nenit 3 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se në rrethin e personave të lidhur përfshihen ata persona që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër i përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, për periudhën e rivlerësimit.

1.28. Në rastin konkret rezulton se shtetasi A. P. (M.) figuron formalisht në certifikatën familjare të gjendjes civile të subjektit të rivlerësimit, pasi ai ligjërisht, në zbatim të nenit 23³⁴ të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, duhet të ishte çregjistruar nga regjistri kombëtar i gjendjes civile brenda 30 ditëve nga momenti i publikimit të dekretit të Presidentit të Republikës. Në këto kushte, pasqyrimi i shtetasit A. P. (M.) në certifikatën familjare të subjektit të rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit nuk tregon realitetin e përbërjes familjare të subjektit, pasi emri i shtetasit të mësipërm figuron për shkak të mosveprimit të organit përgjegjës shtetëror sipas ligjit. Për pasojë, shtetasi A. P. (M.) nuk konsiderohet si “person i lidhur” sipas parashikimeve të pikës 13 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

1.29. Më tej, nga hetimi administrativ rezulton se: (i) në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë apartament në Pogradec se një pjesë e vlerës për blerjen është dhuruar nga vëllai i tij A. P. (M.); (ii) në përgjigje të pyetësorit standard ka deklaruar se ka marrë dhuratë nga vëllai i tij A. P. (M.) vlerën prej 1.500.000 lekësh për blerjen e banesës; (iii) subjekti ka paraqitur me deklaratën *Vetting* 2017 letrën e datës 24.1.2017, të shtetasit A. P. (M.), i cili konfirmon se i ka dhuruar shumën 1.500.000 lekë në vitin 2004 për blerjen e apartamentit në Pogradec³⁵.

1.30. Sa më sipër, në kushtet kur subjekti ka deklaruar se për blerjen e apartamentit ka kontribuar vëllai i tij A. P. (M.), i cili konfirmon kontributin e tij bazuar në pikën 14 të nenit

³¹ Shkresë datë 14.4.2009 nga Presidenca e Republikës; vërtetim për ndryshimin e mbiemrit nga M. në P. (në gjuhën gjermane); korrespondencë me *email* e shtetasit A. P. me ILDKPKI-në; korrespondencë me *email* e shtetasit A. P. me DPGJC-në; pasaportë gjermane për shtetasin A. P.; certifikatë e dhënies së shtetësisë gjermane, datë 19.5.2009.

³² Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 53, datë 30.4.2009.

³³ Ligji nr. 84/2016, neni 3 parashikon: “13. “Person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit”.

³⁴ Ligji nr. 10129/2009, neni 23 parashikon: “Për shtetasit që me dekret të Presidentit të Republikës lënë shtetësinë shqiptare, DPGJC-ja u kërkon zyrave të gjendjes civile, ku shtetasit kanë vendbanimin e tyre, që brenda 30 ditëve të bëjnë çregjistrimin e tyre nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.

³⁵ “Në fund të dhjetorit 2003 apo fillim të janarit 2004 kam bërë për llogari të vëllait tim Hektor Mushi tri pagesa, secila nga 500.000 lekë, tek firma “***” sh.p.k., me pronar F. H., me qëllim blerjen e një apartamenti për vëllain në Pogradec me sip. 92 m²”.

3 dhe pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, ky shtetas konsiderohet person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe subjekti ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhuruar prej 1.500.000 lekësh.

Burimet e krijimit

i) Lidhur me shumën 1.500.000 lekë të dhuruar nga vëllai i subjektit/A. P. (M.)

1.31. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në deklaratën *Vetting* 2017 shkresën sqaruese të datës 24.1.2017 të vëllait të tij/A. P. (M.), ku ky i fundit, lidhur me burimin e shumës së dhuruar, ka deklaruar se: “*Këto para e kanë burimin kryesisht nga punësimi im me kohë të plotë në restorantin “***”, M., gjatë periudhës 1.8.1995 – 14.12.1996, si dhe punësimi nga data 20.7.1998 – 31.10.1998 tek firma “***” po në M.. Po ashtu, edhe punësime të ndryshme gjatë kohësh së studimeve në Gjermani (1998 – 2006)*”.

1.32. Komisioni vëren se për herë të parë deklarimi i dhurimit të shumës prej 1.500.000 lekësh nga ana e vëllait dhe përdorimi i kësaj shume për blerjen e apartamentit është kryer rreth 7 vite pas blerjes së pasurisë, konkretisht deklarimi i dhurimit është kryer në vitin 2011 (në procesverbalin e datës 28.7.2011 të ILDKPKI-së, në përgjigje të konstatimit që lidhej me mosbulimin e asetëve), ndërkohë që blerja e kësaj pasurie është deklaruar në vitin 2004.

1.33. Për sa i përket kryerjes së dy prej pagesave nga shtetasi A. M. që në vitin 2003, ndërkohë që sipas deklarimit dhurimi është bërë në vitin 2004, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2³⁶, shpjegon se ai ka mësuar që banesa e prenotuar në Pogradec i dhurohej nga familja pas ceremonisë së dasmës së zhvilluar në datën 21.12.2003, konkretisht në vitin 2004, dhe kjo ka qenë edhe arsyeja që ka deklaruar se shuma i është dhuruar në fillim të vitit 2004.

1.34. Për të provuar të ardhurat e vëllait A. P. (M.), subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në deklaratën *Vetting* 2017 vërtetim nga sigurimet shoqërore për këtë shtetas, për të ardhurat e realizuara gjatë periudhës 1.8.1995 – 31.12.2006³⁷.

1.35. Nga analizimi i të dhënave për periudhën 1.8.1995 – 21.1.2004³⁸, Komisioni konstatoi se të ardhurat bruto kanë qenë në shumat 68.528 DM dhe 11.992 euro, në total 47.030 euro³⁹.

1.36. Më tej, Komisioni përlllogaritit shpenzimet e jetesës, referuar të dhënave statistikore, nga ku rezultoi se për periudhën e lartpërmendur, shpenzimet e jetesës për 1 person kanë qenë në shumën 78.248 euro⁴⁰.

1.37. Sa më lart, Komisioni konstaton se të ardhurat e shtetasit A. P. (M.) nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës e, për pasojë, përjashtohet mundësia për të pasur burime të ligjshme për t’i dhuruar subjektit të rivlerësimit shumën 1.500.000 lekë.

ii) Kursime në shumën 500.000 lekë

³⁶ Email datë 18.9.2023.

³⁷ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, protokolluar me nr. ***, datë 7.9.2023, subjekti e paraqiti dokumentacion sipas formës së kërkuar ligjore, për të ardhurat e realizuara gjatë periudhës 1.8.1995 – 31.12.2022.

³⁸ Përlllogarituri deri në datën e kryerjes së pagesës së fundit, 21.1.2004.

³⁹ Në dokumentacionin e paraqitur evidentohen vetëm të ardhurat bruto dhe jo neto. Lidhur me kurset e këmbimit të përdorura për përlllogaritjen e ekuivalentit në euro, referojuni tabelës së paraqitur në aneksin nr. 1, “Analiza financiare”.

⁴⁰ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01_custom_7282795/default/table?lang=en

Në mungesë të të dhënave për vitet 2002 dhe 2003 u konsiderua mesatarja e të dhënave për vitin 2001 (viti paraardhës për të cilin disponohen të dhëna) dhe vitit 2005 (viti pasardhës për të cilin disponohen të dhëna).

1.38. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shuma 500.000 lekë ka pasur si burim kursimet e tij nga paga si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

1.39. Në kushtet që në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 29.10.2004, palët kanë deklaruar se çmimi i shitjes i është paguar shitësit para redaktimit të kontratës, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1⁴¹, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të specifikojë datën kur është kryer pagesa e vlerës së mbetur prej 500.000 lekësh, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues. Në përgjigje⁴², subjekti i rivlerësimit deklaroi se shuma e këstit të fundit prej 500.000 lekësh është likuiduar në mirëbesim jashtë zyrës noteriale në momentin e lidhjes së kontratës datë 29.10.2004.

1.40. Sa më lart, Komisioni konsideroi datën 29.10.2004, si moment të pagesës së këstit të fundit prej 500.000 lekësh.

1.41. Për sa i përket kursimeve deri në fund të vitit 2003, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash* jashtë sistemit bankar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, sipas parashikimeve të nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar⁴³.

1.42. Lidhur me të ardhurat nga paga e bashkëshortes, në përgjigje të pyetësorit nr. 2⁴⁴, subjekti paraqiti kopje të librezës së bashkëjetueses së tij dhe vërtetimin datë 15.9.2023, lëshuar nga fondacioni “****”, Pogradec. Komisioni vëren se në librezë paraqitet periudha e punësimit 1.3.2004 – 16.3.2005, në detyrën shefe personeli, pranë fondacionit “****”, çka konfirmohet edhe nga vërtetimi i paraqitur. Gjithashtu, në vërtetim konfirmohet se shtetasja I. B. ka përfituar një pagë neto prej 30.000 lekë/muaj dhe se organizata ka paguar të gjitha detyrimet shtesë të sigurimeve shoqërore dhe tatimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.43. Komisioni vëren se pagesa e detyrimeve nuk është e konfirmuar nga institucionet përkatëse. Për rrjedhojë, këto të ardhura nuk mund të vlerësohen të ardhura të ligjshme duke u përfshirë në analizën financiare, për sa kohë nuk përmbushin standardin e përcaktuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

1.44. Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2004 – 29.10.2004, duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të subjektit dhe personave të lidhur në tabelën vijuese.

Tabela nr. 1 – Analiza financiare datë 29.10.2004 (për këstin 500.000 lekë)

Përshkrimi	Vlera
Shtim/pakësim likuiditete <i>cash</i>	0
Shtim/pakësim likuiditete bankë	0
Total ndryshimi i likuiditeteve	0
Të ardhura nga pagat e subjektit ⁴⁵	954,223
Total të ardhura	954,223
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT ⁴⁶	156,440
Pagesë kësti i fundit për apartamentin në Pogradec	500,000
Total shpenzime	656,440
Balanca e fondeve (të ardhura - ndryshim likuiditete - shpenzime)	297,783

⁴¹ Email datë 27.7.2023.

⁴² Email datë 5.9.2023.

⁴³ Ku parashikohet se subjektet detyrohen të deklarojnë “vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, depozitë, bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”, dhe referuar nenit 7, pika 1 e ligjit më sipër, “në deklarinim periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë”.

⁴⁴ Email datë 18.9.2023.

⁴⁵ Në mënyrë përpjesëtimore për 10 muaj, sipas vërtetim nr. *** prot., datë 24.10.2016, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

⁴⁶ Në mënyrë përpjesëtimore për 10 muaj.

1.45. Sa më lart, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi për pagesën e këstit prej 500.000 lekësh nga kursimet e tij.

1.46. Në përfundim, analiza financiare e burimeve për blerjen e këtij apartamenti paraqitet në tabelën vijuese:

Tabela nr. 2 – Analiza financiare për apartamentin në Pogradec

Përshkrimi	Deklarime	Analiza e Komisionit
Vlera e kontratës	2,000,000	2,000,000
+ Punime gjatë vitit 2004	0 ⁴⁷	2,010,619
- Dhuratë nga vëllai	1,500,000	0
- Paguar nga subjekti	500,000	500,000
Balanca e pambuluar	0	-3,510,619

1.47. Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Personi tjetër i lidhur/A. M. nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për t'i dhuruar shumën 1.500.000 lekë subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 3.510.619 lekë për blerjen e apartamentit në Pogradec.*

1.48. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁴⁸, subjekti i rivlerësimit paraqiti pretendimet e tij, si në vijim:

1.49. *Së pari, lidhur me çmimin e apartamentit*, subjekti shpjegon se ky çmim është i përcaktuar në kontratën e shitblerjes datë 29.10.2004, në vlerën 2.000.000 lekë dhe shpjegoi se apartamenti është në katin e shtatë (kati i gjashtë teknik), objekti është pa ashensor, ndodhet në zonë urbane të qytetit të Pogradecit, e cila nuk është e preferuar. Më pas shpjegon se apartamenti është marrë në dorëzim si karabina, me procese pune të papërfunduara, si vendosja e dyerve, instalimet elektrike e hidraulike, vendosja e dritareve etj., të cilat janë kryer nga vetë ai. Këto zëra punimesh, sipas tij, zënë rreth 10-15% të kostos së ndërtimit dhe vlera e punimeve të kryera nga vetë ai është realisht më e ulët se vlera e punimeve të ngjashme që do të kryheshin nga shoqëria e ndërtimit, pasi nuk përmbajnë vlera të fryra që aplikojnë shoqëritë e ndërtimit, si fitimi, shpenzimet administrative, TVSH etj. Gjithashtu, sqaron se në përcaktimin e çmimit ka ndikuar edhe lidhja miqësore dhe familjare midis babait të tij dhe pronarit të shoqërisë së ndërtimit.

1.50. Më tej, subjekti shpjegon se dokumentacioni i marrë pranë Bashkisë Pogradec e vërteton më së miri koston e ulët të ndërtimit, ku në procesverbalin e kolaudimit të datës 29.7.2003 është përcaktuar vlera e shpenzimeve për ndërtimin e banesës 16.100.000 lekë. Nisur nga kjo kosto totale janë përlllogaritur kostoja e ndërtimit në shumën 13.529 lekë/m² dhe kostoja e shfrytëzimit në shumën 16.972 lekë/m². Bazuar në këto vlera, kostoja e apartamentit përlllogaritet në shumën 1.566.550 lekë⁴⁹. Subjekti shpjegon se në kushtet kur çmimi i shitjes është 2.000.000 lekë fitimi

⁴⁷ Subjekti ka deklaruar se vlera totale e punimeve, përfshirë mobilimin dhe orenditë bazike, ka qenë 750.000 lekë (250.000 lekë për secilin nga vitet 2005, 2006 e 2007), pra gjatë vitit 2004 nuk ka kryer punime.

⁴⁸ Email datë 7.12.2023.

⁴⁹ 92,3 m² x 16.972 lekë/m² = 1.566.550 lekë.

i shoqërisë ndërtimore është 433.449 lekë⁵⁰ ose 27,6% ndaj kostos. Për vërtetimin e deklaramëve, subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumentacionin provues⁵¹.

1.51. Kostoja mesatare e ndërtimit dhe çmimet e shitjes të cilave u referohet Komisioni mund të shërbejnë si të dhëna statistikore për entet shtetërore në planifikimin e fondeve, por nuk kanë efekte në rastet kur nuk mund të krahasojmë objekte ndërtimi me ndryshime të theksuara të parametrave e standardeve të zbatuara dhe nuk mund të merren për bazë në llogaritjen dhe krahasimin me kostot e çmimet e apartamenteve që janë shitur nga shoqëria e ndërtimit, përfundoi subjekti.

1.52. Në konkluzion, subjekti pretendoi se argumentet e mësipërme vërtetojnë se çmimi i kontratës së shitblerjes midis palëve është më se i drejtë, i logjikshëm, real dhe i dokumentar me informacionin e dhënë sa më lart.

1.53. *Së dyti, lidhur me shpenzimet e mobilimit*, subjekti i rivlerësimit shpjegon se është bërë pronar i apartamentit në datën 2.11.2004 dhe, ashtu siç ka deklaruar, në këtë apartament janë kryer punime nga vetë ai, në shumën totale 750.000 lekë, për 3 vite radhazi, e ndarë në periudhën 2005 – 2007. Më tej, ai sqaron se kontrata e furnizimit me ujë mban datën 1.7.2005, ndërsa kontratë për furnizimin me energji elektrike nuk ka. Librezat e pagesave të energjisë elektrike dhe të ujit janë në vlerat minimale, gjë që tregon konsumin minimal të këtyre furnizimeve dhe ky argument, shpjegon subjekti, e rrëzon pretendimin e pikës 1.24 të relacionit, ku pretendohet se subjekti dhe bashkëjetuesja e tij kanë banuar në këtë apartament duke filluar nga viti 2004, kur nuk kishin kushtet minimale për të jetuar, e për pasojë, deklarimi i punimeve shtesë nga subjekti është konsideruar i pabesueshëm. Gjatë periudhës 2004 e në vazhdim ka nisur dhe kryer punimet shtesë, si dhe ka realizuar një mobilim modest në kushtet e kërkesë-ofertës në qytetin e Pogradecit, vijoi subjekti.

1.54. *Së treti, lidhur me analizën financiare të vëllait/shtetasit A. M.*, në prapësimet e dërguara me anë të *email*-it, subjekti, ndër të tjera, paraqiti një dokument në formatin *word*, me emërtimin “Përgjigjja A. P.”, i cili deklaroi se atij i kërkohet nga Komisioni që të vërtetojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhuruar prej 1.500.000 lekësh ndaj vëllait në periudhën gusht 1995 – janar 2004, pra bëhet fjalë për një periudhë kohore 19-28 vjet më parë. Ai vijon të shpjegojë se shumë nga përpjekjet e tij për të siguruar një pjesë të mirë të dokumenteve dolën të pasuksesshme, për arsyen se në Gjermani, në bazë të ligjit federal për taksat dhe financat (Abgabenordn AO), neni 147, paragrafi 3, afati maksimal i ruajtjes së dokumenteve të tilla është 10 vjet⁵². Në deklaratën *Vetting* 2017 iu la një kohë shumë e shkurtër për të siguruar dokumentet e nevojshme dhe kërkoi nga Komisioni të konsiderojë pamundësi objektive për të disponuar dokumente që justifikojnë ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave, në bazë të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

1.55. Më tej, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe në deklaratën në *word* të vëllait A. P., paraqiten pretendimet vijuese lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet:

⁵⁰ Diferenca midis çmimit të shitjes 2.000.000 lekë dhe kostos së rezultuar nga përllogaritjet 1.566.550 lekë.

⁵¹ Akt vlerësimi pasurie; foto apartamenti; dokumente nga Bashkia Pogradec (leje shfrytëzimi, procesverbal kolaudimi, akt piktetimi, procesverbal mbi përfundimin e themeleve, procesverbal mbi përfundimin karabina, leje ndërtimi, formular i kërkesës për leje ndërtimi, formular i lejes së sheshit të ndërtimit dhe planimetria e sheshit, formular i kërkesës për leje sheshi ndërtimi, pjesë nga projekti teknik).

⁵² Në vijim, deklaroi se: “*Pra, ndërmarrjet dhe institucionet e ndryshme ku unë kam qenë i punësuar nuk kanë qenë të detyruara të ruajnë dokumente të tilla si kontrata pune, të ardhurat mujore e të tjera. Kjo vlen dhe për institucione të tilla si bankat. Pas mbarimit të afatit 10-vjeçar këto dokumente fshihen*”.

1.55.i *Lidhur me të ardhurat*, fillimisht është shpjeguar se mbi të ardhurat e tij (A. P.), të paraqitura nëpërmjet vërtetimit të Sigurimeve Shoqërore, nuk janë paguar sigurime shoqërore ose taksë mbi të ardhurat ose, si në rastin e viteve 1995 e 1997, taksat e mbajtura janë kthyer mbrapsht, pra shuma bruto është e barabartë me neto⁵³. Marrëdhëniet e punëve tipike për studentët gjermanë dhe të huaj janë në formën e punës *mini job*, punë ditore, asistent në universitet apo ndërmarrje të ndryshme (*workstudent*), apo punësime si kamerier, recepcionist, përkthyes në zyrat e të huajve e shumë punë të tjera dhe të ardhurat nga këto lloj punësimesh nuk figurojnë në dokumentet e sigurimit shoqëror, pasi janë të karakterit *nicht sozialversicherungspflichtig*, pra për këto të ardhura nuk paguhen taksa mbi të ardhurat apo taksa për pensionin, shpjegohet në deklaratë.

1.55.ii Në vijim, ai shpjegoi se ka përfituar të ardhura të tjera, konkretisht: (i) të ardhurat nga bakshishi gjatë punës si kamerier në tavernën “****” gjatë periudhës gusht 1995 – dhjetor 1996 (400 marka/muaj); (ii) bursë për studentët e huaj “*Ausländerstipendien*” nga Universiteti i ***, në shumën 200 euro/muaj, përgjatë kohës së studimeve pranë këtij universiteti në periudhën 6.9.2001 – 30.9.2005 (për periudhën shtator 2001 – janar 2004, 5.400 euro); (iii) punë të shumëllojshme ditore nga Agjencia e Punësimit për studentë *Job-Börse/Job Cafe* apo agjenci të tjera të ngjashme, për të cilat e ka të vështirë të bëjë një llogari të shumës së përgjithshme të përfituar; (iv) punësim si përkthyes për gjuhët anglisht, shqip dhe gjermanisht dhe *roleplayer* në Bazën Ushtarake Amerikane ***, në Kosovë, në fillim të vitit 2002 (3.500 euro); (v) punë si kamerier në “****”, për të cilat e ka të vështirë të bëjë një llogari të shumës së përgjithshme të përfituar. Në përfundim, shuma përfundimtare e të ardhurave rezulton 55.228 euro, shpjegoi subjekti.

1.56. *Për sa i përket shpenzimeve të jetesës të llogaritura për shtetasin A. M.*, duke shpjeguar se aty konstatohen pasaktësi dhe referenca të gabuara nga Komisioni, pasi statistika e përdorur në analizën financiare nuk ka asnjë lidhje me përllogaritjet e shpenzimeve të jetesës, sepse është statistikë vetëm mbi të ardhurat. Sipas subjektit të rivlerësimit, Eurostat-i ka analizuar prapë e rrezikut të varfërisë e, për pasojë, konkluzioni i Komisionit se në periudhën e lartpërmendur shpenzimet e jetesës për 1 person kanë qenë në shumën 78.248 euro, nuk qëndron.

1.56.i Referuar shpjegimeve të paraqitura, shtetasi A. M. ka mbërritur në Gjermani në gusht të vitit 1995, me një kontratë pune njëvjeçare, me të drejtë zgjatjeje përfundimtare 6-mujore, të tavernës “****”, në M., Gjermani⁵⁴. Në këtë periudhë, vijon ai, jetonte në banesën që i përkiste punëdhënësit, ushqimin e siguronte në restorant dhe mosnjohja e mirë e gjuhës, kontaktet e kufizuara sociale, një ditë pushim në javë, orët e gjata të punës, ishin faktorë favorizues për kursim, konkretisht rreth 20 mijë marka, baza kryesore për krijimin e shumës së dhuruar.

1.56.ii Në vijim, në shpjegimet e tij, subjekti pretendon se për periudhën tetor 1997 – janar 2004 duhet të merren për bazë kostot e jetës së një studenti të huaj në Gjermani, si dhe të merren parasysh nevojat dhe kërkesat e një studenti që vinte nga vendi më i varfër i Evropës. Në shpjegime kërkohet që të merret parasysh se deri në janar të vitit 2004 vëllai i subjektit ka

⁵³ Shtetasi A. P. ka shpjeguar se: “Në rastin tim forma më e thjeshtë e vërtetimit të të ardhurave ishin të dhënat e sigurimit shoqëror (*Rentenversicherung*), në të cilat regjistrohen të ardhura nga marrëdhëniet e punës, të cilat janë “*sozialversicherungspflichtig*”, pra kur punëdhënësi është i detyruar të paguajë për punëmarrësin sigurimet shoqërore. Ky detyrim varet nga sasia e të ardhurave, si dhe nga lloji i kontratës së punës”.

⁵⁴ “Leja e qëndrimit ishte e lidhur me kontratën e punës dhe me mbarimin e saj, pas 18 muajsh, në datën 4.1.1997 unë u detyrova të kthehesha në Shqipëri. Duke qenë se nuk ishte e qartë nëse do të kisha mundësi të vija prapë në Gjermani, si dhe duke pasur si qëllim kursime sa më të larta, unë mora me vete të gjitha kursimet e mia”.

banuar në konvikt studentësh në pronësi të shoqatës kristiane për të rinj “****”, me qira prej 240 marka, si dhe faktorë të tjerë, të tillë si ndarja e kostove për ushqim apo kosto të tjera me tre studentë shqiptarë që banonin në të njëjtin kat dhe me vëllain e vogël D. M., banues nga fillimi i vitit 2003 në të njëjtin konvikt, si dhe afërsia me universitetin, çka bënte të mundur të mos kishte kosto të shumta transporti.

1.56.iii Më tej, pasi paraqet referencat se ku duhet të bazohet përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës, të tilla si ligji Bafög⁵⁵ dhe studime të ndryshme⁵⁶, subjekti deklaroi se për periudhën 1.8.1995 – 21.1.2004 shpenzimet e jetesës kanë qenë 37.628 euro.

1.56.iv Gjithashtu, subjekti ka theksuar se nga ana e shtetasit A. P. (M.) është dokumentuar tërheqja e shumës 4.000 euro nga ***, në Republikën Federale Gjermane, në datën 12.1.2004, e cila ka shërbyer për të realizuar pagesën e tretë të këstit prej 500.000 lekësh për blerjen e apartamentit, nëpërmjet mandatarkëtimit nr. ***, datë 21.1.2004.

1.56.v Në prapësimet e dërguara me anë të *email*-it, subjekti, ndër të tjera, paraqiti: (i) dokument në formatin *word*, me emërtimin “Përgjigjja A. P.”; (ii) dokument në formatin *excel*, me emërtimin “Analiza financiare A. P.”; (iii) foto të lëvizjes së llogarisë në emër të shtetasit A. M., pranë ***, për periudhën 2.1.2002 – 8.2.2002; (iv) kopje e pasaportës së shtetasit A. M., lidhur me hyrje-daljet në Gjermani në vitin 1997; (v) foto të një formulari për taksat e vitit 1996 në emër të shtetasit A. M.; (vi) foto të një kontrate pune, pa nënshkrim, pa datë; (vii) foto të një kontrate pune midis shtetasit A. M. dhe tavernës “****”; (viii) korrespondencë me *email* me Ministrinë Federale të Arsimit; (ix) foto të lëvizjes së llogarisë në emër të shtetasit A. M., pranë ***, për periudhën 1.6.2006 – 13.6.2006, ku evidentohet një kreditim në shumën 124,71 euro, me përshkrimin “Job Boerse”; (x) formular në gjuhën gjermane për përlllogaritjen e taksave për vitin, në emër të shtetasit A. M.; (xi) foto të lëvizjes së llogarisë në emër të shtetasit A. M., pranë ***, për periudhën 9.12.2002 – 13.1.2003, ku evidentohet një debitim për pagesën e qirasë në shumën 121 euro; (xii) foto të lëvizjes së llogarisë në emër të shtetasit A. M., pranë ***, për datën 11.12.2003, ku në këtë datë evidentohet një tërheqje në shumën 4.000 euro; (xiii) foto të lëvizjes së llogarisë në emër të shtetasit A. M., pranë ***, për datën 31.3.2003, ku në këtë datë evidentohet një kreditim në shumën 400 euro, shumë e cila, sipas shpjegimeve, i përket bursës së përfutur nga vëllai A. M.; (xiv) vërtetim për statusin si student pranë Universitetit ***, M.; (xv) vërtetim për statusin si student pranë Universitetit ***.

1.57. Pas analizës së kryer prej tij, subjekti deklaroi se diferenca prej 17.600 euro (të ardhurat 55.228 euro minus shpenzimet 37.628 euro) justifikon kontributin prej 1.500.000 lekësh (11.223 euro) për mbulimin e vlerës së apartamentit.

1.58. Në përfundim, bazuar në të dhënat e mësipërme, konkretisht çmimi i shitjes së apartamentit, burimet e financimit të subjektit të rivlerësimit, dhurata e dhënë nga vëllai A. P. (M.), rezultoi se tabela e analizës financiare për periudhën 1.1.2004 – 31.12.2004 paraqitet me një balancë pozitive prej 171.947 lekësh, deklaroi subjekti.

1.59. Së katërti, lidhur me kursimet e subjektit në shumën 500.000 lekë, të përdorura për pagesën e këstit të fundit të apartamentit, subjekti shpjegoi se – edhe pse Komisioni ka konstatuar se subjekti disponon burime financiare të ligjshme për të krijuar këto kursime – ai disponon dokumentacion lidhur me punësimin e bashkëjetueses së tij, me qëllim përfshirjen e

⁵⁵ Ligji federal mbi ndihmën për financimin e studimeve.

⁵⁶ Të detajuara në dokumentin në *word* me emërtimin “Përgjigjja A. P.”.

këtyre të ardhurave në analizën financiare. Subjekti paraqiti: (i) vërtetim për bazën e vlerësuar, lëshuar nga DRSSH Korçë, gjatë periudhës mars 2004 – mars 2005, punëdhënës fondacioni “****”⁵⁷; (ii) vërtetim për pagën neto, lëshuar nga DRSSH Korçë, për periudhën gusht – shtator 2005, dhjetor 2005, maj 2006⁵⁸, punëdhënës ALSSH Pogradec.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.60. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton si më poshtë:

a) Lidhur me vërtetësinë e çmimit të apartamentit në kontratën e shitblerjes

1.61. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se në *përcaktimin e çmimit të shitblerjes së apartamentit ka ndikuar fakti se ka kryer shpenzime për punimet e domosdoshme dhe është marrë në dorëzim si karabina*, Komisioni vlerëson se ky pretendim është i pabazuar në fakte dhe prova, për sa vijon: *Së pari*, në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 29.10.2004, nuk pasqyrohet gjendja karabina e apartamentit apo e punimeve të papërfunduara. *Së dyti*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë se “apartamenti ishte i papërfunduar dhe ka kryer punimet e domosdoshme” në përgjigje të pyetësorit nr. 1⁵⁹, pasi është njohur me koston mesatare të ndërtimit në vitin 2004 në qytetin e Pogradecit dhe me konstatimin e Komisionit se çmimi i shitjes së apartamentit ishte nën koston e ndërtimit. *Së treti*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vlera totale e punimeve, përfshirë mobilimin dhe orenditë bazike, ka qenë 750.000 lekë (250.000 lekë për secilin nga vitet 2005, 2006 e 2007)⁶⁰, vlerë e cila, nëse i shtohet çmimit të parashikuar në kontratën e shitblerjes (2.000.000 lekë), rezulton në total 2.750.000 lekë, shumë që i përafrohet pikërisht vlerës së koston së ndërtimit (2.692.021 lekë). *Së katërti*, nga njëra anë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka filluar të banojë në këtë apartament së bashku me bashkëjetuesen e tij që prej vitit 2004⁶¹, ndërsa nga ana tjetër ka deklaruar se në apartament nuk ishin kryer një pjesë e punimeve të brendshme hidraulike, dyert e brendshme dhe punimet elektrike, punime të cilat janë domosdoshme për krijimin e kushteve minimale për banim dhe, sipas deklaratimit të tij, i ka kryer gjatë viteve 2005, 2006 e 2007. *Së fundi*, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit ka paraqitur si provë lejen e shfrytëzimit të miratuar me vendimin nr. ***, datë 1.8.2003, të KRRT-së Bashkia Pogradec, për objektin “Banesë 7 kat + çati” bashkë me procesverbalin e kolaudimit, dokumente të cilat, sipas legjislacionit të kohës⁶², vërtetojnë që objekti ka qenë plotësisht i përfunduar.

1.62. Sa më lart, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë rrethana jo të vërteta për sa i përket gjendjes së apartamentit në momentin e blerjes e, për pasojë,

⁵⁷ Bashkëlidhur *email*-it të dërguar në datën 7.12.2023.

⁵⁸ Paraqitur në seancën dëgjimore, datë 13.12.2023.

⁵⁹ *Email* datë 5.9.2023.

⁶⁰ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

⁶¹ Në përgjigje të pyetësorit standard.

⁶² Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (nenet 12 e 13).

deklarimi i tij gjatë hetimit administrativ se ka kryer punime të domosdoshme (bashkë me mobilimin) në vlerën 750.000 lekë, në periudhën 2005 – 2007, nuk është i besueshëm.

1.63. Për sa i përket shpenzimeve të deklaruara nga ana e subjektit në shumën 750.000 lekë, në kushtet që subjekti ka deklaruar se këtu përfshihen edhe shpenzimet e mobilimit, Komisioni e paraqiti këtë shumë në vitin 2004, referuar deklaramit të subjektit se ka filluar të banojë në këtë apartament pikërisht në vitin 2004 dhe faktit që subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues se apartamenti ishte në gjendjen karabina.

1.64. Sa më lart, Komisioni edhe pse konstaton se, çmimi në kontratë është më i ulët se çmimet referuese të tregut, dhe atyre të pasqyruara në kontratat e shitjes të apartamenteve në të njëjtin pallat, krahasuar me llojin e pasurisë (apartament, njësi), vendndodhjen e tyre dhe sipërfaqen, në raport me vlerën e kostos së ndërtimit dhe shfrytëzimit për m², sipas procesverbalit të kolaudit të datës 29.7.2003, e cila rezulton e ulët, dhe në mungëse të ndonjë të dhëne/fakt tjetër, nuk mund të konkludojë për deklaramit të pavërtetë të subjektit për çmimin e saj. Në këto rrethana, trupi gjykues në vlerësimin përfundimtar çmoi të vendosë në analizën financiare përfundimtare vlerën 2.000.000 lekë të pasqyruar të pasqyruar në kontratën e shitblerjes dhe shpenzimet e deklaruara nga subjekti për punime në shumën 750 000 lekë.

1.65. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në deklaramitën *Vetting 2017* iu la një kohë shumë e shkurtër për të siguruar dokumentet e nevojshme dhe ndodhet në pamundësi objektive për të disponuar dokumente që justifikojnë ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave, Komisioni arsyeton se parashikimet e pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, e detyron subjektin e rivlerësimit për t'i vërtetuar institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Në rastin konkret vërehet se *së pari*, se subjekti i rivlerësimit nuk ka cilësuar/identifikuar se cili është dokumentacioni i pamundur objektivisht për t'u paraqitur dhe *së dyti* subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni që deklaramit e tij do të duhet të shoqërohet me dokumentacion provues që në momentin kur hyri në fuqi ligji nr. 84/2016⁶³ dhe nga koha e paraqitjes së deklaramitës *Vetting 2017* e deri në datën kur është njohur me rezultatet e hetimit administrativ ka kaluar një periudhë më shumë se 5 vjet, e cila është kohë më se e mjaftueshme për të paraqitur dokumentacionin e nevojshëm. Sa më lart, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se gjendet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nuk është i bazuar.

b) Lidhur me burimin e krijimit

1.66. Për sa i përket pretendimit të subjektit për përdorimin e gabuar të të dhënave statistikore lidhur me shpenzimet e jetesës në shtetin gjerman, Komisioni thekson se kjo metodologji dhe referencat përkatëse janë bazuar në praktikën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, konkretisht në vendimet nr. 26-2021 (JR), datë 4.8.2021⁶⁴, nr. 12-2022 (JR), datë 29.4.2022⁶⁵, nr. 28-2022 (JR), datë 14.7.2022⁶⁶, nr. 15-2023 (JR), datë 13.4.2023⁶⁷ dhe nr. 32-2019 (JR),

⁶³ Ky detyrim del qartë në pikën 5 të neni Ç të Aneksit të Kushtetutës, në pikën 1 të nenit 32 dhe pikat 2 dhe 3 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, sikurse edhe udhëzimi nr. ***/2016 i Inspektorit të ILDKPKI-së për zbatim të këtyre dy akteve, të cilët përcaktojnë shprehimisht nevojën për të mbështetur çfarë deklaramit me dokumentacion.

⁶⁴ Paragrafi 20.6.

⁶⁵ Paragrafët 9.5.1.1.1.; 9.7.1.1.1.; 9.8.1.1.

⁶⁶ Paragrafi 37.

⁶⁷ Paragrafi 62.

datë 21.11.2019⁶⁸, vendime në të cilat është përdorur e njëjta bazë të dhënash statistikore dhe të njëjtat kritere⁶⁹, të cilave u është referuar Komisioni në rastin konkret.

1.67. Përdorimi i referencave të cituara nga subjekti për përlogaritjen e shpenzimeve të jetesës mund të ketë kuptim në rastin e përlogaritjes së shpenzimeve të një studenti me qëllim përballimin e shpenzimeve të jetesës. Ndërsa, në kushtet e një shtetasi që dhuron shuma të tilla, si ajo e pretenduar në rastin konkret, prezumohet që standardi i jetesës është më i lartë dhe jo në kufijtë e mbijetesës.

1.68. Në çdo rast, vetë shpjegimet e subjektit lidhur me mënyrën e jetesës së vëllait e bëjnë të vështirë besueshmërinë për ekzistencën e këtij dhurimi, pasi nga analizimi i shpjegimeve, dokumentacionit të paraqitur dhe rrethanave, vërehet se:

1.68.i Gjatë periudhës kohore të marrë në analizë, referuar deklarimeve – vëllai i subjektit/A. P. jetonte në konvikt, duke ndarë shpenzimet me studentë të tjerë dhe kryente punë të ndryshme studentore (*mini jobs*) – çka nënkupton një situatë jo të lehtë financiare.

1.68.ii Referuar shpjegimeve të paraqitura, vëllai i subjektit ka përfituar bursë gjatë studimeve të tij. Bazuar në jurisprudencën e Kolegjit⁷⁰, bursa akordohet si kuotë financiare për ushqim dhe shpenzime të tjera të vogla të studentit, të cilat hyjnë si shpenzime bazë jetese, pa përfshirë luksin. Një ndër arsyet për të cilat edhe studentët punojnë gjatë kohës në universitet, është për shkak të përballimit të shpenzimeve, për të cilat nuk është e mundur të përballohen vetëm me bursën e akorduar nga universiteti.

1.68.iii Qëllimi i dhurimit deklarohet të jetë për kryerjen e një investimi në pasuri të paluajtshme.

1.69. Pra, në këto kushte, në vlerësim të Komisionit, është e vështirë të arrihet në një përfundim që një student – i gjendur në situatën ekonomiko-sociale të përshkruar nga vetë subjekti – të mund t'i dhuronte subjektit të rivlerësimit një shumë prej 1.500.000 lekësh për të investuar në një apartament në qytetin e Pogradecit, në një kohë që subjekti i rivlerësimit ishte në marrëdhënie pune prej më shumë se 8 vitesh, më shumë se 4 prej të cilëve në detyrën e prokurorit.

1.70. Për rrjedhojë, mbetet i pandryshuar konkluzioni i Komisionit se personi tjetër i lidhur/A. M. nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për t'i dhuruar shumën 1.500.000 lekë subjektit të rivlerësimit.

1.71. Lidhur me pretendimin e subjektit për paraqitjen në analizën financiare të të ardhurave të bashkëjetueses gjatë periudhës mars 2004 – mars 2005, Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e paraqitur, pasqyroi në analizën financiare të ardhura në shumën 180.164

⁶⁸ Paragrafët 58 dhe 71.

⁶⁹ *At risk of poverty threshold (60% of median equivalised income).*

⁷⁰ Vendimi nr. 09-2018 (JR), datë 24.10.2018.

lekë në vitin 2004⁷¹, në shumën 163.258 lekë në vitin 2005⁷² dhe në shumën 31.122 lekë në vitin 2006⁷³.

1.72. Në vijim të arsytimit lidhur me paraqitjen në analizën financiare të vitit 2004, të pagave të bashkëjetueses dhe të shpenzimit prej 750.000 lekësh, balanca negative e vitit 2004 rezulton -1.612.496 lekë, si në tabelën vijuese.

Tabela nr. 3 – Analiza financiare e vitit 2004

Përshkrimi	Vlera
Apartament banimi sip. 92,3 m ² , Pogradec	2,000,000
Shtim/pakësim likuiditete <i>cash</i>	0
Shtim/pakësim likuiditete bankë	0
Total pasuri	2,000,000
Të ardhura nga pagat e subjektit	1,145,068
Të ardhura nga pagat e bashkëjetueses	180,164
Total të ardhura	1,325,232
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	187,728
Shpenzime apartamenti Pogradec	750,000
Total shpenzime	937,728
Balanca e fondeve (të ardhura-ndryshim likuiditete-shpenzime)	-1,612,496

1.73. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.612.496 lekë për blerjen e pasurisë apartament në Pogradec, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

2. Bashkëpronar në apartamentin e privatizuar në Elbasan, me pjesë 4/12

2.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Përfitues si trashëgimtar ligjor i 1/4 pjesë të pasurisë trashëgimore të luajtshme dhe të paluajtshme... e të ndjerit babait tim A. I. M. dhe përfitues nga privatizimi i banesës në vitin 1991 si fëmijë madhor... Bashkëpronar me nënën F. M. dhe vëllezërit D. e A. M.”. Si burim krijimi deklaron: “Përfitues nga privatizimi dhe trashëgimia ligjore e 4/12 pjesë të pasurisë nr. ***, apartament banimi 73 m², lagjja “***” (ndryshuar lagjja “***”) Elbasan, p. ***, hyrja ***, ap. nr. ***, zona kadastrale ***. Dëshmi trashëgimie ligjore datë 20.5.2015”. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁷⁴.

2.2. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Elbasan⁷⁵ rezulton se me kontratën e datës 13.9.1993 shtetasi A. M. ka blerë nga Ndërmarrja Komunale Banesa apartamentin nr. ***, p. ***, të përbërë nga 2+1, në lagjen “***”, në shumën 8.750 lekë. Sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme, ky apartament është regjistruar me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Elbasan⁷⁶. Gjithashtu, konstatohet se në certifikatën e gjendjes familjare të datës 20.5.1993

⁷¹ Për pagat bruto të periudhës mars – dhjetor 2004 (206.640 lekë) u përlogaritën ndalesat për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe për tatimin mbi të ardhurat sipas legjislacionit të kohës, duke rezultuar një shumë neto prej 180.164 lekësh.

⁷² Për pagat bruto të periudhës janar – mars 2005 (61.992 lekë) u përlogaritën ndalesat për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe për tatimin mbi të ardhurat sipas legjislacionit të kohës, duke rezultuar një shumë neto prej 54.049 lekësh. Kësaj vlere iu shtuan edhe shumat e pasqyruara për vitin 2005 në vërtetimin për pagën neto, lëshuar nga DRSSH Korçë, punëdhënës ALSSH Pogradec.

⁷³ Referuar shumës neto të muajit maj 2006, të paraqitur në vërtetimin për pagën neto, lëshuar nga DRSSH Korçë, punëdhënës ALSSH Pogradec.

⁷⁴ Certifikatë pronësie e pasurisë nr. ***, z. k. ***, Elbasan, datë 25.5.2015, bashkë me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë; dëshmi trashëgimie ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.5.2015.

⁷⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2021.

⁷⁶ Kjo pasuri është shitur me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 3.5.2017, në shumën 2.937.017 lekë (shkresa nr. *** prot., datë 26.5.2023, e ILDKPKI-së).

figurojnë shtetasit A. M., kryefamiljar, F. M., bashkëshortja, Hektor Mushi, i biri, A. M., i biri dhe D. M., i biri.

2.3. Ligji nr. 7652/1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” në nenin 20⁷⁷ përcaktonte se në privatizimin e banesave shtetërore merrej për bazë përbërja familjare dhe gjendja e strehimit që rezulton në regjistrat themeltarë të shtetasve në datën 1.12.1992. Në vijim, udhëzimi nr. 1/1993⁷⁸, në pikën 11 përcaktonte se banesat që do të privatizohen regjistrohen në emër të qiramarrësit dhe të pjesëtarëve të tjerë madhorë të familjes së tij dhe pjesëtar madhor quhej personi që është mbi moshën 18 vjeç.

2.4. Referuar të dhënave personale të pasqyruara në certifikatat e gjendjes civile të paraqitura nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, rezulton se subjekti në datën 1.12.1992 ishte 20 vjeç e, për pasojë, përfitonte të drejtën e privatizimit të apartamentit ku banonte me familjen.

2.5. Subjekti ka paraqitur në deklaratën *Vetting* 2017 kopje të aktit noterial nr. ***, datë 20.5.2015, “Dëshmi trashëgimie ligjore”, për të ndjerin A. M., administruar edhe nga notere A. B.⁷⁹, ku pasqyrohet se ky shtetas ka ndërruar jetë në datën 6.3.2014 dhe trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të tij janë: F. M., bashkëshortja, Hektor Mushi, i biri, A. M., i biri dhe D. M., i biri, të cilët trashëgojnë nga 1/4 pjesë të pasurisë trashëgimore.

2.6. Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se ka banuar në këtë banesë gjatë periudhave 1995 – 1999⁸⁰ dhe 2007 – 2008⁸¹.

2.7. Në përfundim, Komisioni vlerëson se për këtë pasuri nuk konstatohen problematika lidhur me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

PASURI NË PËRDORIM

3. Apartament me sipërfaqe 112 m², në lagjen “**”, Elbasan** (në përdorim të subjektit, në pronësi të nënës së tij)

3.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur/nëna e subjektit të rivlerësimit, shtetasja F. M., ka deklaruar: “*Pronare me certifikatë për vërtetim pronësie të një apartamenti me sip. 112 m², në lagjen “****”, Elbasan, me nr. pasurie ***, në z. k. ***, Elbasan*”. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi ka deklaruar kursimet e saj dhe të bashkëshortit të ndjerë, si dhe kredinë e marrë nga djali Hektor Mushi. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁸².

⁷⁷ Ligji nr. 7652/1992, neni 20 parashikon: “Për efekt të zbatimit të këtij ligji, të merret për bazë përbërja familjare dhe gjendja e strehimit që rezulton në regjistrat themeltarë të shtetasve në datën 1 dhjetor 1992”.

⁷⁸ Udhëzimi nr. 1, datë 29.1.1993, i Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, parashikon: “11. Banesat që do të privatizohen regjistrohen në emër të qiramarrësit dhe të pjesëtarëve të tjerë madhorë të familjes së tij. Do të quhet pjesëtar madhor personi që është mbi moshën 18 vjeç”.

⁷⁹ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 22.5.2023.

⁸⁰ “Nga momenti që kam marrë detyrën në vitin 1995, kam banuar nga ky vit dhe deri në vitin 1999 në banesën e prindërve të mi, me adresë lagja “****” (ish-lagja “****”), p. ***, hyrja ***, ap nr. ***, Elbasan”.

⁸¹ “Nga viti 2007 deri në vitin 2008, pas emërimit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan kam jetuar së bashku me bashkëjetuesen dhe vajzën G. M. në banesën e prindërve të mi, bashkë me ta, me adresë lagja “****” (****), p. ***, hyrja ***, ap. nr. ***, Elbasan”.

⁸² Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 26.12.2014; kontratë porosie datë 11.12.2006; kontratë shitjeje me kusht nr. ***, datë 17.12.2014; kontratë kredie nr. ***, datë 18.12.2014; kontratë hipotekimi nr. ***, datë 18.12.2014; plan amortizimi i kredisë; kartelë e pasurisë së paluajtshme të pasurisë nr. ***, z. k. ***, Elbasan; kontratë porosie datë 11.12.2006; vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 11.12.2006.

Deklarimet e subjektit lidhur me përdorimin e këtij apartamenti

3.2. Në deklaratën *Vetting* 2017, në seksionin “Vendqëndrim tjetër, adresa e plotë e banimit”, subjekti ka deklaruar adresën lagjja “****”, rruga “****”, pallati i DHL-së, kati i 3-të banim, Elbasan, pra, pikërisht apartamentin me sip. 112 m², në pronësi të nënës së tij. Kjo adresë është deklaruar edhe në DIPP-të e viteve 2010, 2012 dhe 2016⁸³. Ndërsa, si adresë të gjendjes civile, në deklaratën *Vetting*, në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 dhe në DIPP-të e viteve 2005 – 2016, subjekti ka deklaruar apartamentin e prindërve, përfituar nga privatizimi.

3.3. Në pyetësin standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nga viti 2008 e në vijim ka jetuar së bashku me bashkëjetuesen dhe vajzën në apartamentin e hipotekuar në emër të nënës së tij F. M., me adresë lagjja “****”, rruga “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, Elbasan.

3.4. Në pyetësin nr. 2⁸⁴, i pyetur lidhur me adresat e banimit të nënës së tij, subjekti i rivlerësimit deklaroi se deri në prill të vitit 2014 ka jetuar në banesën me adresë lagjja “****”, pallati ***, hyrja ***, apartamenti nr. ***, Elbasan (apartament i përfituar nga privatizimi), e në vijim është transferuar tek subjekti, në adresën lagjja “****”, rruga “****”, nd. ***, hyrja ***, apartamenti nr. ***, Elbasan. Subjekti sqaron se ky transferim banimi është bërë pasi nëna nuk mund të jetonte e vetme pas vdekjes së babait në mars të vitit 2014.

3.5. Sa më lart, bazuar në deklaratimet e subjektit, ai ka filluar të banojë në këtë apartament që prej vitit 2008 e në vijim.

Faktet nga hetimi administrativ kryesisht

3.6. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, administruar edhe nga notere M. L.⁸⁵, rezultoi se ndërmjet shtetasve V. K., në cilësinë e sipërmarrësit, dhe A. M., në cilësinë e porositësit, është lidhur kontrata e porosisë datë 11.12.2006, vërtetuar nënshkrimi nga noteri, me nr. *** rep., datë 11.12.2006, në të cilën parashikohet që sipërmarrësi V. K. merr përsipër ndërtimin e një apartamenti me sip. 121,4 m² në objektin që po ndërton mbi truallin e shtetasve A., A. e A. M.. Në kontratë parashikohet që apartamenti, së bashku me aksesoret dhe sipërfaqet në bashkëpronësi, do të ndërtohet me një çmim me vlerë totale 5.500.000 lekë.

3.7. Lidhur me afatet dhe mënyrat e pagesës⁸⁶, kontrata parashikon se kësti i parë në masën 40% të totalit do të kryhet nga porositësi në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes dhe pagesa si këst i parë në masën 3.000.000 lekë deklarohet e marrë nga sipërmarrësi, ndërsa këstet e tjera do të paguhet në marrëveshje midis palëve.

3.8. Në vijim, ndërmjet shtetasve V. K., në cilësinë e palës shitëse, dhe F. M., në cilësinë e palës blerëse, është lidhur kontrata e shitjes me kusht nr. ***, datë 17.12.2014⁸⁷, me objekt kalimin e të drejtës së pronësisë të pasurisë apartament banimi me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z.

⁸³ Në DIPP-të e viteve 2007, 2008, 2009, 2011, 2013, 2014 dhe 2015 nuk është deklaruar asnjë adresë në këtë seksion.

⁸⁴ Email datë 18.9.2023.

⁸⁵ Shkresë nr. *** regj., datë 27.5.2023.

⁸⁶ 1. Pagesa si këst i parë në masën 40% të totalit do të kryhet nga porositësi në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes; 2. Pagesa si këst i dytë në masën 30% do të paguhet nga porositësi në momentin e përfundimit të karabinasë; 3. Pagesa si këst i tretë në masën 20% do të paguhet nga ana e porositësit në rifiniturën e objektit; 4. Pagesa si kësti i fundit do të paguhet nga porositësi në momentin e dorëzimit të apartamentit me çelësa në dorë.

⁸⁷ E paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* dhe e administruar nga notere A. B., protokolluar me nr. *** prot., datë 22.5.2023.

k. ***, me sip. 112 m², me adresë lagjja “****”, pallati ***, shkalla ***, kati ***, apartamenti nr. ***, Elbasan.

3.9. Në kontratë parashikohet se çmimi i shitjes është 5.510.400 lekë, i cili është me dy këste: (i) kësti i parë prej 3.010.400 lekësh është likuiduar nga blerësi në datën 24.8.2009, sipas mandatar-këtimit nr. ***, datë 24.8.2009, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k.; (ii) kësti i dytë prej 2.500.000 lekësh do të likuidohet pas disbursimit të kredisë nga ana e ***, e cila do të disbursohet në llogarinë e noteres e më pas do t’i transferohet shitësit.

3.10. *Për sa i përket datave të kryerjes së pagesës*, konkretisht lidhur me këstin e parë rezulton se: (i) në kontratën e sipërmarrjes të datës 11.12.2006, të lidhur ndërmjet shtetasve V. K. dhe A. M., pasqyrohet se kësti i parë për blerjen e apartamentit në masën 3.000.000 lekë paguhet me lidhjen e kontratës dhe deklarohet i marrë nga sipërmarrësi; (ii) në procesverbalin e datës 29.2.2016 të ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar se babai i tij ka nënshkruar kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “****” sh.p.k. për blerje apartamenti të ndodhur në lagjen “****”, Elbasan, dhe janë paguar 3.500.000 lekë nga prindërit në momentin e përpilimit të kontratës⁸⁸; (iii) në kontratën e shitjes me kusht nr. ***, datë 17.12.2014, përcaktohet se kësti i parë prej 3.010.400 lekësh është likuiduar nga ana e blerësit në datën 24.8.2009, siç rezulton nga mandatar-këtimi nr. ***, datë 24.8.2009⁸⁹.

3.11. Sa më sipër, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1⁹⁰, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të sqarojë mospërputhjet e sipërcituara lidhur me vlerën dhe datën e pagesës së këstit të parë, si dhe të specifikojë vlerën dhe datën e pagesës së këstit të parë, të shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues.

3.12. Në përgjigje⁹¹, subjekti i rivlerësimit sqaron se deklarimi në ILDKPKI, në datën 29.9.2016, i shumës 3.500.000 lekë, është bërë me sa dijeni kishte në ato momente, pa u konsultuar me nënën (pasi babai kishte ndërruar jetë), si dhe pa pasur kontakt viziv me kontratën e sipërpërmendur⁹². Më tej, deklaroi se kësti i parë për blerjen e këtij apartamenti është paguar në datën 11.12.2006, që në momentin e lidhjes së kontratës së porosisë nga babai i tij me ndërtuesin V. K., ku në kontratë përcaktohet se kjo shumë është marrë nga sipërmarrësi.

3.13. Në cilësinë e provës subjekti i rivlerësimit paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.8.2023, të sipërmarrësit V. K., i cili ka deklaruar se kësti i parë prej 3.000.000 lekësh është marrë prej tij nga porositësi në datën 11.12.2006, data e nënshkrimit të kontratës së porosisë nr. ***, datë 11.12.2006. Në vijim, lidhur me mandatar-këtimin nr. ***, datë 24.8.2009, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., ky shtetas ka deklaruar se bëhet fjalë për një gabim material nga ana e personit që ka përpiluar mandatin, shtetasja I. H. (e cila ka ndërruar jetë), pasi shuma e

⁸⁸ “Ndërkohë që unë kam qenë në Pogradec, im atë, i ndjeri A. M., ka nënshkruar kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “****” për blerje apartamenti të ndodhur në lagjen “****”, Elbasan, me sip. 117 m². Vlera e kësaj kontrate ka qenë rreth 5.500.000 lekë dhe është paguar 3.500.000 lekë nga prindërit në momentin e përpilimit të kontratës, ndërsa pjesa tjetër do të paguhej në momentin e përfundimit të objektit dhe regjistrimit të tij...”

⁸⁹ Bashkëlidhur kontratës së shitjes gjendet mandatar-këtimi i lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k. me nr. ***, datë 24.8.2009, ku pasqyrohet se shtetasja F. M. ka derdhur shumën 3.010.400 lekë, me përshkrimin “Pagesë për blerje ap. 2+1 në pallatin “****”, të ndodhur në lagjen “****”, Elbasan, kati i 6-të”.

⁹⁰ Email datë 27.7.2023.

⁹¹ Email datë 5.9.2023.

⁹² Subjekti deklaroi se: “Sa më sipër, deklarimi i kësaj shume është një gabim material, pasi një ngatërrësë e tillë ka ardhur edhe për shkak të pagesës së kontributit tim për blerjen e këtij apartamenti me anë të kredisë së marrë nga unë dhe bashkëjetuesja në vitet e mëpasshme. Duke qenë se kredia ishte 2.500.000 lekë për një afat prej 20 vjetësh, unë gabimisht kam menduar se kredia ishte 2.000.000 lekë për 25 vjet dhe, në këto kushte, diferenca për shumën e paguar nga prindërit është deklaruar gabim në vlerën e 3.500.000 lekëve, ndërkohë që ishte 3.000.000 lekë”.

këstit të parë ka qenë 3.000.000 lekë dhe jo 3.010.400 lekë, siç pasqyrohet në mandat, e gjithashtu data e arkëtimit ka qenë 11.12.2006 dhe jo 24.8.2009, siç pasqyrohet në mandat.

3.14. Sa më lart, Komisioni konsideroi datën 11.12.2006 si datë të pagesës së këstit të parë, pasi: (i) kjo datë është përcaktuar në kontratën e porosisë, e cila daton më herët në kohë, pra më pranë momentit në të cilin është porositur apartamenti; (ii) në datën 11.12.2006 evidentohet një tërheqje në shumën 1.800.000 lekë nga llogaria bankare e babait pranë ProCredit Bank; (iii) mandatarëkëtimi me datë 24.8.2009, që i është bashkëlidhur kontratës së shitjes, nuk përmban nënshkrimin e blerësit/porositësit.

3.15. Lidhur me datën e pagesës së këstit të dytë, Komisioni konstaton se me deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.12.2014, shtetasi V. K. dhe bashkëshortja e tij T. K. kanë deklaruar se në datën 24.12.2014 është likuiduar kësti i dytë dhe i fundit i shitjes së apartamentit të sipërcituar, në masën 2.500.000 lekë, që vërtetohet nga urdhërshirimi bankar, datë 24.12.2014, nëpërmjet ***⁹³, bashkëlidhur kësaj deklaratë.

3.16. Nga dokumentacioni i administruar nga FSHU-ja⁹⁴ rezulton se kontrata e furnizimit me energji elektrike është lidhur në emër të nënës së subjektit, në datën 18.2.2009.

3.17. UK Elbasan⁹⁵ informon se shtetasi Hektor Mushi është abonent me nr. kontrate 30663 dhe regjistrimi i saj është bërë në vitin 2009 me kërkesë të investitorit V. K.⁹⁶, në datën 28.1.2009, me listën emërore të banorëve. Pra, rezulton se kontrata me UK-në për këtë apartament është lidhur në emër të subjektit që në vitin 2009.

3.18. Lidhur me mobilimin e këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit deklaroi se shpenzimet për mobilim në vitin 2008 kanë qenë minimale, pasi një pjesë e elektroshtëpiakeve janë marrë nga banesa në Pogradec, janë bërë shpenzime rreth 250.000 lekë dhe, më tej, janë kryer të tjera shpenzime në vitet 2011 e 2012, pasi ka marrë kredinë konsumatore në vlerën 500.000 lekë në vitin 2011, ndërsa për vitet e tjera kalendarike, deri në vitin 2016, shpenzimet për mobilime, blerje elektroshtëpiake apo riparime nuk kanë qenë më shumë se 100.000 lekë për çdo vit.

3.19. Sa më lart, Komisioni paraqiti si shpenzime për mobilimin/arredimin e shtëpisë në Elbasan vlerën 250.000 lekë në vitin 2008 dhe vlerën 100.000 lekë për secilin nga vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, ndërsa në vitin 2011, Komisioni paraqiti si shpenzim në analizën financiare të vitit 2011 shumën e tërhequr prej 497.000 lekësh, pas disbursimit të kredisë konsumatore pranë Credins Bank.

3.20. Komisioni verifikoi të dhënat lidhur me vlerën mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë të apartamenteve në vitin 2006⁹⁷ në qytetin e Elbasanit dhe rezulton se çmimi për metër katror ishte në vlerën 41.838 lekë. Për pasojë, apartamenti i porositur nga babai i subjektit sipas çmimeve të referencës llogaritet në vlerën 4.685.856 lekë⁹⁸. Në këto kushte, çmimi për blerjen e apartamentit të mësipërm nuk rezulton të jetë preferencial.

⁹³ Në mandatpagesën e bankës SGS pasqyrohet se në datën 24.12.2014, nga llogaria e shtetasve Hektor Mushi dhe I. B. ka kaluar shuma 2.500.000 lekë në llogari të noteres A. B. (G.), me përshkrimin "Kalim fondi për blerje apartamenti sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2014, të noteres A. B.".

⁹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2021.

⁹⁵ Shkresë nr. *** prot., pa datë (prot. në KPK me nr. *** prot., datë 13.6.2023).

⁹⁶ Sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme, pjesë e kontratës së shitjes me kusht nr. ***, datë 17.12.2014, rezulton që apartamenti me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. *** është regjistruar në emër të shtetasit V. K. në datën 28.7.2009, ndërsa regjistrimi i pronësisë në emër të shtetasit F. M. është bërë në datën 26.12.2014.

⁹⁷ Udhëzim nr. 5, datë 7.9.2006, i Këshillit të Ministrave.

⁹⁸ Për llogaritë 112 m² x 41.838 lekë.

3.21. Gjithashtu, Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasit V. e T. K. dhe shoqërinë “****” sh.p.k., dhe nuk rezultoi që subjekti të ishte në kushtet e konfliktit të interesit⁹⁹.

Analizimi i deklarimeve në raport me faktet

3.22. Nga hetimi administrativ konstatohet se: (i) subjekti i rivlerësimit ka filluar të banojë në këtë apartament që prej vitit 2008 e në vijim¹⁰⁰; (ii) nëna e subjektit të rivlerësimit është transferuar në apartamentin ku banon subjekti në prill të vitit 2014, pas vdekjes së babait të tij¹⁰¹; (iii) subjekti i rivlerësimit ka kontribuar në shumën 2.500.000 lekë për blerjen e këtij apartamenti¹⁰², por nuk figuron të ketë të drejta pronësie në këtë pasuri; (iv) emri i subjektit të rivlerësimit figuron në listën emërore të banorëve të paraqitur në datën 28.1.2009 nga investitori pranë UK Elbasan; (v) kontrata e furnizimit me ujë është lidhur në emër të subjektit të rivlerësimit (jo të prindërve).

3.23. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur marrëdhënie të vazhdueshme përdorimi të apartamentit që nga momenti i ndërtimit, ndërsa babai i tij nuk e ka përdorur asnjëherë këtë apartament dhe nëna e tij është transferuar aty vetëm pas vdekjes së babait të subjektit.

3.24. Në këto kushte, Komisioni ngre dyshime mbi vërtetësinë e deklaramit të subjektit se ai ka vetëm të drejta përdorimi mbi këtë apartament, duke u përpjekur të paraqesë rrethana të rreme, të cilat tentojnë të shmangin nga kontrolli një marrëdhënieje të një natyre tjetër, që është ajo e pronësisë me këtë pasuri.

Burimet e krijimit

3.25. Pavarësisht analizës së mësipërme, Komisioni analizoi burimet e krijimit të këtij apartamenti sipas deklarimeve të subjektit, si më poshtë vijon:

3.26. Nga hetimi rezulton se: (i) në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim kursimet e prindërve, të mbledhura në vite; (ii) në deklaratën *Vetting* personi i lidhur/F. M. ka deklaruar si burim kursimet e saj dhe të bashkëshortit të ndjerë, si dhe kredinë e marrë nga djali Hektor Mushi; (iii) në procesverbalin e datës 29.2.2016 të ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat e prindërve dhe dërgesat e vëllezërve nga Gjermania¹⁰³.

a) Burimi i këstit të parë prej 3.000.000 lekësh

3.27. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁰⁴, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të specifikojë se sa është kontributi i të ardhurave nga pagat e prindërve në kursimet e tyre të deklaruara si burim për këstin e parë dhe të konfirmojë nëse dërgesat e vëllezërve nga Gjermania kanë qenë pjesë e kursimeve të përdorura për pagesën e këstit të parë sipas deklaramit në procesverbalin e ILDKPKI-së.

⁹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 2.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë JP Korçë; shkresë nr. *** prot., datë 2.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë JP Elbasan.

¹⁰⁰ Përgjigjet e pyetësorit standard; shkresë nr. *** prot., pa datë (nr. *** prot., datë 13.6.2023), e UK Elbasan.

¹⁰¹ Përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

¹⁰² Subjekti dhe bashkëjetuesja kanë marrë një kredi në vlerën 2.500.000 lekë pranë OTP Bank, me qëllim blerje banese (trajtuar në vijim të relacionit).

¹⁰³ Në procesverbalin e datës 29.2.2016 të ILDKPKI-së¹⁰³, subjekti ka deklaruar: “*Burimi i blerjes së këtij apartamenti ishin të ardhurat e prindërve, kursimet nga puna e babait si inxhinier (në firmë inertesh) deri 2 vjet para vdekjes dhe dërgesat e vëllezërve nga Gjermania*”.

¹⁰⁴ Email datë 27.7.2023.

3.28. Në përgjigje¹⁰⁵, subjekti i rivlerësimit deklaroi se vëllezërit kanë kontribuar në kursimet e përdorura për pagesën e këstit të parë, por nuk specifikon vlerën e këtij kontributi. Më tej, shpjegon se një pjesë të këtyre të ardhurave, konkretisht shuma 10.000 euro, vëllai i tij/D. M. e ka marrë hua nga kushërira e tyre T. L. (D.), vajza e hallës, me nënshtetësi gjermane. Këtë hua, shtetasi D. M. ia ka dhënë babait për pagesën e kontratës së porosisë, ndërsa huan e ka shlyer deri në vitin 2021 nga të ardhurat e tij personale.

3.29. Në cilësinë e provës, subjekti i rivlerësimit paraqiti: (i) dokumentacion lidhur me të ardhurat e realizuara nga vëllai D. M., për periudhën 26.8.2003 – 31.12.2022¹⁰⁶; (ii) dokumentacion lidhur me të ardhurat e realizuara nga shtetasja T. L. (D.), për periudhën 20.5.1994 – 31.12.2010; (iii) deklaratë datë 11.8.2023, nga shtetasja T. L., për dhënie huaje.

3.30. Sa më lart, Komisioni fillimisht analizoi të dhënat lidhur me mundësitë financiare të vëllezërve për të kontribuar në pagesën e këtij kësti.

Lidhur me kontributin e shtetasit A. P. (M.), vëllai i subjektit

3.31. Në vijim të trajtimit të mundësive financiare të këtij shtetasi për dhurimin e shumës 1.500.000 lekë subjektit të rivlerësimit, Komisioni analizoi të ardhurat dhe shpenzimet e jetesës për periudhën pasuese, konkretisht për periudhën shkurt 2004 – dhjetor 2006.

3.32. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, për periudhën e sipërcituar, të ardhurat bruto përlllogariten në shumën 9.694 euro, ndërsa shpenzimet e jetesës për një person përlllogariten në shumën 28.337 euro¹⁰⁷.

3.33. Sa më lart, Komisioni vëren se vëllai i subjektit/A. M. nuk ka pasur mundësi të kontribuojë në pagesën e këstit të parë, pasi të ardhurat e tij bruto kanë qenë më të ulëta se shpenzimet e jetesës.

Lidhur me kontributin e shtetasit D. M., vëllai i subjektit

3.34. Për sa i përket deklaramit të subjektit se vëllai/D. M. ka marrë hua një shumë prej 10.000 euro nga kushërira e tij për t'ia dhënë më pas babait, Komisioni vëren se ky burim është deklaruar për herë të parë në përgjigje të pyetësorit nr. 1, datë 27.7.2023, ndërkohë që subjekti dhe personi i lidhur/nëna i kanë pasur të gjitha mundësitë që ta shpjegonin këtë situatë në deklaratën *Vetting* 2017, sipas kërkesave ligjore lidhur me deklaramin e burimit. Për rrjedhojë, kjo hua e deklaruar nuk mund të konsiderohet nga Komisioni si burim për pagesën e këstit të parë.

3.35. Më tej, Komisioni analizoi dokumentacionin e paraqitur lidhur me të ardhurat e realizuara në Gjermani nga shtetasja D. M., nga ku u konstatua se të ardhurat bruto gjatë periudhës 26.8.2003 – 31.12.2006 kanë qenë 21.687 euro, ndërkohë që për të njëjtën periudhë shpenzimet e jetesës për 1 person kanë qenë 32.474 euro.

3.36. Gjithashtu, nga dokumentacioni i përcjellë nga ProCredit Bank¹⁰⁸ vërehet se gjatë periudhës 2006 – 2011 babai i subjektit ka kryer transferta bankare të vazhdueshme në favor të

¹⁰⁵ Email datë 5.9.2023.

¹⁰⁶ Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur dokumentacion për të ardhurat e realizuara gjatë periudhës 26.8.2003 – 31.12.2006. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, dokumentacioni u paraqit sipas formës së kërkuar ligjore.

¹⁰⁷ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01_custom_7282795/default/table?lang=en

¹⁰⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 3.2.2021.

djalit të tij D. M., të cilat sipas përshkrimit të paraqitur kanë qenë me qëllim pagesën e studimeve.

3.37. Konkretisht, janë kryer këto transferta bankare: (i) në vitin 2006 – tri transferta bankare me vlerë totale 2.500 euro; (ii) në vitin 2007 – dy transferta me vlerë totale 3.000 euro; (iii) në vitin 2008 – gjashtë transferta me vlerë totale 3.500 euro; (iv) në vitin 2009 – dy transferta me vlerë totale 1.080 euro; (v) në vitin 2010 – një transfertë me vlerë 500 euro; (vi) në vitin 2011 – një transfertë me vlerë 600 euro.

3.38. Sa më lart, Komisioni vëren se vëllai i subjektit/D. M. nuk ka pasur mundësi të kontribuojë në pagesën e këstit të parë, pasi të ardhurat e tij bruto kanë qenë më të ulëta se shpenzimet e jetesës, çka përforcohet nga fakti që babai i ka dërguar fonde të tjera nga Shqipëria me qëllim pagesën e studimeve.

*Lidhur me pagat e të ndjerit, babait të subjektit, pranë shoqërisë “***” sh.p.k.*

3.39. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur/nëna e subjektit ka deklaruar: “*Paga e bashkëshortit tim të ndjerë në firmën private “***” sh.p.k., si inxhinier mekanik nga data 1.2.1995 deri më 30.10.2001, me pagë mujore 45.000 lekë, në vlerën 3.645.000 lekë*”. Bashkëlidhur është paraqitur vërtetimi i datës 18.10.2016 nga shoqëria “***” sh.p.k., që konfirmon se shtetasi A. M. ka qenë punonjës pranë kësaj shoqërie me profesion inxhinier mekanik gjatë periudhës 1.2.1995 – 31.10.2001, me pagë mujore 45.000 lekë.

3.40. Sipas informacionit të përcjellë nga DRSSH Elbasan¹⁰⁹, për vitet 1995, 1996, 1997 dhe periudhën gusht – dhjetor 1998 nuk ka listëpagesa (bordero), ndërsa për periudhat janar – korrik 1998, 1999, 2000 dhe 2001 emri i shtetasit A. M. nuk figuron në listëpagesë.

3.41. Sa më sipër, Komisioni çmon se këto të ardhura mund të jenë krijuar në kuadër të një marrëdhënieje informale punësimi dhe, për rrjedhojë, edhe në eventualitetin që do të provohej krijimi i tyre, ato nuk mund të vlerësohen të ardhura të ligjshme, duke u përfshirë në analizën financiare, për sa kohë nuk përmbushin standardin e përcaktuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

3.42. Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve të subjektit¹¹⁰, për periudhën 1994 – 11.12.2006, duke konsideruar: (i) të ardhurat e të ndjerit, babai i subjektit, nga pagat pranë N.P.C., Uzina Mekanike¹¹¹; (ii) të ardhurat e të ndjerit, babai i subjektit¹¹²; (iii) të ardhurat e nënës nga pagat¹¹³; (iv) të ardhurat nga interesat në ProCredit Bank¹¹⁴; (v) shpenzimet e jetesës për dy persona¹¹⁵; (vi) dërgesa për djalin/D. M. për

¹⁰⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 2.8.2023.

¹¹⁰ Duke qenë se prindërit e subjektit nuk kanë pasur detyrim për plotësim të deklaratës periodike vjetore të interesave private, analiza financiare nuk mund të kryhet në fund të çdo viti kalendarik, siç kryhet për vetë subjektin, por në vijimësi, në mënyrë akumulative, duke mbartur në vitin pasardhës edhe balanca të mundshme pozitive që mund të rezultojnë nga vitet paraardhëse.

¹¹¹ Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare N.P.C. Elbasan, ***, Zyra e Punës (paraqitur në deklaratën *Vetting*).

¹¹² Vërtetim nr. *** prot., datë 25.2016, i DRSSH-së Elbasan (paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*), saktësuar me vlerën 16.979 lekë, pasi i përket muajit dhjetor 2006.

¹¹³ Saktësuar me vlerën 63.763 lekë, pasi është transferuar në llogarinë bankare të nënës pranë Intesa Sanpaolo Bank pas datës 11.12.2006.

¹¹⁴ Evidentuar në lëvizjet e llogarive bankare të babait pranë ProCredit Bank.

¹¹⁵ Zbritur shpenzimet për 0.6 muaj.

shkollimin¹¹⁶; (vii) shpenzimet për udhëtime nga sistemi TIMS¹¹⁷, nga ku rezultoi një balancë negative në shumën -1.567.206 lekë.

b) Burimi i dytë – kredia në shumën 2.500.000 lekë

3.43. Në deklaratën Vetting 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kredi afatgjatë “Për shtëpi”. Kredimarrës Hektor Mushi dhe dorëzues I. B., nr. kontratë kredie ***, datë 24.12.2014, në vlerën 2.500.000...lekë, normë interesi 4.90%, me afat shlyerjeje 20... vjet. Këst mujor 17.993...lekë. Data e fillimit të kontratës 18.12.2014. Kjo kredi është marrë me qëllim shlyerjen e pjesës së mbetur pa shlyer...prej 2.500.500 lekësh të kontratës së sipërmarrjes për blerjen e një apartamenti 112 m², me adresë lagjia “***”, Elbasan, me vlerë 5.500.000 lekë dhe njëkohësisht hipotekimin e kësaj shtëpie. Kjo kontratë porosie është bërë ndërmjet... A. M. dhe firmës ndërtuese të apartamentit me sipërmarrës V. K., duke paguar fillimisht vlerën prej 3.000.000 lekësh... Shuma e kredisë e marrë prej meje i është dhënë firmës me qëllim blerjen e banesës dhe hipotekimin e saj në emër të nënës time F. M.. Kontrata e shitblerjes dhe hipotekimi është bërë në emër të nënës time, për arsye se në kohën e lidhjes së kontratës së shitblerjes, babai im kishte vdekur, ndërsa vëllezërit e mi A. dhe D. M., pavarësisht faktit se janë trashëgimtarë ligjorë (de jure) edhe të pjesës takuese sipas kontratës së porosisë së apartamentit... (në deklaratë mungon vazhdimi i fjalisë)”.

3.44. Kjo kredi është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-të vjetore¹¹⁸.

3.45. Në procesverbalin e datës 29.2.2016 të ILDKPKI-së¹¹⁹, subjekti ka deklaruar: “[...] Duke pasur njohje me ndërtuesin e pallatit, si dhe për shkak të gjendjes shëndetësore, babai nuk kishte përfunduar shlyerjen totale të shtëpisë, në fund të vitit 2014 na u kërkua të bënim procedurat, d.m.th. pagesën tërësore dhe regjistrimin në hipotekë. Për këtë qëllim u mor kredia prej 2.500.000 lekësh në *** në datën 24.12.2014..., për këtë arsye kam deklaruar vetëm marrjen e kredisë dhe jo apartamentin [...]”.

3.46. OTP Bank¹²⁰ konfirmon se ndërmjet shtetasve Hektor Mushi dhe I. B., në cilësinë e kredimarrësit, dhe bankës *** sh.a. është lidhur kontrata e kredisë bankare afatgjatë për shtëpi, me nr. ***, datë 18.12.2014, në të cilën pasqyrohet se banka i jep kredimarrësit shumën 2.500.000 lekë, me normë interesi jo më pak se 4,9% në vit. Gjithashtu, rezulton se është lidhur kontrata e hipotekimit nr. ***, datë 18.12.2014, ku në cilësinë e hipotekuesit pasqyrohet shtetasi V. K. dhe në cilësinë e hipotekuesit të ardhshëm shtetasja F. M., me objekt hipotekimin e pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 112 m², lagjia “***”, Elbasan.

¹¹⁶ Dërgesa nëpërmjet ProCredit Bank deri në datën 11.12.2006 (2.500 euro).

¹¹⁷ Udhëtim nëna, datë 28.11.2006.

¹¹⁸ Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar: “Kredi afatgjatë për blerje banese në emër të Hektor Mushit dhe I. B., nr. kredie ***, datë 24.12.2014, në vlerën 2.500.000 lekë, normë interesi 4.90%, me afat shlyerjeje 20 vjet”. Në DIPP-në e vitit 2015, në seksionin “Detyrime financiare...”, subjekti ka deklaruar: “Kredi afatgjatë për blerje banese në emër të Hektor Mushit dhe I. B., nr. kredie ***, datë 24.12.2014, në vlerën 2.500.000 lekë, normë interesi 4.90%, me afat shlyerjeje 20 vjet. Këst mujor 17.993 lekë. Në ***, me kontratë nr. ***, datë 18.12.2014. Kredia është marrë për të paguar pjesën e mbetur, pa paguar sipas kontratës së porosisë për blerje apartamenti në lagjen “***”, Elbasan, datë 11.12.2016, ndërmjet prindërve të mi dhe sipërmarrësit V. O. K.. Pjesë e mbetur prej 2.500.000 lekësh. Kjo shumë i është depozituar firmës ndërtuese pas marrjes së kredisë dhe është përpiluar kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2014, ndërmjet nënës time F. Q. M. dhe palës shtetase V. O. K., me objekt kalimi i të drejtës së pronësisë me kusht nga shitësi tek blerësi i pasurisë së llojit apartament banimi me nr. ***, në lagjen “***”, Elbasan, p. *** ap. ***, zona kadastrale 8523, Elbasan, me sip. 112 m². Kjo pasuri është regjistruar më pas në ZVRPP në emër të nënës F. Q. M., në datën 26.12.2014. Kjo pasuri është kufizuar nga hipoteka si kolateral për pagimin e kredisë...”.

¹¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.5.2023.

¹²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2021.

3.47. Nga verifikimi i llogarisë bashkëmore të subjektit të rivlerësimit dhe shtetases I. B. konstatohet se në datën 24.12.2024 është bërë kalimi i shumës 2.500.000 lekë në llogarinë e noteres A. B., me përshkrimin “Kalim fondi për blerje apartamenti sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2014, të notere A. B.”.

3.48. Sa më lart, konstatohet se kredia e marrë nga subjekti i rivlerësimit ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në pronësi të nënës së tij.

3.49. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) *Ka dyshime mbi vërtetësinë e deklaramit të subjektit se ai ka vetëm të drejta përdorimi mbi këtë apartament, duke u përpjekur të paraqesë rrethana të rreme lidhur me pronësinë e vërtetë të apartamentit, pasi: (a) subjekti ka filluar të banojë në këtë apartament që prej vitit 2008 e në vijim¹²¹; (b) nëna e subjektit është transferuar në apartamentin ku banon subjekti në prill 2014, pas vdekjes së babait të subjektit¹²²; (c) është e paqartë që subjekti nuk figuron të ketë të drejta pronësie në këtë pasuri, ndërkohë që ka kontribuar në shumën 2.500.000 lekë për blerjen e këtij apartamenti; (ç) emri i subjektit figuron në listën emërore të banorëve të paraqitur në datën 28.1.2009 nga investitori pranë UK Elbasan; (d) kontrata e furnizimit me ujë është lidhur në emër të subjektit (jo të prindërve); (ii) Personi i lidhur/nëna e subjektit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 1.567.206 lekë për pagesën e këstit të parë në datën 11.12.2006, për apartamentin në Elbasan.*

3.50. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹²³, lidhur me dyshimet mbi vërtetësinë e deklaramit se ai ka vetëm të drejta përdorimi mbi këtë apartament, duke u përpjekur të paraqesë rrethana të rreme lidhur me pronësinë e vërtetë, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti shpjegime.

3.51. Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme të nënës së subjektit në shumën 1.567.206 lekë për pagesën e këstit të parë në datën 11.12.2006, subjekti kërkoi që analiza financiare të ndahet në dy pjesë, si në vijim:

3.52. Në pjesën e parë, subjekti kërkoi të konsiderohen burimet financiare të personave të lidhur, babait dhe nënës së tij, deri në datën 11.12.2006, duke kërkuar:

3.52.i Të saktësohen të ardhurat nga pensioni i babait, duke i shtuar edhe të ardhurat e përfituara për periudhën 1.7.2006 – 11.12.2006, në shumën 96.145 lekë.

3.52.ii Të përfshihen të ardhurat nga paga e babait të tij pranë shoqërisë “****” sh.p.k., së paku për periudhën 1.2.1995 – 31.12.1997, në vlerën 1.575.000 lekë, pasi: (i) vërtetimi i lëshuar nga shoqëria konfirmon pagesën prej 45.000 lekësh në muaj; (ii) DRSSH Elbasan ka bërë me dije se nuk gjenden listëpagesat e shoqërisë për periudhën 1995 – 1997, ndërsa për periudhën 1998 – 2001 emri nuk rezulton në listëpagesë e, për pasojë, nuk mund të penalizohet për faktin që në zyrat e institucioneve shtetërore nuk ekzistojnë listëpagesat e babai të tij për periudhën 1995 – 1997. Gjithashtu, sqaron se ka paraqitur deklaratën noteriale të datës 9.12.2005, që tregon për lidhjen që ka pasur babai i tij me shoqërinë “****” sh.p.k. në marrëdhënie pune, në mirëbesim

¹²¹ Përgjigjet e pyetësorit standard; shkresë nr. *** prot., pa datë (nr. *** prot., datë 13.6.2023), e UK Elbasan.

¹²² Përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

¹²³ Email datë 7.12.2023.

për blerjen e një makinerie ndërtimi dhe bazuar në këtë fakt kërkon që të ardhurat të përfshihen në analizën financiare.

3.52.iii Të konsiderohet që në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në të ardhurat e prindërve kanë pasur ndikim edhe kontributet e fëmijëve, pasi vetëm balancat pozitive të vërtetuara nga analiza financiare e Komisionit për vitet 2005 – 2006, në kushtet e mosdeklarimit të gjendjes *cash*, por edhe analiza financiare e paraqitur nga ana e tij, rezultoi e mundur ndihma financiare për prindërit.

3.52.iv Në përfundim, subjekti paraqiti analizën e tij financiare për periudhën 1994 – 11.12.2006, me një balancë pozitive në shumën 103.939 lekë.

3.53. Në pjesën e dytë, subjekti shpjegoi se në analizën financiare të paraqitur nga ana e tij, me balancë pozitive 103.939 lekë, nuk është konsideruar huaja e dhënë vëllait të tij nga kushërira/shtetasja T. L. D., në shumën 10.000 euro, hua të cilën ia ka dhënë babait për të mbuluar koston e parë të blerjes së apartamentit në Elbasan. Subjekti shpjegon se shtetasja T. L. disponon likuiditete për dhënien e huas dhe shtetasi D. M. e ka shlyer deri në vitin 2021 nga atë ardhurat e tij personale.

3.54. Subjekti ka paraqitur një dokument në formatin *word*, ku citohet se vëllai i tij nuk e kishte të qartë qëllimin e pyetësorit dhe në çfarë detaji duhej të përgjigjej, duke shtuar se në vitin 2017 përgjigjet e tij të pyetësorit u bënë në funksion të justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive të krijuara. Më tej, në këtë dokument sqarohet se periudha për huamarrjen është viti 2006, 11 vite para se të plotësonte pyetësorin, ndërkohë që udhëzimi i shtetit gjerman është të ruash dokumente financiare për një periudhë prej 10 vjetësh. Gjithashtu, ka sqaruar se huaja nga kushërira nuk është përmendur, për shkak se: (i) ishte një huadhënie informale mes njerëzve familjarë shumë të afërt; (ii) dokumenti që dëshmonte huamarrjen, i krijuar në vitin 2023, ka dashur një kohë të konsiderueshme për të krijuar, duke përfshirë vizita të shumta në zyra të ndryshme publike dhe notere, për atë dhe kushërirën, duke përfshirë marrjen e disa ditëve pushimi nga puna; (iii) pjesa më e madhe e huas ishte paguar në vitin 2017, pasi gjatë kësaj kohe kishte filluar të punonte me kohë të plotë dhe se qëllimi i një pjese të kredisë në *** Bank prej 5.000 euro ishte shlyerja e kësaj huaje; (iv) nuk e ka përcaktuar këtë huadhënie si të rëndësishme për pyetësorin, pasi ishte hua nga një pjesë e familjes dhe jo pasuri; (v) për të njëjtën arsye nuk i ka listuar në pyetësor si burime pasurie paratë që i kanë dërguar prindërit gjatë viteve për ta ndihmuar me studimet; (vi) për të njëjtën arsye nuk ka listuar në vitin 2017 ose në vitin 2023 ndihmat financiare që i ka dhënë prindërve; (vii) kjo huamarrje nuk ka lidhje me vëllain e tij Hektor Mushi.

3.55. Për sa i përket mënyrës së llogaritjes së shpenzimeve të jetesës në Gjermani nga ana e Komisionit, subjekti pretendon se këto vlera nuk janë tregues për koston e jetesës, por japin një prag minimal për të klasifikuar një pjesë të popullsisë si në “rrezik për varfëri”. Norma e rrezikut të varfërisë nuk është një masë absolute për nevojat e njerëzve ose për koston e jetesës. Një indeks më i saktë për kostot e jetesës për studentët në Gjermani mund të gjendet në bazë të “***”, një studim shkencor i trendeve për situatën jetësore dhe studimore të studentëve në Gjermani, studim ku jepet një bazë më e saktë mbi kostot e jetesës së një studenti në Gjermani, shpjegoi subjekti.

3.56. Në vijim, subjekti shpjegoi se *duke konsideruar të dhënat e studimit, si dhe duke konsideruar se kostot mund të jenë më të larta ose të ulëta për një person specifik, kostot për*

një student të huaj nga një vend zhvillimi janë mesatarisht më ulëta se një student i huaj nga një vend i zhvilluar, në kosto është dhënë një çmim mesatar për qiranë (ndërkohë që çmimi i qirasë së tij ishte më i ulët se mesatarja), në koston mesatare të jetesës është përfshirë edhe kostoja për një automjet (ndërkohë që vëllai nuk kishte makinë, në koston mesatare është marrë parasysh një çmim mesatar për internet, telefon dhe televizor/radio (ndërkohë që kisha kosto për internet/televizor/radio pasi ishin të përfshira në qira), në koston mesatare është një çmim për ushqimin (ndërkohë që gjatë një periudhe jetonte në një konvikt me vëllain/A. P. dhe i ndanin kostot e ushqimeve bashkë).

3.57. Lidhur me të ardhurat e përfituara, në dokumentin në formatin *word* sqarohet se në dokumentin e paraqitur lidhur me të ardhurat e vëllait D. M. nuk listohen punët *mini job* – punë me pagesë të ulët, për të cilat nuk paguhen taksa sociale dhe taksat e pensionit. Këto punë kanë qenë një nga metodat kryesore të vetëfinancimit gjatë kohës studentore të vëllait, por fatkeqësisht nuk disponohen dokumente, shpjegohet në këtë dokument.

3.58. Në prapësimet e dërguara me anë të *email*-it, subjekti, ndër të tjera, paraqiti: (i) dokument në formatin *word*, me emërtim “***.”; (ii) dokument në formatin *excel*, me emërtim “Aneksi 2 D. M.”; (iii) dy foto dokumentesh në gjuhën gjermane, njëri me emërtim “***” dhe tjetri nga *** Bank.

3.59. Në përfundim, lidhur me analizën e mundësive financiare të vëllait D. M., subjekti deklaroi se, nëse konsiderohet sa më lart, si dhe duke i shtuar ndihmën financiare të prindërve, do të rezultojnë të ardhura në shumën totale 24.187 euro dhe kostoja e jetesës 20.792 euro.

3.60. Pas shpjegime të mësipërme, subjekti paraqiti një analizë të dytë financiare për periudhën 1994 – 11.12.2006, ku reflektohet një balancë pozitive në shumën 1.371.339 lekë.

3.61. Në konkluzion, subjekti pretendoi që: (i) personat e lidhur/nëna dhe babai i subjektit të rivlerësimit kanë pasur burime të ligjshme financiare për të kryer pagesën e këstit të parë në shumën 3.000.000 lekë për blerjen e apartamentit në Elbasan; (ii) të ardhurat nga paga të personit të lidhur/babait të subjektit të rivlerësimit janë të ligjshme dhe duhet të merren në konsideratë në analizën financiare; (iii) huaja e dhënë në shumën 10.000 euro nga kushërira T. L. (D.) për shtetasin D. M., e cila ka ndihmuar për kryerjen e këstit të parë për blerjen e apartamentit në Elbasan nga personat e lidhur/babai dhe nëna e subjektit të rivlerësimit është e dokumentuar dhe e ligjshme.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.62. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton si më poshtë:

3.63. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova shtesë apo shpjegime lidhur me konstatimin e rezultateve të hetimit *për dyshimet mbi vërtetësinë e deklaratimit se ai ka vetëm të drejta përdorimi mbi këtë apartament*, Komisioni, bazuar në rezultatet e hetimit administrativ të pasqyruara në paragrafin 3.22 të vendimit, çmon se subjekti i rivlerësimit ka pasur marrëdhënie të vazhdueshme përdorimi të apartamentit që nga momenti i ndërtimit të tij e, për

pasojë, krijohen dyshime të arsyeshme për sa i përket vërtetësisë së deklaramit të tij se ai ka vetëm të drejta banimi mbi këtë apartament.

3.64. Në vijim, për sa i përket burimeve të krijimit *lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për saktësimin e shumës së të ardhurave nga pensioni*, Komisioni, pasi verifikoi vërtetimin e lëshuar nga DRSSH Elbasan¹²⁴, çmon se pretendimi i subjektit është i drejtë dhe, për rrjedhojë, në analizën financiare të ardhurat nga pensioni i babait u shtuan me shumën 84.895 lekë¹²⁵.

3.65. *Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizën financiare të pagave të babait të tij gjatë periudhës 1.2.1995 – 31.12.1997*, Komisioni çmon se për sa kohë që këto të ardhura mund të jenë krijuar në kuadër të një marrëdhënieje informale punësimi dhe, për rrjedhojë, edhe nëse provohet krijimi i tyre, ato nuk mund të vlerësohen të ardhura të ligjshme duke u përfshirë në analizën financiare, për sa kohë nuk përmbushin standardin e përcaktuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

3.66. Për më tepër, nga verifikimi në faqen *online* të QKB-së të ekstraktit historik të shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, rezulton se kjo shoqëri është themeluar në datën 22.10.1995 dhe është regjistruar në datën 13.3.1996, ndërkohë që subjekti pretendon të ardhura, duke filluar që nga data 1.2.1995.

3.67. Për rrjedhojë të sa më lart, pretendimi i subjektit nuk konsiderohet i bazuar dhe të ardhurat e pretenduara nga punësimi i babait në shumën 1.575.000 lekë nuk u paraqitën në analizën financiare.

3.68. Në vijim, Komisioni e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit për të konsideruar balancat pozitive të viteve 2005 – 2006 të analizës së tij financiare si ndihmë për prindërit, pasi ky pretendim është ngritur për herë të parë pas kalimit të barrës së provës dhe pas vënies në dispozicion të analizës financiare, ndërkohë që as në deklaratën *Vetting* dhe as gjatë hetimit¹²⁶ nuk është deklaruar ndonjë kontribut i subjektit në pagesën e kështit të parë.

3.69. Për sa i përket deklaramit të subjektit se *vëllai/D. M. ka marrë hua një shumë prej 10.000 euro nga kushërira e tij për t’ia dhënë më pas babait*, Komisioni vëren se ky burim është deklaruar për herë të parë në përgjigje të pyetësorit nr. 1, datë 27.7.2023, ndërkohë që subjekti dhe personi i lidhur/nëna i kanë pasur të gjitha mundësitë që ta shpjegonin këtë situatë në deklaratën *Vetting* 2017, sipas kërkesave ligjore lidhur me deklaramin e burimit. Për rrjedhojë, kjo hua e deklaruar nuk mund të konsiderohet nga Komisioni si burim për pagesën e kështit të parë.

3.70. *Për sa i përket pretendimit të subjektit për përdorimin e gabuar të të dhënave statistikore lidhur me shpenzimet e jetesës në shtetin gjerman*, Komisioni thekson se kjo metodologji dhe referencat përkatëse janë bazuar në praktikën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, konkretisht në vendimet nr. 26-2021 (JR), datë 4.8.2021, nr. 12-2022 (JR), datë 29.4.2022, nr. 28-2022 (JR), datë 14.7.2022, nr. 15-2023 (JR), datë 13.4.2023 dhe nr. 32-2019 (JR), datë

¹²⁴ Vërtetim nr. *** prot., datë 25.2016.

¹²⁵ Përllogarituri periudha 1.7.2006 – 11.12.2006, 5 muaj x 16.979 lekë = 84.895 lekë. Të ardhurat nga pensioni ishin në shumën 915.128 lekë, tashmë përllogariten në shumën 1.000.023 lekë.

¹²⁶ Konkretisht në përgjigjen e pyetjes nr. 2.2 të pyetësorit nr. 1, datë 27.7.2023.

21.11.2019, vendime në të cilat është përdorur e njëjta bazë të dhënash statistikore dhe të njëjtat kritere¹²⁷, të cilave u është referuar Komisioni në rastin konkret.

3.71. Në çdo rast, Komisioni nuk e vlerëson bindës *pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vëllai i tij/D. M. ka ndihmuar financiarisht prindërit* për pagesën e këstit të parë të apartamentit në Elbasan, pasi nga analizimi i shpjegimeve, dokumentacionit të paraqitur dhe rrethanave vërehet se:

3.71.i Përgjatë një periudhe të caktuar, vëllai/D. M. jetonte në konvikt, ndërsa më vonë jetonte në shtëpi me kosto të ulët qiraje (kosto që, madje, përfshinte edhe internet, telefon dhe televizor/radio), nuk dispononte automjet, kryente disa punë – çka nënkupton një situatë jo të lehtë financiare.

3.71.ii Gjatë periudhës qershor – korrik 2006, vëllait/shtetasit D. M. i janë dërguar nga ana e prindërve 2.500 euro, të cilat, referuar përshkrimin në lëvizjen e llogarisë bankare, kanë pasur si qëllim pagesën e studimeve – çka prezumon që ai nuk ka pasur mundësi financiare që t'i kryejë vetë këto pagesa.

3.71.iii Në datën e lidhjes së kontratës dhe kryerjes së pagesës për apartamentin në Elbasan, prindërit e subjektit kishin në pronësi dhe jetonin në apartamentin në lagjen “***”¹²⁸, pra ata nuk ishin në kushtet e nevojës së menjëhershme për strehim, por, siç rezultoi gjatë hetimit, apartamenti nuk është përdorur asnjëherë nga babai, ndërsa nëna ka filluar të jetojë shumë më vonë (në vitin 2014).

3.72. Pra, në këto kushte, në vlerësim të Komisionit, është e vështirë të arrihet në një konkluzion që një student – i gjendur në situatën ekonomiko-sociale të përshkruar nga vetë subjekti – të mund të ndihmonte financiarisht prindërit e tij, aq më tepër për të investuar në një apartament të dytë.

3.73. Pavarësisht të sa më lart, edhe nëse konsiderohet analiza financiare e paraqitur nga subjekti, Komisioni çmon se sërish vëllai D. M. do të gjendej me mungesë burimesh financiare për të ndihmuar financiarisht prindërit. Të ardhurat e këtij shtetasi – për shkak të mungesës së informacionit mbi shumën neto – janë përlllogaritur në shumën bruto, konkretisht 21.687 euro. Duke konsideruar nivelin e ndalesave të pagës në shtetin gjerman – si shembull, për vitin 2016 ndalesat kanë qenë në masën rreth 40% të pagës bruto referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti¹²⁹ – duket se diferenca e rezultuar nga analiza e financiare e paraqitur nga subjekti prej 3.395 euro¹³⁰, e tejkalon masën e mundshme të ndalesave mbi pagën bruto të vëllait D. M..

3.74. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se vëllai i tij/D. M. ka ndihmuar prindërit e subjektit të rivlerësimit vlerësohet i pabazuar.

¹²⁷ *At risk of poverty threshold (60% of median equivalised income).*

¹²⁸ Në pyetësorin nr. 2, i pyetur lidhur me adresat e banimit të nënës së tij, subjekti i rivlerësimit deklaroi se deri në prill 2014 ka jetuar në banesën me adresë lagja “***”, pallati ***, hyrja ***, apartamenti nr. ***, Elbasan (apartamenti i përfutur nga privatizimi).

¹²⁹ Për muajin janar 2016 – paga bruto 2.683 euro, paga neto 1.701 euro; për muajin shkurt – paga bruto 2.683 euro, paga neto 1.701 euro, e kështu në vijim.

¹³⁰ Diferenca midis të ardhurave në shumën totale 24.187 euro (duke e përfshirë ndihmën e dërguar nga prindërit prej 2.500 euro) dhe koston së jetesës në shumën 20.792 euro.

3.75. Në përfundim, Komisioni çmon se personi i lidhur/nëna e subjektit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.482.311 lekë për pagesën e kështit të parë në datën 11.12.2006 për apartamentin në Elbasan, sipas tabelës me poshtë:

Tabela nr.3/1 – analiza financiare prindërit e subjektit, për pagesën e kështit të parë, periudha 1994-11.12.2006.

Përshkrim	Vlerë
Likuiditete në datë 11.12.2006	376,523
Total ndryshimi i likuiditeteve	376,523
Të ardhura babai nga pagat	748,193
Të ardhura babai nga pagat pranë "****" ShPK	0
Të ardhura babai nga pensioni	1,000,023
Të ardhura nëna nga pagat	2,677,015
Të ardhura nga interesat neto Banka Procredit	23,580
Total të ardhura	4,448,811
Shpenzime jetese	2,241,011
Dërgesa për djalin/D. M. për shkollimin	309,258
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	4,330
Pagesë kështi i parë për apartamentin në Elbasan	3,000,000
Total shpenzime	5,554,598
Balanca e fondeve (Të ardhura- likuiditete-shpenzime)	-1,482,311

3.76. Për sa më sipër, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit: (i) ka pasur marrëdhënie të vazhdueshme përdorimi të apartamentit që nga momenti i ndërtimit të tij; (ii) nëna e subjektit është transferuar në apartamentin ku banon subjekti në prill 2014, pas vdekjes së babait të subjektit¹³¹; (iii) emri i subjektit figuron në listën emërore të banorëve të paraqitur në datë 28.1.2009, nga investitori pranë UK Elbasan; (iv) kontrata e furnizimit me ujë është lidhur në emër të subjektit (jo të prindërve); (v) subjekti ka kontribuar në shumën 2.500.000 lekë për blerjen e këtij apartamenti, por nuk figuron të ketë të drejta pronësie, (vi) subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime mbi rrethanat e konstatuara në barrën e provës, rrethana që shoqërohen me mungesën e burimeve të ligjshme financiare të prindërve të tij për pagesën e kështit të parë në shumën 1.482.311 lekë – Komisioni çmon se krijohen dyshime të arsyeshme se pasqyrimi i emrit të babait të subjektit në kontratën e porosisë së datës 11.12.2006, e më pas i emrit të nënës së tij në kontratën e shitjes me kusht të datës 17.12.2014, bashkë me deklarin në deklaratën *Vetting* i të drejtës së banimit të tij dhe të pronësisë së nënës së tij, janë veprime në funksion të fshehjes së të drejtës së pronësisë së subjektit të rivlerësimit mbi apartamentin e sipërcituar, duke u gjendur në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

3.77. Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit se ka vetëm të drejta banimi dhe deklarimi i personit të lidhur/F. M. në deklaratën *Vetting* 2017 i të drejtës së pronësisë për apartamentin me sip. 112 m², me adresë lagjja "****", Elbasan, nuk bindin për vërtetësinë e tyre, dhe për rrjedhojë, Komisioni e vlerëson sjelljen e subjektit si përpjekje për të fshehur pasurinë në emër të prindërve, sipas parashikimit të gërmës "c" të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

¹³¹ Përgjigjet e pyetësorit nr.2.

PASURITË E PERSONAVE TË LIDHUR

Pasuritë e nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. F. M.

4. Përfituese nga privatizimi dhe trashëgimia ligjore e 4/12 pjesë e apartamentit me sipërfaqe 73 m², në Elbasan

4.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur F. M. ka deklaruar: “Përfituese si trashëgimtare ligjore e ¼ pjesë të pasurisë trashëgimore të luajtshme dhe të paluajtshme kudo që ajo ndodhet e të ndjerit bashkëshortit tim A. I. M.. Dhe përfitues nga privatizimi i banesës në vitin 1991 si bashkëshorte. Konkretisht, përfitues nga privatizimi dhe trashëgimia ligjore e 4/12 pjesë të pasurisë nr. ***, të apartamentit të banimit me sip. 73 m², lagjja “***” (ndryshuar lagjja “***”), Elbasan, p. ***, h. ***, ap. ***, z. k. ***, Elbasan. Pjesa takuese: 33%”. Si burim krijimi deklaron: “Përfituese nga privatizimi dhe nga dëshmia e trashëgimisë ligjore e bashkëshortit”. (Kjo pasuri është trajtuar në pikën 2 të vendimit).

5. Apartament me sipërfaqe 112 m², në lagjen “***”, Elbasan (kjo pasuri është trajtuar në pikën 3 të vendimit).

6. Depozitë me vlerë 710.000 lekë

6.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur/F. M. ka deklaruar: “Depozitë me nr. ***, në emër të F. M. në ProCredit Bank, filiali Elbasan, me gjendje llogarie aktive me interes bankar, vlera 710.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”. Nuk deklaron burim krijimi. Për vërtetimin e deklaramentit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues¹³².

6.2. ProCredit Bank¹³³ konfirmon depozitë në shumën 710.000 lekë në emër të personit të lidhur/F. M..

6.3. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të deklarojë burimin financiar të krijimit të depozitës së mësipërme të shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues. Në përgjigje¹³⁴, subjekti i rivlerësimit deklaron se kjo depozitë ka pasur si burim të ardhurat e prindërve nga pagat/pensionet dhe, nga biseda me nënën, këto të ardhura kanë qenë dhe nga para të dërguara në vazhdimësi edhe pas vdekjes së babait nga vëllezërit dhe motra e saj që jetojnë dhe punojnë prej shume vitesh jashtë Shqipërisë. Gjithashtu, një pjesë e tyre janë edhe nga të ardhurat që i ka dhënë subjekti dhe vëllezërit.

6.4. Më tej, subjekti i rivlerësimit shpjegon se pas vdekjes së babait nëna ka jetuar me të dhe shpenzimet e jetesës janë paguar prej tij, si dhe nga ndihma që kanë dërguar edhe vëllezërit.

6.5. Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion lidhur me të ardhurat nga vëllezërit dhe motra e nënës, si dhe nuk ka përcaktuar kontributin e dhënë nga vëllezërit e tij. Gjithashtu, këto burime nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 si burim për krijimin e kësaj depozite.

6.6. Komisioni analizoi lëvizjet ndër vite të llogarive të prindërve të subjektit pranë ProCredit Bank, për të evidentuar kronologjinë e krijimit të kësaj depozite, nga ku rezultuan transaksionet e paraqitura në tabelën vijuese.

¹³² Kthim përgjigje datë 26.1.2017, nga ProCredit Bank.

¹³³ Shkresë nr. *** prot., datë 3.2.2021.

¹³⁴ Email datë 5.9.2023.

Tabela nr. 4 – Kronologjia e transaksioneve bankare të prindërve në ProCredit Bank

Viti	Depozitime	Interesa	Komisione	Tërheqje	Gjendje në fund
2006	2,050,000	23,580	1,907	1,800,000	271,673
2007	-	9,036			280,709
2008	500,000	27,154			807,863
2009		48,701			856,564
2010		47,652			904,216
2011		39,479			943,695
2012		48,418	1,238	90,013	900,862
2013		47,784	1,541	45,000	902,105
2014		20,261	50	221,300	701,016
2015		11,900	1,800		711,116
2016			1,116		710,000
TOTAL	2,550,000	323,964	7,651	2,156,313	710,000

6.7. Sa më lart, Komisioni konstaton se kjo depozitë është krijuar me depozitim e vitit 2008, datë 14.6.2008, me vlerë 500.000 lekë, me përshkrimin “Derdhje për TD nga A. M.”, dhe, më tej, është shtuar me interesat bankarë, duke arritur shumën 710.000 lekë. Në vijim të kryerjes së analizës deri në datën 11.12.2006, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën pasuese, konkretisht për periudhën 12.12.2006 – 14.6.2008, për të verifikuar burimet e ligjshme të prindërve për kryerjen e këtij depozitimi në datën 14.6.2008.

Tabela nr. 5 – Analiza financiare e prindërve të subjektit, periudha 12.12.2006 – 14.6.2008

Përshkrim	Vlera
Ndryshim likuiditete bankë (përfshirë depozitim 500.000 lekë) ¹³⁵	450,740
Total ndryshimi i likuiditeteve	450,740
Të ardhura babai nga pensioni ¹³⁶	314,686
Të ardhura nëna nga pagat ¹³⁷	1,178,418
Të ardhura nga interesat ProCredit Bank	14,894
Total të ardhura	1,507,998
Shpenzime jetese ¹³⁸	484,335
Dërgesa për djalin/D. M. për shkollimin ¹³⁹	646,044
Total shpenzime	1,130,379
Balanca e fondeve (të ardhura - ndryshim likuiditete - shpenzime)	-73,121

6.8. Sa më lart, rezulton se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 73.121 lekë për krijimin e depozitës pranë ProCredit Bank.

6.9. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës dhe i kërkoi të paraqesë shpjegime në lidhje me konstatimin se *personi i lidhur/nëna e subjektit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 73.121 lekë për krijimin e depozitës pranë ProCredit Bank.*

6.10. Lidhur me këtë konstatim subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti shpjegime.

¹³⁵ Diferenca e gjendjes së llogarive bankare të prindërve në datën 14.6.2006 me gjendjen e llogarive bankare në datën 11.12.2006.

¹³⁶ Përllogaritur 1 muaj për vitin 2006, viti 2007 dhe 5 muaj për vitin 2008. Vlera mujore sipas përcaktimit në vërtetimin nr. ***, datë 4.9.2023, DRSSH Elbasan (paraqitur nga subjekti në pyetësorin nr. 1).

¹³⁷ Kreditime të pagave në llogarinë bankare të nënës pranë Intesa Sanpaolo Bank gjatë periudhës 12.12.2006 – 14.6.2008.

¹³⁸ Përllogaritur 0.6 muaj për vitin 2006, viti 2007 dhe 5 muaj për vitin 2008 (për 2 persona).

¹³⁹ Dërgesa nëpërmjet ProCredit Bank gjatë periudhës 12.12.2006 – 14.6.2008 (5.300 euro).

6.11. Në përfundim, Komisioni vlerëson se personi i lidhur/nëna e subjektit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 73.121 lekë për krijimin e depozitës pranë ProCredit Bank, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

❖ **Pasuritë e vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. D. M.**

Nga hetimi rezulton se shtetasi D. M./vëllai i subjektit të rivlerësimit figuron në certifikatën familjare të dorëzuar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, si dhe është deklaruar nga subjekti si pjesë e përbërjes familjare në këtë deklaratë. Gjithashtu, ky shtetas ka paraqitur formularin e deklaramit *Vetting* në cilësinë e personit të lidhur.

Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një shkresë sqaruese datë 14.1.2017, të shtetasit D. M., drejtuar ILDKPKI-së, ku, ndër të tjera, citohet: “[...] *jetoj që nga nëntori i vitit 2002 pothuajse pa ndërprerje në Gjermani. Unë nuk kam asnjë lidhje financiare me vëllain tim Hektor Mushi... Unë kam studiuar në Gjermani që nga viti 2005 deri në vitin 2015, kur mbarova studimet për informatikë. Gjatë kësaj kohe kam punuar periodikisht si student në firma të ndryshme. Që nga janari i vitit 2016 unë punoj me kohë të plotë tek firma “****” GmbH në rolin e informacionit [...]*”.

Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka paraqitur dokumentacion lidhur me të ardhurat e realizuara nga data 26.8.2003 e në vijim, për çdo vit kalendarik¹⁴⁰.

Në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vëllai i tij D. M. është ndarë “*de facto*” nga trangu familjar në dhjetor të vitit 2002, pasi është larguar për në Gjermani dhe qëndron atje në mënyrë të përhershme. Në datën 16.9.2019, nëpërmjet Dekretit nr. *** të Presidentit të Republikës është dekretuar mbarimi i shtetësisë shqiptare, datë në cilën shënohet edhe ndarja *de jure* nga trangu familjar.

Nga analizimi i lëvizjeve në pikat kufitare sipas sistemit TIMS rezulton se ky shtetas ka këto periudha qëndrimi në Shqipëri: (i) 29 ditë gjatë vitit 2007; (ii) 18 ditë gjatë vitit 2008; (iii) 11 ditë gjatë vitit 2009; (iv) 6 ditë gjatë vitit 2014; (v) 7 ditë gjatë vitit 2015; (vi) 14 ditë gjatë vitit 2017 etj.

Bazuar në nenin 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, shtetasi D. M. konsiderohet person i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe sipas nenit 32, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të krijuara.

Megjithatë, Komisioni vëren se: (i) ky shtetas ka qenë i punësuar në Gjermani që nga gushti i vitit 2003 e në vijim, për çdo vit kalendarik; (ii) nga sistemi TIMS rezulton se ky shtetas ka qëndruar në territorin shqiptar në periudha shumë të shkurtra.

Sa më sipër, konfirmohen deklaramet e subjektit lidhur me shkëputjen *de facto* të vëllait të tij/D. M. nga trangu familjar e, për rrjedhojë, Komisioni nuk kreu hetime të mëtejshme.

Më tej, Komisioni analizoi deklaramet e shtetasit D. M. në formularin e deklaramit të pasurisë, si vijon:

¹⁴⁰ (i) Të dhëna për të ardhurat për periudhën gusht 2003 – 2015 (në gjermanisht), (ii) të dhëna për të ardhurat për periudhën janar 2016 – janar 2017 pranë shoqërisë “****”; (iii) kontratë pune datë 19.12.2015 me palë “****” dhe D. M. (në gjermanisht).

7. Llogari rrjedhëse në vlerën 350 euro pranë * Bank**

7.1. Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur/D. M. ka deklaruar llogari rrjedhëse në *** Bank, M., datë 14.1.2017, në vlerën 350 euro. Pjesa takuese: 100%. Nuk ka deklaruar burim krijimi. Për vërtetimin e deklaramit, subjekti ka paraqitur një vërtetim nga *** Bank, ku konfirmohet se gjendja e llogarisë në datën 14.1.2017 ka qenë 351,61 euro. Sa më lart, përputhet deklarimi me dokumentacionin e administruar.

8. Bashkëpronar në apartamentin e privatizuar nga babai në Elbasan

8.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur/D. M. ka deklaruar: “*Apartament në lagjen “***”, p. ***, kati i pestë, me sip. 70 m², trashëguar nga babai*”. (Kjo pasuri është trajtuar në pikën 2 të vendimit).

9. Kredi në vlerën 5.500 euro në * Bank**

9.1. Në seksionin e detyrimeve, ky shtetas ka deklaruar kredi bankare në vlerën 5.500 euro, pranë *** Bank, M.. Shuma e detyrimit të mbetur pa shlyer 5.283 euro.

9.2. Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një vërtetim të lëshuar nga *** Bank, datë 10.1.2017, ku vërtetohet se shtetasi D. M. ka marrë kredi në shumën 5.500 euro, në datën 30.5.2016, gjatë vitit janë shlyer 416,2 euro dhe gjendja e detyrimit në datën 31.12.2016 ka qenë 5.283 euro.

9.3. Sa më lart, përputhet deklarimi me dokumentacionin e administruar.

KONSTATIME TË TJERA

10. Adresa e banimit për periudhën 1999 – 2004, në Pogradec

10.1. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: “*Nga viti 1999 me emërimin në Prokurorinë e Rrethit Pogradec kam banuar nga ky vit deri në vitin 2004 në hotel “***”, Pogradec, me adresë Lagja Nr. *** rruga “***” Unaza, Pogradec, hotel në pronësi të shtetasit A. M.. Gjatë kësaj periudhe nuk kam paguar qira dhe kam qëndruar pa pagesë në ambientet e këtij hoteli*”.

10.2. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁴¹, i kërkoi subjektit të sqaronte marrëdhënien e tij me shtetasin A. M.. Në përgjigje¹⁴², subjekti deklaroi: “*Me shtetasin A. M. jam njohur nëpërmjet njerëzve të familjes sime që janë në krushqi me këtë shtetas, të cilët, kur shkova si prokuror në Pogradec më rekomanduan që të qëndroja në shtëpinë e tij, pasi në atë kohë nuk njihja njerëz të tjerë... pa probleme me ligjin që të më mundësonin në momentet e para fjetjen... Realisht unë kam qëndruar në ambientet e shtëpisë së shtetasit A. M., ambiente të cilat nga ana strukturore ishin pjesë përbërëse e godinës ku ndodheshin edhe dhomat e hotelit*”.

10.3. Subjekti paraqiti 3 foto të ambientit të jashtëm të godinës, ku përfshihen edhe dhomat e hotelit, si dhe ambientet e banesës së këtij shtetasi.

10.4. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasin A. M. dhe nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ishte në kushtet e konfliktit të interesit¹⁴³.

¹⁴¹ Email datë 27.7.2023.

¹⁴² Email datë 5.9.2023.

¹⁴³ Shkresë nr. *** prot., datë 2.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të JP Korçë; shkresë nr. *** prot., datë 2.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të JP Elbasan.

10.5. Sa më sipër, nuk u konstatuan problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit.

11. Apartament në emër të shtetasës I. B. në *, Kavajë**

11.1. Nga informacioni i administruar nga FSHU-ja¹⁴⁴ rezulton se me gjeneralitetet I. B. identifikohet 1 abonent me kontratën e furnizimit nr. ***, në instancën Kavajë.

11.2. Lidhur me informacionin e administruar nga OSSHE-ja se I. B. figuron abonent në instancën ***-Kavajë, subjekti, në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 16.2.2016, ka deklaruar: *“Dua të shpjegoj se I. B. (bashkëjetuesja ime) nuk zotëron asnjë apartament tjetër as përpara as pas bashkëjetesës në emrin e saj dhe të familjarëve të saj. Në dijeninë time ekziston një shtetase tjetër me të njëjtat gjeneralitete I. S. B. e datës 25.9.1974, për të cilën po ju dorëzoj kopje të nxjerrë nga sistemi TIMS. Pra, bashkëjetuesja ime I. S. B. nuk ka asnjë lidhje me kontratën e OSSHE-së të lidhur në ***”.*

11.3. Nga shqyrtimi i të dhënave të sistemit TIMS të paraqitur nga subjekti në ILDKPKI, rezulton se shtetasja I. S. B. është e datëlindjes 25.9.1974, ndërsa sipas certifikatës së gjendjes civile të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* bashkëjetuesja e subjektit figuron me gjeneralitetet I. S. B., e datëlindjes 12.1.1979.

11.4. Megjithatë, për të shteruar çdo paqartësi lidhur me identitetin e shtetasës I. B. që figuron pronare e apartamentit në ***, Komisioni kërkoi nga FSHU-ja dokumentacionin mbi bazë e të cilit është bërë regjistrimi i kontratës së furnizimit me energji elektrike në emër të shtetasës I. B. dhe vënien në dispozicion të kartës së identitetit të abonentit.

11.5. Në përgjigje, FSHU-ja¹⁴⁵ informon se nuk disponon dokumentacion për shkak të keqmenaxhimit të shoqërisë ndër vite. Gjithashtu, FSHU-ja¹⁴⁶ ushtroi kontroll në vend dhe mbajti procesverbalin e datës 21.6.2023, ku konstatoi se abonentit nuk gjendet në objekt dhe, si pasojë, është i pamundur identifikimi i tij.

11.6. Në këto kushte, Komisioni kërkoi nga ASHK Drejtoria Vendore Kavajë vënien në dispozicion të dokumentacionit të regjistrimit të pasurisë apartament me vendndodhje në ***, në emër të shtetasës I. B..

11.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga ASHK Kavajë¹⁴⁷ rezulton se pasuria apartament me nr. pasurie ***, z. k. ***, *** Kavajë, figuron e regjistruar në emër të shtetasës I. S. B., e datëlindjes 25.9.1974, me nr. personal ***.

11.8. Në përfundim, Komisioni konstaton se pasuria apartament me vendndodhje në ***, Kavajë, nuk është në pronësi të bashkëjetueses së subjektit, znj. I. S. B..

12. Analiza financiare

12.1. Komisioni kreu analizën financiare për: (i) periudhën dhjetor 1995 – 2016, duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin, bashkëjetuesen dhe vajzën; (ii) periudhën 1994 – 2016, duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve të subjektit¹⁴⁸. Analiza financiare u paraqit e përmbledhur dhe subjektit

¹⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2021.

¹⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 26.5.2023.

¹⁴⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 26.6.2023.

¹⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 8.7.2023.

¹⁴⁸ Duke qenë se prindërit e subjektit nuk kanë pasur detyrim për plotësim të deklaratës periodike vjetore të interesave privatë, analiza financiare nuk mund të kryhet në fund të çdo viti kalendarik, siç kryhet për vetë subjektin, por në vijimësi, duke mbartur në vitin pasardhës edhe balanca të mundshme pozitive që mund të rezultojnë nga vitet paraardhëse.

të rivlerësimit iu vendos në dispozicion aneksi nr. 1, me emërtimin “Analiza financiare e detajuar” dhe Aneksi nr. 2, me emërtimin “Metodika e analizës financiare”.

12.2. Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën totale 5.150.956 lekë, e detajuar si në vijim: (a) subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 3.510.619 lekë, për blerjen e apartamentit në Pogradec; (b) personi i lidhur/nëna e subjektit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 1.567.206 lekë, për pagesën e këstit të parë në datën 11.12.2006 për apartamentin në Elbasan; (ii) Personi i lidhur/nëna e subjektit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 73.121 lekë për krijimin e depozitës pranë ProCredit Bank.*

12.3. Lidhur me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime dhe prova, sikurse është trajtuar në pikat e mësipërme të vendimit.

12.4. Pas arsyesimit përkatës në këtë vendim, analiza financiare e përmbledhur paraqitet në vijim.

Tabela nr. 6 – Analiza financiare (subjekti, bashkëjetuesja dhe vajza)

Periudha/viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Balanca negative për krijimin e pasurive
Dhjetor 1995 - 2003	-	-	4,211,018	-	888,878	3,322,140	
2004	2,000,000	-	1,325,232	-	937,728	-1,612,496	-1,612,496
2005	-	35,601	1,268,718	-	296,441	936,677	
2006	-	- 22,917	1,152,146	-	370,730	804,333	
2007	-	45,527	1,137,478	-	529,471	562,480	
2008	-	- 56,327	1,328,601	-	687,576	697,352	
2009	-	55,702	1,436,980	-	414,661	966,617	
2010	-	- 86,545	1,410,297	-	488,982	1,007,861	
2011	-	64,464	1,393,587	500,000	1,056,407	772,716	
2012	-	- 44,144	1,555,445	-	726,685	872,904	
2013	-	18,381	1,536,167	-	1,073,699	444,087	
2014	-	- 58,914	1,788,961	3,000,000	4,182,745	665,130	
2015	-	- 1,225	1,805,317	-	1,665,574	140,968	
2016	-	103,762	1,702,296	-	1,064,682	533,852	
TOTAL	2,000,000	53,364	23,052,244	3,500,000	14,384,258	10,114,622	-1,612,496

Tabela nr. 7 – Analiza financiare (prindërit e subjektit)

Periudha/viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Balanca vjetore	Gjendje progresive	Balanca negative për krijimin e pasurive
Periudha 1994-2006								
1994-1999	0	0	1,283,071		846,827	436,244	436,244	
2000	0	0	211,020		216,000	-4,980	431,264	
2001	0	0	276,217		187,728	88,489	519,753	
2002	0	0	223,823		187,728	36,095	555,848	
2003	0	0	429,875		187,728	242,147	797,995	
2004	0	68,596	477,139		187,728	220,815	1,018,810	
2005	0	51,731	622,444		219,114	351,599	1,370,409	
2006	3,000,000	219,959	921,069		532,701	-2,831,592	-1,461,182	-1,482,311
Periudha 2007-2016								
2007	0	-24,256	1,020,785		710,874	334,167	334,167	
2008	0	503,847	1,113,646		717,929	-108,130	226,036	-73,121
2009	0	53,760	1,217,529		421,384	742,386	968,423	
2010	0	30,828	1,391,722		487,007	873,887	1,842,309	
2011	0	76,829	576,815		533,244	-33,258	1,809,051	
2012	0	-80,432	752,486		282,048	550,870	2,359,921	
2013	0	22,754	631,683		282,048	326,880	2,686,801	
2014	0	-174,442	400,804		102,981	472,265	3,159,066	
2015	0	65,200	323,820		470,670	-212,050	2,947,017	
2016	0	163,493	312,249		331,810	-183,055	2,763,962	

12.5. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në një vlerë totale prej 3.168.928 lekësh për blerjen e pasurive, në momentin e krijimit të tyre duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga shkronja “b” e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Përfundimet e Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë

13. Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin në këto përfundime:

13.1. Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 92,3 m², në qytetin e Pogradecit subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burime të ligjshme financiare në shumën 1.612.496 lekë për blerjen e pasurisë apartament në Pogradec, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

13.2. Lidhur me pasurinë apartament me sip. 112 m², në lagjen “***”, Elbasan, deklarimi i subjektit të rivlerësimit se ka vetëm të drejta banimi dhe deklarimi i personit të lidhur/F. M. në deklaratën Vetting 2017 i të drejtës së pronësisë për apartamentin me sip. 112 m², me adresë lagjja “***”, Elbasan, nuk bindin për vërtetësinë e tyre, por nisur nga të dhënat e pasqyruara paragrafin 3.76, si më lart, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur rrethana jo të vërteta, e për rrjedhojë, Komisioni e vlerëson sjelljen e subjektit si përpjekje për të fshehur pasurinë në emër të prindërve, sipas parashikimit të gërmës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

13.3. Personi i lidhur/nëna e subjektit ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në një vlerë totale prej 1.556.432 lekësh për blerjen e pasurive, në momentin e krijimit të tyre, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga shkronja “b” e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzion lidhur me vlerësimin e pasurisë

14. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm

të pasurisë dhe gjendet në kushtet e nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “ç” në lidhje me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim AKSIK-ja ka dërguar një raport me shënimin “Sekret”.

2. Komisioni¹⁴⁹ kërkoi nga AKSIK-ja deklasifikimin e raportit mbi kontrollin e figurës së z. Hektor Mushi, si dhe përditësimin e raportit me informacionet shtesë. AKSIK-ja¹⁵⁰, me shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2023, ka përcjellë raportin për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 5.10.2023, të KDZH-së, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016¹⁵¹.

3. Sipas raportit, subjekti i rivlerësimit Hektor Mushi: (a) gjatë periudhës në të cilën ushtronte detyrën si prokuror dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive; (b) ka të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, të shfaqura në formën e ndikimit të paligjshëm me qëllim favorizimin e pozitës së individëve të caktuar.

3.1. Nga të dhënat e autoriteteve verifikuese kërkohet të merren parasysh elemente që evidentojnë përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme në formën e korrupsionit gjatë ushtrimit të detyrës, pasi disponohen informacione për implikim të subjektit të rivlerësimit në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë në periudha të shkëputura kohore në më shumë se një rast nëpërmjet premtimit, kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi të çfarëdolloj përfitimi të parregullt për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me detyrën e tij funksionale.

3.2. Si konkluzion, Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Hektor Mushi.

4. Bazuar në raportin e përditësuar të dërguar nga AKSIK-ja, Komisioni kreu hetim administrativ pranë organeve verifikuese dhe kërkoi informacion shtesë për subjektin e rivlerësimit.

5. Në vijim, pranë Komisionit është paraqitur denoncimi nr. *** prot., datë 11.6.2019, i shtetasit A. H., i cili denoncon subjektin e rivlerësimit se shoqërohet me shtetasit Sh. dhe M. Q., persona të njohur në Elbasan për shkak të së shkuarës kriminale dhe me shtetasin Th. B., një individ që ka krijuar pasuri nga trafiku i drogës. Ky denoncim është trajtuar në vijim.

6. Referuar informacioneve të organeve ligjzbatuese, Komisioni administroi nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan¹⁵² 5 vendime gjyqësore (dhe procesverbalet e seancave gjyqësore me të akuzuar G. M.) dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës

¹⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 8.6.2023.

¹⁵⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 5.10.2023.

¹⁵¹ Vënë në dispozicion të subjektit të rivlerësimit me *email*-in e datës 12.12.2023.

¹⁵² Shkresat nr. *** prot., datë 26.9.2023 dhe nr. *** prot., datë 16.10.2023.

së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan¹⁵³ 13 procedime penale ndaj shtetasve për të cilët dyshohet se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar të dyshuarin/personin nën hetim/të pandehurin apo ka kryer veprimtari të kundërligjshme të shfaqur në formën e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm, me qëllim favorizimin e pozitës së tyre, analiza e të cilave është pasqyruar më poshtë.

Analizimi i kontakteve të subjektit të rivlerësimit me shtetasit Sh. e M. Q. dhe Th. B.

Lidhur me shtetasit Sh. dhe E. Q., nga hetimi i Komisionit nuk rezultuan të dhëna të mëtejshme, që ndikonin në kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit pas hetimit të kryer.

Lidhur me shtetasin Th. B.

7. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 3¹⁵⁴, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të deklaronte: (i) nëse ka pasur kontakte të papërshtatshme faktike, në formën e një takimi, komunikimi elektronik ose çfarëdolloj mënyre takimi të qëllimshme, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar gjatë viteve 2017 – 2023; (ii) nëse ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar gjatë viteve 2017 – 2023; (iii) nëse njihet me shtetasin Th. B. dhe, nëse po, të përshkruajë marrëdhënien me këtë shtetas; (iv) të japë deklaratimet e tij lidhur me kriterin e figurës.

8. Në përgjigje¹⁵⁵, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në dijeninë e tij nuk di që ndaj tij të jetë filluar ndonjë procedim penal me emër të regjistruar apo jo të regjistruar apo të jetë regjistruar ndonjë kallëzim penal për të cilin edhe mund të jetë vendosur mosfillim procedimi penal. Për periudhën kohore të sipërcituar, vijon subjekti i rivlerësimit, nuk ka pasur asnjë njoftim sipas Kodit të Procedurës Penale se ndaj tij zhvillohet ndonjë hetim penal. Në vijim deklaroi se në dijeninë e tij as ai apo pjesëtarët e tjerë të afërm të familjes së tij nuk kanë pasur kontakte të papërshtatshme faktike, në formën e një takimi, komunikimi elektronik ose çfarëdolloj mënyre takimi të qëllimshme me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar gjatë viteve 2017 – 2023 dhe as në periudhën paraardhëse. Gjithashtu, deklaroi se në dijeninë e tij as ai apo pjesëtarët e tjerë të afërm të familjes nuk kanë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar gjatë viteve 2017 – 2023 dhe në periudhën paraardhëse.

9. Lidhur me shtetasin Th. B., subjekti ka deklaruar se: *“Shtetasin Th. B. e njoh prej shume vitesh, që në kohën që jam njohur me bashkëjetuesen I. B., në vitin 1999, pasi ai dhe familja e tij kanë lidhje miqësore dhe familjare me familjen e S. B., babait të bashkëjetueses... Ndërkohë që shtetasi V. Gj., bashkëshorti i shtetases A. Gj. (B.), motrës së bashkëjetueses sime, është kushëri i parë me shtetasin Th. B., pasi e ka djalin e hallës. Gjithashtu, me shtetasen A. Gj. (B.)... që përpara se unë të njihja bashkëshorten time, kam pasur lidhje shoqërore të mëparshme, pasi kemi pasur shoqëri që në kohën që studionim në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës në vitet 1991 – 1995. Gjithashtu, bashkëshortja e shtetasit Th. B., shtetasja E. U., është lidhje e jona shoqërore, pasi me shtetasen A. Gj. (B.) kanë qenë bashkë në shkollën e mesme në Elbasan. Për shkak të këtyre lidhjeve jam njohur edhe unë me shtetasin Th. B. dhe marrëdhëniet e mia me të kanë qenë vetëm në kuadër të këtyre lidhjeve familjare dhe shoqërore. Në punën time të përditshme unë nuk kam pasur ndonjë situatë konflikti interesi në*

¹⁵³ Shkresat nr. *** prot., datë 16.10.2023 dhe nr. *** prot., datë 17.10.2023.

¹⁵⁴ Email datë 6.10.2023.

¹⁵⁵ Email datë 10.10.2023.

lidhje me këtë shtetas, ashtu si edhe në jetën e përditshme as unë dhe as familjarët e mi nuk kemi pasur me të ndonjë lidhje interesash ekonomike”.

10. Në përfundim, lidhur me kriterin e figurës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vjen nga një familje intelektualësh, ku babai i tij i ndjerë dhe nëna e tij kanë qenë inxhinierë të nderuar, ashtu si edhe vëllezërit e tij që janë nënshtetas gjermanë të arsimuar me arsim të lartë në Gjermani, ku edhe aktualisht punojnë. Gjithashtu, vijon subjekti, asnjë nga familjarët e tij, si nga nëna e babai dhe nga bashkëjetuesja nuk rezultojnë të jenë dënuar për ndonjë veprë penale. Në vijim deklaroi se detyrën e tij si prokuror është përpjekur që ta kryejë me ndershmëri dhe përgjegjshmëri dhe në jetën e përditshme ka ruajtur normat morale dhe etike në marrëdhëniet me të tretët, për të mos cenuar figurën e tij dhe të familjes. Më pas deklaroi se gjatë periudhës kohore që ka punuar si oficer i policisë gjyqësore, si prokuror, drejtues prokurorie në Prokurorinë e Rrethit Pogradec, si dhe si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku punon edhe sot, jeta e tij shoqërore sociale ka qenë shumë e kufizuar, kjo për shkak të detyrës dhe karakterit të tij.

11. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar¹⁵⁶ informon se ndaj shtetasit Th. B. etj., në datën 1.1.2009, është regjistruar procedimi penal nr. ***, në ish-Prokurorinë e Krimeve të Rënda Tiranë për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal. Pas kryerjes së hetimeve në lidhje me këtë procedim penal është vendosur pushimi i hetimeve në lidhje me shtetasin Th. B., në datën 10.10.2009, dhe pezullimi i procedimit penal nr. ***, viti 2009.

12. Ligji nr. 84/2016, në nenin 13, pika 15¹⁵⁷ parashikon se person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192/2009, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.

13. Ligji nr. 10192/2009, në pikën 1 të nenit 3¹⁵⁸ ka përcaktuar si një nga rastet e zbatimit të dispozitave të tij pasuritë e personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në *indicie*, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, “Trafikimi i narkotikëve”.

14. Në rastin konkret rezulton se ndaj shtetasit Th. B. është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2009, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal dhe ky procedim është pushuar, por, pavarësisht këtij fakti, për sa kohë që ky shtetas nuk është deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë, sipas parashikimeve të pikës 15 të nenit 3

¹⁵⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 26.10.2023.

¹⁵⁷ Ligji nr. 84/2016, neni 3 parashikon: “15. Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet”.

¹⁵⁸ Ligji nr. 10192/2009, neni 3 parashikon: “1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, siç përcaktohet në pikën 2, të këtij neni, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në *indicie*, për:... c) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal”.

të ligjit nr. 84/2016, konsiderohet si “person i përfshirë në krimin e organizuar” e, për pasojë, konsiderohet kontakt i papërshtatshëm.

15. Referuar deklaratës për kontrollin e figurës të dorëzuar sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti nuk e ka deklaruar marrëdhënien me shtetasin Th. B., por e ka deklaruar vetëm pas pyetësorit nr. 3 të dërguar nga Komisioni.

16. Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me konstatimin se: (i) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kontaktin me shtetasin Th. B., në kushtet kur vetë subjekti konfirmon marrëdhënien me këtë shtetas dhe nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti ka kontakt;* (ii) *Shtetasi Th. B. është kontakt i papërshtatshëm, pasi: (a) ndaj këtij shtetasi është regjistruar procedimi penal nr .3, viti 2009, për një vepër penale të parashikuar nga pika 1 e nenit 3 e ligjit nr. 10192/2009; (b) ky shtetas nuk është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.*

17. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁵⁹, subjekti i rivlerësimit shpjegon se nuk ka pasur dijeni as ai, as personat e tjerë familjarë apo rreth krushqie për procedimin penal në ngarkim të shtetasit Th. B., në janar të vitit 2009 nga ish-Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, por është vënë në dijeni vetëm pas ardhjes së raportit nga Komisioni. Gjithashtu, sqaron se pas pyetësorit nr. 3 ka dhënë shpjegime të detajuara për marrëdhënien me këtë shtetas dhe në çfarë rrethanash është njohur dhe, sikurse ka shpjeguar, nuk e ka rreth shoqëror të tijin këtë shtetas, por të njohur nga rrethi i krushqisë nga bashkëjetuesja e tij I. B. e, për këtë shkak, nuk ka pasur kontakte personale, por vetëm rastësore, si dhe nuk ka pasur takime personale, komunikime elektronike e, aq me tepër, takime të qëllimshme. Më tej deklaroi se njohja me këtë shtet nuk është shoqëri personale me kontakte të qëllimshme, por thjesht indiferente për shkak të krushqisë.

18. Në vijim, pasi citon pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, sqaron se në interpretim të kësaj dispozite ligjvënësi, nga rastet e pushimit të çështjes penale nga organi i akuzës, përjashton vetëm një pikë kur procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet. Pra, të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale, që kanë të bëjnë me rastet e pushimit të çështjes, ligjvënësi nuk i përfshin në ato raste që personin ta përfshijë në krimin e organizuar.

19. Më pas shpjegon se në kohën kur është vendosur pushimi i çështjes nga organi i akuzës pushimi i çështjes në përfundim të hetimit ka qenë e drejtë ekskluzive e prokurorit të çështjes dhe nuk dërgohej kërkesë për t’u pushuar në gjykatë. Pra, në referim të këtyre dispozitave del në mënyrë të qartë se ligjvënësi përjashtimin e personave që marrin pafajësi me vendim gjyqësor të formës së prerë e përdor për rastet kur nuk pushohet çështja nga organi i akuzës në përfundim të hetimeve apo në çdo moment të procedimit dhe në lidhje me rastet kur organi procedues vendos pushimin, ligjvënësi bën përjashtimin e vetëm një pike siç është shprehur më sipër.

¹⁵⁹ Email datë 7.12.2023.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

20. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën për kontrollin e figurës; (ii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iii) shpjegimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton si më poshtë:

21. Në pikat 3 dhe 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës përcaktohet se: “3. Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. 4. [...] Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklaratime të pasakta ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

22. Në pikën 3 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se: “Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6 të këtij neni dhe rrethanat lehtësuese, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të këtij neni. Vlerësimi duhet të përmbajë rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese të këtij konstatimi. Nëse vlerësimi nuk përmban elementet e parashikuara në këtë paragraf, konsiderohet i paplotë”.

23. Në funksion të kësaj analize, trupi gjykues analizoi pyetjet e parashtruara: (i) A konsiderohet z. Th. B. person i përfshirë në krimin e organizuar?; (ii) A konsiderohet ai kontakt i papërshtatshëm për subjektin?; (iii) A kemi të bëjmë me deklaratim të pamjaftueshëm nga ana e subjektit në deklaratën e kontrollit të figurës?; (iv) A kemi fshehje të faktit nga ana e subjektit? i) A konsiderohet shtetasi Th. B. person i përfshirë në krimin e organizuar?

24. Në pikën 15 të nenit 3 të ligji nr. 84/2016 parashikohet se: “Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë [...]”. Në veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, në të cilin referon pika 15 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, janë, ndër të tjera, edhe krimet e parashikuara në nenin 283/a të Kodit Penal”.

25. Neni 283/a i Kodit Penal parashikon si vepër penale importimin, eksportimin, tranzitimin dhe tregtimin, në kundërshtim me ligjin, të substancave narkotike ose psikotrope, si dhe të farërave të bimëve narkotike.

26. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar¹⁶⁰ informon se ndaj shtetasit Th. B. etj., në datën 1.1.2009 është regjistruar procedimi penal nr. ***, në ish-Prokurorinë e Krimeve të Rënda Tiranë për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal. Pas kryerjes së hetimeve në lidhje me këtë procedim penal është vendosur pushimi i hetimeve në lidhje me shtetasin Th. B. në datën 10.10.2009 dhe pezullimi i procedimit penal nr. ***, viti 2009.

¹⁶⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 26.10.2023.

27. Pra, nga informacioni i administruar nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar rezulton se në kuptim të përcaktimit që neni 3 i ligjit nr. 84/2016, në pikën 15 të tij bën për personat e përfshirë në krimin e organizuar, shtetasi Th. B. konsiderohet person i përfshirë në krimin e organizuar.

ii) A konsiderohet shtetasi Th. B. kontakt i papërshtatshëm i subjektit të rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016?

28. Sipas nenit 38, pika 4: “Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, janë kur:

[...] ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar; [...] d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës”.

29. Kjo dispozitë përcakton qartë që lidhja e ngushtë e subjektit me një person të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe marrja pjesë në takime me këta persona janë fakte të mjaftueshme për ta konsideruar kontakt të papërshtatshëm.

30. Nga analizimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ konstatohet se në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrëdhënien e krushqisë së bashkëshortes së tij me shtetasin Th. B., marrëdhënien shoqërore me bashkëshorten e këtij shtetasi e, më pas, marrëdhëniet familjare dhe shoqërore me këtë shtetas, ndërsa në përgjigje të rezultateve të hetimit deklaroi se nuk ka pasur kontakte të qëllimshme, por thjesht indiferente për shkak të krushqisë. Për pasojë, deklarimi i subjektit të rivlerësimit për kontakte indiferente duket jobindës.

31. Nga sa më lart, në raport edhe me nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmon se shtetasi Th. B., për efekt të ligjit nr. 84/2016, është person i përfshirë në krimin e organizuar dhe konsiderohet kontakt i papërshtatshëm i subjektit, fakt të cilin ky i fundit kishte detyrimin që ta deklaronte në deklaratën për kontrollin e figurës. E për pasojë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar duke u gjendur në kushtet e pikës 3, të nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe, gërmës “ç”, të pikës 4, të nenit 38, të ligjit nr.84/2016

iii) A kemi të bëjmë me deklaram të pamjaftueshëm nga ana e subjektit në deklaratën e kontrollit të figurës? (iv) A kemi të bëjmë me fshehje të faktit?

32. Sikurse u analizua më lart, neni DH i Kushtetutës përcakton detyrimin e subjektit për të plotësuar dhe dorëzuar personalisht formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, duke e plotësuar në mënyrë të saktë, të plotë dhe me vërtetësi.

33. Subjekti e ka plotësuar dhe dorëzuar këtë deklaratë, duke mos deklaruar kontaktin me shtetasin Th. B., të cilit i është pushuar vepra penale sipas ligjit për krimin e organizuar, sikurse përcaktohet në pikat e pjesës 5 të shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016. Ndërkohë, me nënshkrimin e deklaramit, subjekti deklaroi se është i vetëdijshëm që mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaramit për kontrollin e figurës mund të passjellë shkarkimin e tij nga detyra, sipas ligjit nr. 84/2016.

34. Sipas pikës 6 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, rasti kur subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme, është një ndër rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm.

35. Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka arsyetuar se: *“Pamjaftueshmëria e deklarimit, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të lidhet vetëm me lënien e vendeve bosh në formularin e deklarimit përkatësisht sipas kriterit, por ka të bëjë me plotësimin e formularit në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, që në momentin e vlerësimit nga grupet e kontrollit, të konkludohet në lidhje me përshtatshmërinë ose papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës¹⁶¹”.*

36. Pra, plotësimi i formularit në mënyrë jo të saktë dhe të vërtetë konsiderohet pamjaftueshmëri e deklarimit, pra deklarimi nuk konsiderohet i plotë, prandaj trupi gjykues vlerëson se në rastin konkret fakti që subjekti nuk e ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit kontaktin me shtetasin Th. B., ndonëse, siç deklaroi subjekti, ka lidhje familjare dhe shoqërore, bën që formulari i deklarimit të konsiderohet jo i plotë dhe i besueshëm.

37. Komisioni analizoi të gjitha shpjegimet e sipërcituara të subjektit, ku ka pretenduar se *nuk ka pasur dijeni as ai, as personat e tjerë familjarë apo rreth krushqie për procedimin penal në ngarkim të shtetasit Th. B., në muajin janar të vitit 2009 nga ish-Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda*. Komisioni vëren se sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit¹⁶², personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka lidhje të hershme krushqie me shtetasin Th. B., gjithashtu edhe subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrëdhënien shoqërore të hershme me bashkëshorten e këtij shtetasi dhe është njohur me këtë shtetas për shkak të këtyre lidhjeve.

38. Në këto rrethana, duke marrë në konsideratë: (i) njohjen familjare dhe shoqërore të subjektit të rivlerësimit me shtetasin Th. B., që nënkupton pjesëmarrje reciproke në ngjarje me rëndësi; (ii) faktin që banojnë në të njëjtin qytet, me përmasa gjeografike të vogla dhe me popullsi pothuajse homogjene; (iii) natyrën e detyrës që ushtron subjekti i rivlerësimit – Komisioni krijoi bindjen se qëndrimi i subjektit për ta kanalizuar dijeninë nën lidhjen e krushqisë për shkak të bashkëshortes përbën në thelb një përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të fshehur marrëdhënien me këtë shtetas, në kuptim të nenit DH, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës.

39. Sa më sipër, Komisioni çmon se padijenja e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit është jobindëse e, për pasojë, nuk gjen zbatim rrethana lehtësuese e parashikuar në shkronjën “c” të pikës 5 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

40. Në përfundim, pasi analizoi të gjitha faktet si më lart, Komisioni vlerëson se shtetasi Th. B., për efekt të ligjit nr. 84/2016, është person i përfshirë në krimin e organizuar dhe konsiderohet kontakt i papërshtatshëm i subjektit, fakt të cilin subjekti kishte detyrimin ta deklaronte në deklaratën e plotësuar për kontrollin e figurës.

41. Më tej, *lidhur me interpretimin e pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016*, Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit në analizën e tij i mëshon përmbajtjes së fjalisë së dytë të kësaj pike, duke anashkaluar parashikimet e fjalisë së parë, që përcakton në mënyrë të qartë se: *“15 “Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar*

¹⁶¹ Pika 44.1 e vendimit nr. 2/2019(JR) të subjektit të rivlerësimit A. Z.

¹⁶² Në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009... me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë”. Në fjalinë e dytë, duke përdorur lidhësen “edhe”, ligjvënësi ka bërë plotësimin e fjalisë së parë, duke qartësuar edhe rastet specifike kur procedimi penal i filluar ndaj personit të përfshirë në krimin e organizuar pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet ose deklarohet i pafajshëm nga gjykata, pasi vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose dënohet. Në këtë kuptim, Komisioni çmon se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit nuk bazohet në prashikimet e pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

42. Në vijim, në analizë të kërkesave të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016 lidhur me kontrollin e figurës, rezulton e provuar se: (i) subjekti i rivlerësimit ka kontakte/marrëdhënie familjare/shoqërore me shtetasin Th. B., e konfirmuar edhe nga vetë ai; (ii) në vitin 2009, ndaj shtetasit Th. B. ka pasur një regjistrim procedimi penal për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, i cili është pushuar; (iii) vepra penale e parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal përfshihet në veprat penale të parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192/2009; (iv) nuk rezulton që shtetasi Th. B. të jetë deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë; (v) shtetasi Th. B. në kuptim të dispozitave të ligjit nr. 84/2016 konsiderohet person i përfshirë në krimin e organizuar; (vi) subjekti në deklaratën për kontrollin e figurës, të dorëzuar sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, nuk e ka deklaruar marrëdhënien me këtë shtetas.

43. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti shpjegime apo prova të mjaftueshme për të kundërshtuar rezultatet e hetimit, sikurse është arsyetuar më lart, Komisioni çmon se: (i) marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me shtetasin Th. B. është kontakt i papërshtatshëm e, për pasojë, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit DH, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës; (ii) deklarimi i subjektit në formularin e deklaramit të figurës sipas parashikimeve të shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016 nuk është i plotë, pasi nuk ka deklaruar kontaktin me shtetasin Th. B..

44. Në përfundim, trupi gjykues, për sa u arsyetua më lart, vlerwson se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar duke u gjendur në kushtet e pikës 3, të nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe, germës “ç”, të pikës 4, të nenit 38, të ligjit nr.84/2016; (ii) ka bërë deklaramit të pamjaftueshëm lidhur me kontrollin e figurës në formularin sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, duke fshehur kontaktin me shtetasin Th. B. si person i përfshirë në krimin e organizuar, referuar pikës 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, duke u gjendur në kushtet e pikave 2, 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Çështjet penale për të cilat dyshohet se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar të dyshuarin/personin nën hetim/të pandehurin

45. Referuar dokumentacionit të administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për çështje penale si poshtë:

46. Në lidhje me çështjen penale të gjykuar me vendimin nr. *, datë 18.1.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan,** Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: (i) *Subjekti ka marrë vendimin e datës 27.7.2021 për mosfillimin e procedimit penal, pa kontrolluar veprimet hetimore sipas parashikimit të nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale, pasi akti i ekspertimit mjekoligjor nuk ka marrë në konsideratë kartelën mjekësore të Spitalit Universitar të Traumës Tiranë, në kushtet kur i dëmtuari është*

transportuar pranë këtij spitali; (ii) Subjekti, me marrjen e vendimit të datës 27.7.2021 për mosfillimin e procedimit penal, ka favorizuar shtetasen e dyshuar K. B..

47. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁶³, subjekti i rivlerësimit shpjegon se pavarësisht konstatimeve të Komisionit është arritur në përfundimin se si akti i ekspertimit i kryer nga eksperti mjekoligjor pranë Spitalit Rajonal Elbasan ashtu edhe konkluzionet e ekspertëve të IML-së Tiranë, pas kryerjes së riekspertimit, janë të njëjtë. Për këtë arsye edhe gjykata ka vendosur pushimin e çështjes, duke iu referuar vetëm konkluzioneve të aktit të ekspertimit mjekoligjor. Sa më lart, pretendon se vendimmarrja e tij për mosfillimin e procedimit është e drejtë.

Analiza e Komisionit

48. Bazuar në vendimin e mësipërm gjyqësor, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2022, në ngarkim të personit nën hetim K. B. për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, për shkak se shtetasja K. B. gjatë kohës që ka qenë duke udhëtuar me automjetin e saj ka aksidentuar këmbësorin, shtetasin V. Xh., i cili është dërguar menjëherë në Spitalin Rajonal të Elbasanit për të marrë mjekim. Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor, datë 19.7.2021, është arritur në përfundimin se tek i dëmtuari konstatohen dëmtime që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme për punë mbi 9 ditë. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 27.7.2021, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi fakti i referuar nuk përbën vepër penale për shkak të mosardhjes së pasojës së kërkuar nga neni 290/2 i Kodit Penal. Kundër këtij vendimi i dëmtuari ka paraqitur ankesë në gjykatë.

49. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***¹⁶⁴, datë 29.12.2021, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal të prokurorisë dhe regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, me arsyetimin se nga prokuroria nuk janë hetuar elementet e anës objektive të figurës së veprës penale, të parashikuara nga neni 290/2 i Kodit Penal¹⁶⁵. Në vijim të detyrave të lëna nga gjykata, prokuroria ka urdhëruar kryerjen e një akti të ri ekspertimi mjekoligjor, i cili ka konkluduar se: “*Dëmtimet e konstatuara në trupin e shtetasit V. Xh. nuk kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të tyre, nuk kanë sjellë për pasojë shëmtim, as humbje të aftësisë së përhershme për punë në masën mbi 1/3 dhe, si të tilla, hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve që kanë sjellë humbje të aftësisë së përkohshme për punë mbi 9 (nëntë) ditë*”. Mbështetur në të dhënat e mësipërme, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar përsëri gjykatës për pushimin e procedimit penal, kërkesë që është pranuar nga gjykata.

50. Komisioni arsyeton se në kuptim të nenit 290 të Kodit Penal, për *sqarimin e anës objektive të veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”*, kërkohet verifikimi i faktit nëse personat e përfshirë në ngjarje kanë kryer shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, si dhe verifikimi i pasojave ardhura nga shkelja e këtyre rregullave, për të cilët kërkohen njohuri të

¹⁶³ Email datë 7.12.2023.

¹⁶⁴ Të administruar nga sistemi elektronik gjykata.gov.al.

¹⁶⁵ Gjykata në vendim ka arsyetuar se: “*Së pari, nuk kemi përcaktimin e faktit nëse kemi shkelje të rregullave të ... Kodin Rrugor apo jo, nga kush janë shkelur këto rregulla dhe shkaku determinuat i ndodhjes së aksidentit. Së dyti, është e vërtetë që nga mjeku ligjor kemi përcaktimin e pasojës së ardhur nga ngjarja... se dëmtimet që ka pësuar i dëmtuari... hyjnë në kategorinë e atyre që kanë shkaktuar humbje të aftësisë së përkohshme në punë mbi 9 ditë, por në akt rezulton se në datë 7.7.2021, ora 16:00 (i dëmtuari) është transferuar në SUT Tiranë për mungesë të ortopedit. Ky konstatim e çon gjykatën në konkluzionin se akti i ekspertimit mjekoligjor nuk është i plotë dhe duhet të rikryhet përsëri... mbi bazë të kartelës së SUT Tiranë dhe ekzaminimit të të dëmtuarit*”.

posaçme në fushat përkatëse. Në rastin konkret, gjykata në vendimin e datës 29.12.2021 ka konstatuar se organi i akuzës nuk ka përcaktuar faktin nëse ka shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, nga kush janë shkelur këto rregulla dhe shkakun determinant të ndodhjes së aksidentit. Gjithashtu, gjykata ka konstatuar se eksperti mjekoligjor është mbështetur vetëm në kartelën e Spitalit Rajonal Elbasan dhe jo në këqyrjen e të dëmtuarit, si dhe nuk ka administruar kartelën mjekësore të SUT Tiranë, në kushtet kur i dëmtuari është transportuar pranë këtij spitali. Në vijim të detyrave të lëna nga gjykata, Prokuroria ka urdhëruar kryerjen e një akti të ri ekspertimi mjekoligjor.

51. *Lidhur me shpjegimin e subjektit të rivlerësimit se kërkesa e tij për pushimin e procedimit penal pas riekspertimit është gjendur e drejtë*, Komisioni arsyeton se në rastin konkret nuk ka shqyrtuar çështjen penale me qëllim për t'i dhënë zgjidhje asaj me pasoja konkrete për palët, por ka analizuar qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit të rivlerësimit¹⁶⁶. Fakti që pas kthimit të çështjes nga gjykata prokurori i çështjes dhe, më tej, gjykata ka arritur në përfundimin se nuk kemi vepër penale, nuk e përjashton subjektin nga përgjegjësia për moskryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore dhe për moskontrollin e veprimeve hetimore, sipas parashikimeve të nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale.

52. Sa më lart, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e aftësisë për të hetuar, për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kriteret të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

53. Në kushtet kur vlerësimi i çështjes penale ka ardhur si pasojë e informacioneve mbi integritetin e figurës së subjektit të rivlerësimit, të ngritura nga organet ndihmëse, Komisioni çmon se krijohen dyshime të arsyeshme se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar të dyshuarin/personin nën hetim e, për pasojë, dyshimet mbi integritetin e figurës së subjektit të rivlerësimit, të ngritura nga organet ligjzbatuese, janë të bazuara. Megjithatë, kjo rrethanë nuk është shkak për kualifikimin e subjektit të rivlerësimit si të papërshtatshëm në kuptim të kriterit të kontrollit të figurës, sipas parashikimeve të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, por është një rrethanë që lidhet me komponentët e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale që afektojnë cenimin e besimit të publikut te drejtësia.

54. Në përfundim, Komisioni vlerëson se krijohen dyshime të arsyeshme se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar të dyshuarin/personin nën hetim, rrethanë e cila është vlerësuar bashkë me komponentët e tjerë të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, që afektojnë cenimin e besimit të publikut te drejtësia.

55. Në lidhje me çështjen penale të gjykuar me vendimin nr. *, datë 16.2.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan**, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: (i) *Kërkesa e subjektit për pushimin e procedimit penal, dhe njëkohësisht caktimin e masave mjekësore, nuk bazohet në nenin 46 të Kodit Penal; (ii) Subjekti, me paraqitjen e kërkesës për pushimin e procedimit penal, ka favorizuar të dyshuarin.*

56. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁶⁷, subjekti i rivlerësimit shpjegon se për vite të tëra praktika në Prokurorinë Shqiptare për personat e papërgjegjshëm ka qenë nëpërmjet pushimit të çështjes dhe caktimit të masës mjekësore të detyrueshme. Kohët e fundit, vijon subjekti i

¹⁶⁶ Vendimi nr. 30, datë 18.11.2019 (JR), i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹⁶⁷ Email datë 7.12.2023.

rivlerësimit, Gjykata e Lartë, në datën 16.11.2023 ka shpallur dispozitivin e vendimit në lidhje me çështjen penale nr. *** akti, i cili mbart disponime njehsuese të praktikës gjyqësore në lidhje me mënyrën se si duhet të veprojë prokurori dhe gjykatat në çështjet me persona të papërgjegjshëm dhe nisur nga praktika e unifikuar çështja në ngarkim të shtetasit E. K. është dërguar për gjykim me qëllim vendosjen e masës mjekësore të detyrueshme.

Analiza e Komisionit

57. Nga shqyrtimi i vendimit gjyqësor rezulton se në datën 8.9.2022 është njoftuar policia mbi një konflikt në familje në lagjen “****”. Skuadra e policisë, e mbërritur në adresën e dhënë, ka gjetur në banesën e shtetasit E. K. njolla gjaku në shkallë dhe në sallon, njerëz që bënë veprime të dyshimta, si dhe kanë konstatuar shtetasen Sh. K. të shtrirë e të gjakosur në krahavor. Në këto kushte, patrulla e policisë ka prangosur shtetasin E. K.. Gjatë këqyrjes është gjetur një thikë me teh metalik në dyshemenë e verandës. Deklarimet e shtetasve tregojnë se shtetasi E. K. kishte probleme të shëndetit mendor dhe, për shkak të kësaj, shpeshherë manifestonte sjellje konfliktuale. Është kryer akti i ekspertimit teknik për thikën e gjetur në vendngjarje dhe ka rezultuar se nuk plotëson kushtet teknike të armëve të ftohta me prerës e shpues. Është kryer akti i ekspertimit psikiatriko-ligjor për shtetasin E. K., i cili ka arritur në përfundimin se ky shtetas vuan nga sëmundje mendore dhe në momentin e kryerjes së veprës penale vuante nga çrregullimet bipolare me tipare psikotike, që daton që nga viti 2019. Gjithashtu, janë administruar aktet e ekspertimit mjekoligjor të shtetasve Sh. K. dhe E. S., nga ku rezulton se dëmtimet e pësuar nga këta shtetas hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve që kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit.

58. Në përfundim të hetimeve paraprake, subjekti ka paraqitur në gjykatë kërkesën për pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se në analizë të provave, të cilat ndodhen në dosjen hetimore, dhe bazuar në aktin e ekspertimit psikiatriko-ligjor, arrihet në përfundimin se procedimi penal duhet të pushohet dhe për personin në hetim duhet të zbatohet masa mjekësore e mjekimit të detyruar spitalor. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan (gjyqtari i seancës paraprake) me vendimin e datës 16.2.2023 ka vendosur kthimin e akteve prokurorisë, me arsyetimin se vepra penale është konsumuar dhe duhet hetuar e vlerësuar gjyqësisht. Sipas gjykatës, prokurori nuk mund të paraqitet përpara gjykatës njëkohësisht me kërkesën për pushimin e procedimit dhe caktimin e masës mjekësore. Caktimi i masës mjekësore, vijon arsyetimin gjykata, duhet të jetë si rezultat i një kontrolli të plotë që vjen nga një gjykim themeli, për shkak se ai vendos kufizim të vullnetit/lirisë së personit, cenon procesin e rregullt ligjor dhe parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

59. Komisioni vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë¹⁶⁸, në vendimin e mësipërm njësues të cituar nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se prokurori në rastet kur nga hetimi arrin në konkluzionin se personi që i atribuohet vepra penale është i papërgjegjshëm dhe ndaj tij duhet të caktohet masë mjekësore sipas nenit 46 të Kodit Penal, duhet t’i kërkojë gjykatës (gjyqtarit të seancës paraprake) dërgimin e çështjes në gjyq, sipas nenit 327, pika 6, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale dhe jo të kërkojë pushimin e gjykimit dhe vendosjen e masës mjekësore. Në rastin konkret rezulton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë në gjykatë për pushimin e çështjes dhe njëkohësisht caktimin e masës mjekësore, ndërkohë që

¹⁶⁸ <https://www.gjykataelarte.gov.al/sq/lajme/publiku/njoftim-i-kolegjit-penal-per-njesim-te-praktikes-gjyqesore>

sipas vendimit njehsues duhet të kërkonte dërgimin e çështjes për gjykim dhe caktimin e masës mjekësore.

60. Megjithatë, Komisioni, duke çmuar: (i) se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur njësimin e praktikës gjyqësore, për sa i përket rasteve të mësipërme, çka presupozon se ka pasur qëndrime të ndryshme nga gjykatat; si dhe (ii) rrethanat e procedimit penal – krijon bindjen se në rastin konkret veprimet e subjektit të rivlerësimit nuk kanë pasur si qëllim favorizimin e të dyshuarit/personit në hetim, por kanë ardhur si pasojë e interpretimit të gabuar të dispozitave penale, e cila mund të jetë edhe si pasojë e interpretimeve të ndryshme të gjykatave.

61. Në përfundim, Komisioni vlerëson se informacioni i organeve ligjzbatuese se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar të dyshuarin/personin nën hetim nuk është i bazuar.

62. Në lidhje me procedimin penal nr. *, viti 2022,** Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: (i) *Subjekti nuk i ka njoftuar të dëmtuarit vendimin e datës 9.9.2020 për mosfillimin e procedimit penal sipas parashikimit të nenit 291, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale;* (ii) *Subjekti ka marrë vendimin e datës 9.9.2020 për mosfillimin e procedimit penal pa kryer veprimet e nevojshme hetimore, pasi nuk ka administruar aktin e ekspertimit mjekoligjor, me qëllim vërtetimin e pasojave të parashikuara nga neni 290 i Kodit Penal;* (iii) *Veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti janë kryer të shkëputura në kohë, pasi akti i ekspertimit mjekoligjor është hartuar dhe dorëzuar në organin procedues pas më shumë se 1 vit nga data e marrjes së vendimit për kryerjen e tij, ndodhjes së aksidentit dhe shtrimit në spital të të dëmtuarit;* (iv) *Subjekti nuk ka kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore, pasi: (a) ka regjistruar procedimin penal pas më shumë se 3 muajve nga paraqitja e vendimit të gjykatës në organin procedues; (b) ka regjistruar emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale pas më shumë se 9 muajve nga regjistrimi i procedimit penal, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe nuk ka kryer ndonjë veprim hetimor për zbulimin e autorit të veprës penale dhe vërtetimin e pasojave nga aksidenti; (c) ka zgjatur për një periudhë prej 1 vit e 5 muaj afatet e përfundimit të hetimeve pa shkaqe të arsyeshme; (v) Subjekti, me marrjen e vendimit të datës 9.9.2020 për mosfillimin e procedimit penal, me tejzgjatjen e afateve të përfundimit të hetimeve pasi çështja është kthyer nga gjykata pa shkaqe të arsyeshme, ka favorizuar të pandehurin.*

63. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁶⁹, subjekti i rivlerësimit ka dhënë këto shpjegime: *Në lidhje me mosnjoftimin e vendimit të mosfillimit, sqaron se në pikën 4 të vendimit është vendosur që vendimi t'i njoftohet të dëmtuarit dhe palëve të interesuara nëpërmjet sekretarisë së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe ka qenë detyrim që njoftimi të bëhej nga sekretaria.*

64. *Në lidhje me konstatimin se ka marrë vendimin e mosfillimit të procedimit penal pa administruar aktin e ekspertimit mjekoligjor, subjekti i rivlerësimit sqaron se eksperti mjekoligjor ka parashtruar se i dëmtuari nuk ishte paraqitur në Spitalin Rajonal Elbasan dhe nuk kishte kartelë spitalore. Gjithashtu, sqaron se i ka kërkuar ekspertit që ky komunikim t'i referohej me shkresë zyrtare, gjë e cila nuk u realizua nga ana e ekspertit. Më pas shpjegon se duke pasur parasysh që vendimi i mosfillimit të procedimit penal është i cenueshëm, nga gjykata nëpërmjet ankimit të të dëmtuarit nga momenti i marrjes dijeni të vendimit, për të mos cenuar edhe afatin 15-ditor të parashikuar nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale ka*

¹⁶⁹ Email datë 7.12.2023.

vendosur mosfillimin e procedimit penal për mungesë të aktit mjekoligjor. Gjithashtu, shprehet se ka orientuar të dëmtuarin për ankimin e vendimit të mosfillimit të procedimit në gjykatë.

65. *Lidhur me konstatimin se ka regjistruar procedimin penal me vonesë nga momenti i ardhjes së vendimit të gjykatës në organin e akuzës*, subjekti i rivlerësimit shpjegon se është kryer për shkak të ngarkesës mbi normalen si në gjykim edhe në hetimin e procedimeve penale, si dhe për shkak të mbingarkesës së sekretarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Megjithatë, edhe pse regjistrimi është kryer me vonesë, kjo rrethanë nuk është shkak për pavlefshmëri apo papërdorshmëri të akteve hetimore procedurale dhe nuk ka sjellë pasoja në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

66. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit sqaron se në datën 25.4.2023 janë përfunduar hetimet në lidhje me këtë çështje penale dhe i është drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin e çështjes për gjykim me të pandehur A. Gj., akuzuar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal dhe aktualisht kjo çështje është në gjykim.

Analiza e Komisionit

67. Referuar akteve të procedimit penal nr. ***, rezulton se në datën 22.8.2020, në segmentin rrugor Elbasan-Peqin, në vendin e quajtur *** ka ndodhur një aksident rrugor mes tri automjeteve. Ka rezultuar se automjeti tip “Renault” me drejtues shtetasin Gj. H. është përplasur në pjesën e pasme nga automjeti furgon, që drejtohej nga shtetasi A. Gj. Ky i fundit, pas përplasjes me automjetin tip “Renault” ka përplasur edhe automjetin tip “Volkswagen” të shtetasit G. M., që ka qenë i pozicionuar jashtë rruge. Nga ky aksident ka mbetur i dëmtuar babai i shtetasit G. M., Q. M., i cili ka qenë duke u futur në mjetin e djalit të tij. Pasi është transportuar në spital, ka rezultuar jashtë rrezikut për jetën. Nga testi i alkoolit ka rezultuar se shtetasi A. Gj. nuk ka konsumuar pije alkoolike. Sipas aktit të ekspertimit autoteknik të datës 24.8.2020, shkak determinant për ndodhjen e aksidentit kanë qenë shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e shtetasit A. Gj., pasi nuk ka ruajtur kontrollin e drejtimit të mjetit, nuk ka frenuar në mënyrë të menjëhershme, si dhe nuk ka ruajtur distancën e sigurisë ndaj mjetit në lëvizje përpara tij, sipas parashikimeve të neneve 139 dhe 147 të Kodit Rrugor. Rezulton se nuk është kryer akti i ekspertimit mjekoligjor, pasi i dëmtuari nuk i është nënshtruar ekzaminimit mjekoligjor e, për pasojë, nuk është bërë e mundur të përcaktohet shkalla e dëmtimeve trupore të shkaktuara nga aksidenti.

68. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 9.9.2020, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se nga aksidenti nuk kanë ardhur pasojat e parashikuara nga neni 290 i Kodit Penal. Kundër vendimit të subjektit ka paraqitur ankim në gjykatë i dëmtuari Q. M.. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 24.1.2022, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, me arsyetimin se nga organi i akuzës nuk janë hetuar elementet e anës objektive të figurës së veprës penale, sikurse janë shkelja e dispozitës konkrete të përcaktuar në Kodin Rrugor, ardhja e pasojës së kërkuar nga dispozita penale, si dhe lidhja shkakësore mes veprimit dhe pasojës së ardhur.

69. Nga analizimi i akteve të dosjes penale, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal në datën 9.9.2020. Sipas vendimit gjyqësor, i

dëmtuari është vënë në dijeni të vendimit të mësipërm në datën 7.9.2021 dhe ka paraqitur ankesë në datën 17.9.2021 e, për pasojë, ankesa e tij është pranuar për shqyrtim nga gjykata me arsyetimin se është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale. Lidhur me shpjegimin *se ka qenë detyrim që njoftimi të bëhej nga sekretaria*, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti ndonjë provë për të vërtetuar datën e dorëzimit të vendimit në sekretari. Për pasojë, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti prova lidhur me konstatimin e rezultateve të hetimit se të dëmtuarit nuk i është njoftuar vendimi i mosfillimit të procedimit penal sipas parashikimit të nenit 291¹⁷⁰, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, por është vënë në dijeni në rrethana të tjera.

70. Lidhur me shpjegimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi i mosfillimit është marrë për mos u cenuar afati 15-ditor i parashikuar nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale, pasi në rastin konkret nuk plotësohen kushtet për vendosjen e mosfillimit të procedimit penal sipas nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit e pranon edhe vetë që në rastin konkret nuk plotësoheshin kushtet e parashikuara në dispozitat e mësipërme për marrjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal e, megjithatë, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal duke vepruar në kundërshtim të hapur me parashikimet e neneve 290 dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale.

71. Në rastin konkret rezulton se shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor është konstatuar nga akti i ekspertimit autoteknik, por në kushtet kur nuk është administruar akti i ekspertimit mjekoligjor, i cili shërben për vërtetimin e pasojave, si një nga elementet e domosdoshme të anës objektive të figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk mund të arrijë në konkluzionin që fakti nuk ekziston. Në rast se akti i ekspertimit nuk mund të realizohet brenda afatit të parashikuar nga pika 1 e nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale dhe në kushtet kur shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor parashikohet nga ligji si vepër penale, subjekti i rivlerësimit duhet të vijonte me regjistrimin e procedimit penal e, më pas, me administrimin e aktit të ekspertimit mjekoligjor.

72. Referuar arsyetimit të mësipërm, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse lidhur me rezultatet e hetimit se ka marrë vendimin e datës 9.9.2020 për mosfillimin e procedimit penal pa kryer veprimet e nevojshme hetimore, pasi nuk ka administruar aktin e ekspertimit mjekoligjor, me qëllim vërtetimin e pasojave të parashikuara nga neni 290 i Kodit Penal.

73. Më tej, Komisioni vëren se vendimi për kryerjen e aktit të ekspertimit mjekoligjor është marrë në datën 22.8.2020, ndërsa akti i ekspertimit mjekoligjor nr. ***, datë 7.9.2021, “Mbi shqyrtimin e kartelës ditore të shtetasit Q. M.” në të cilin konkludohet se dëmtimet që i janë shkaktuar të dëmtuarit hyjnë në kategorinë e atyre që kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit, është protokolluar në organin procedues në datën 9.9.2021, që do të thotë pas më shumë se 1 vit nga data e marrjes së vendimit për kryerjen e aktit të ekspertimit, ndodhjes së aksidentit dhe shtrimit në spital të të dëmtuarit. Lidhur me këtë konstatim subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime. Në këto kushte, Komisioni çmon se veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti janë kryer të shkëputura në kohë, pasi akti i ekspertimit mjekoligjor është hartuar

¹⁷⁰ Kodi i Procedurës Penale, neni 291 parashikon: “1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit. 2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit”.

dhe dorëzuar në organin procedues pas më shumë se 1 vit nga data e ndodhjes së aksidentit, marrjes së vendimit për kryerjen e aktit të ekspertimit dhe shtrimit në spital të të dëmtuarit.

74. Nga shqyrtimi i veprimeve hetimore, vërehet se: (i) akti i ekspertimit mjekoligjor është administruar nga prokuroria në datën 9.9.2021; (ii) vendimi i gjykatës për regjistrimin e procedimit penal është protokolluar në Prokurorinë e Rrethit Elbasan në datën 22.2.2022; (iii) subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal në datën 10.6.2022, pa emër personi (pas 3 muaj e 20 ditëve); (iv) regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale është bërë në datën 17.4.2023, pavarësisht se akti i ekspertimit mjekoligjor ishte administruar në datën 9.9.2021 (pas 10 muaj e 7 ditëve); (v) në datën 25.4.2023, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës; (vi) në datën 18.7.2023¹⁷¹ subjekti i rivlerësimit i është drejtuar gjykatës me kërkesë për gjykim.

75. Referuar rrethanave të çështjes vërehet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore, pasi ka regjistruar procedimin penal pas më shumë se 3 muajve nga paraqitja e vendimit të gjykatës në organin procedues, ka regjistruar emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale pas më shumë se 10 muajve nga regjistrimi i procedimit penal, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe nuk ka kryer ndonjë veprim hetimor¹⁷², si dhe ka zgjatur për një periudhë prej rreth 1 vit e 5 muaj afatet e përfundimit të hetimeve pa shkaqe të përligjura, veprime të cilat demonstrojnë mungesë të angazhimit e përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksioneve.

76. *Lidhur me konstatimet e mësipërme*, subjekti i rivlerësimit është shprehur vetëm për regjistrimin e procedimit penal me vonesë pas kthimit të çështjes nga gjykata, duke sqaruar se kjo ka ndodhur *për shkak të ngarkesës mbi normalen në hetimin e procedimeve penale dhe për shkak të mbingarkesës së sekretarisë së prokurorisë*. Komisioni, duke marrë në konsideratë edhe faktin që subjekti i rivlerësimit ka zgjatur afatin e përfundimit të hetimeve paraprake në mënyrë të pajustificueshme pa kryer veprime hetimore, çmon se shpjegimi i mësipërm nuk është i besueshëm.

77. Sa më lart, *duke marrë në konsideratë se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin e datës 9.9.2020 për mosfillimin e procedimit penal pa kryer veprimet e nevojshme hetimore*, ka kryer veprimet hetimore të shkëputura në kohë, pas kthimit të çështjes nga gjykata nuk ka kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore dhe në shpjegimet e rezultateve të hetimit pranon që në rastin konkret nuk plotësoheshin kushtet e parashikuara për marrjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e: (i) njohurive ligjore bazuar në aftësitë e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) kriterit të aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore ose gjyqësore, si dhe aftësisë për të administruar dosjet gjyqësore, sipas prashikimit të

¹⁷¹ Shkresë nr. *** prot., datë 16.10.2023, e Prokurorisë së Rrethit Elbasan.

¹⁷² Nga momenti i depozitimit të vendimit të gjykatës për regjistrimin e procedimit penal në organin procedues e deri në paraqitjen e kërkesës për gjykim kanë kaluar pothuajse 1 vit e 5 muaj¹⁷², ndërkohë që gjatë kësaj kohe subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer ndonjë veprim hetimor për zbulimin e autorit të veprës penale pasi akti i ekspertimit autoteknik që provonte fajësinë e personit të dyshuar ishte hartuar që në datën 24.8.2020 dhe akti i ekspertimit mjekoligjor lidhur me dëmtimet që i janë shkaktuar të dëmtuarit nga aksidenti ishte administruar nga subjekti përpara se vendimi i gjykatës për regjistrimin e procedimit penal të paraqitej në organin e akuzës.

pikës 1 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016; (iii) kriterit të etikës së magjistratit në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.

78. Në vijim, në kushtet kur vlerësimi i çështjes penale ka ardhur si pasojë e informacioneve mbi integritetin e figurës së subjektit të rivlerësimit, të ngritura nga organet ndihmëse, Komisioni çmon se krijohen dyshime të arsyeshme se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar të dyshuarin/personin nën hetim e, për pasojë, dyshimet mbi integritetin e figurës së subjektit të rivlerësimit, të ngritura nga organet ndihmëse janë të bazuara. Megjithatë, kjo rrethanë nuk është shkak për kualifikimin e subjektit të rivlerësimit si të papërshtatshëm në kuptim të kriterit të kontrollit të figurës, sipas parashikimeve të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, por është një rrethanë që lidhet me komponentët e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale që afektojnë cenimin e besimit të publikut te drejtësia.

79. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar në mënyrë të hapur personin e dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, rrethanë e cila është vlerësuar bashkë me komponentët e tjerë të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale që afektojnë cenimin e besimit të publikut te drejtësia.

Çështje penale për të cilat dyshohet se subjekti ka kryer veprimtari të kundërligjshme të shfaqur në formën e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm, me qëllim favorizimin e pozitës së personit të dyshuar/personit nën hetim apo të pandehurit

80. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ndaj shtetasve për të cilët dyshohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimtari të kundërligjshme, të shfaqur në formën e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm me qëllim favorizimin e pozitës së tyre, Komisioni vlerësoi se nuk u gjetën elemente që vërtetojnë ekzistencën e ndikimit të paligjshëm të subjektit të rivlerësimit në çështjet penale të ndjekura nga prokurorë të tjerë.

Përfundimet e Komisionit lidhur me kontrollin e figurës

Trupi gjyqësor, në vlerësimin tërësor të kriterit të figurës, arrin në këto përfundime:

i. Subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar duke u gjendur në kushtet e pikës 3, të nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “ç”, të pikës 4, të nenit 38, të ligjit nr.84/2016

ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar saktësisht, plotësisht dhe me vërtetësi formularin për kontrollin e figurës dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm pasi nuk ka deklaruar kontaktin e papërshtatshëm që është konstatuar nga prova të besueshme, duke u gjendur në kushtet shkronjës “a” të pikës 6 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Të dhënat e përfituara nga hetimi për të cilat është marrë informacion nga organet ligjzbatuese mbi çështjen penale të gjykuar me vendimin nr. ***, datë 18.1.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në ndjekjen e procedimin penal nr. ***, viti 2022, janë vlerësuar bashkë me komponentët e tjerë të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale që afektojnë cenimin e besimit të publikut te drejtësia.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

4. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit së bashku me tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin, të paraqitura nga subjekti; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga 23 prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

5. Nga shqyrtimi i të dhënave në dosjen personale konstatohet se subjekti i rivlerësimit Hektor Mushi ka punuar si oficer i policisë gjyqësore e, më pas, në datën 26.3.1998 është emëruar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Elbasan. Në datën 25.1.1999 është emëruar në Prokurorinë e Rrethit Pogradec dhe në datën 2.5.2007 është transferuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku vazhdon detyrën aktualisht. Gjithashtu, rezulton se nga data 20.11.2007 deri në datën 25.4.2010 ka ushtruar detyrën e zëvendës drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe në 5 dosjet e shortuara rezulton se subjekti i rivlerësimit Hektor Mushi ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet dhe në shumicën e rasteve analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme në harmoni me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit. Në vlerësimin e punës së bërë nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se subjekti i rivlerësimit Hektor Mushi për vitin 2014 është vlerësuar “shumë mirë”, për vitin 2015 është vlerësuar “mirë” dhe për vitin 2016 është vlerësuar “shumë mirë”.

b) Arsyetimi ligjor

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i 5 dosjeve penale të shortuara konstatohet se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në arsyetimin ligjor. Aktet e arsyetuara prej tij janë të kuptueshme, duke respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe standardin e procesit të rregullt ligjor.

Hetimi i Komisionit

6. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLP-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me 3 dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe me 5 dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për dokumentin nr. 1 dhe dosjen nr. 2.

7. **Lidhur me dokumentin nr. 1** “Konkluzione përfundimtare”, për procedimin penal nr. ***, viti 2014, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se *vendimi për pushimin e hetimeve ndaj personit nën hetim L. T. për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal është i paqartë, pasi duket se konkluzioni i subjektit nuk bazohet në situatën faktike.*

8. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁷³, subjekti i rivlerësimit shpjegon se nga informacionet policore të përcjella verbalisht arriti në përfundimin se kontrolli dhe arrestimi i shtetasit L. T. ishin masa të përshtatshme, me qëllim dhënien e deklarimeve lidhur me përgjegjësinë penale të personave organizatorë të shpërndarjes së lëndëve narkotike në qytetin e Gramshit. Sikurse rezulton, strategjia hetimore rezultoi e drejtë, pasi shtetasi i mësipërm dha *indicie* dhe të dhëna në lidhje me organizatorët e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve. Gjithashtu, shpjegon se nga hetimi nuk ka rezultuar që ky shtetas të ketë qenë shitës i lëndëve narkotike, por thjesht përdorues i tyre, bazuar edhe në aktet e ekspertimeve toksikologjike dhe në ekspertimin kimik.

Analiza e Komisionit

9. Referuar dokumentit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit rezulton se oficerët e policisë në Drejtorinë e Qarkut Elbasan, bazuar në të dhënat se shtetasi L. T. merrej me shpërndarje të lëndëve narkotike, në datën 20.6.2014, kanë ushtruar kontroll fizik ndaj tij dhe kanë gjetur e sekuestruar në cilësinë e provës materiale 6 porcione qeska plastike të mbushura me material pluhur, të dyshuar për lëndë narkotike të llojit heroinë, si dhe një qese farmaceutike të mbushur me lëndë bimore të thatë, të dyshuar për lëndë narkotike të llojit *cannabis sativa*. Nga kontrolli i banesës së këtij shtetasi janë gjetur 31 fara me ngjyrë gri, të dyshuara për fara të bimës narkotike të llojit *cannabis sativa*. Sipas aktit të ekspertimit toksikologjik ka rezultuar se në mostrën e urinës së shtetasit L. T. është konstatuar prania e produkteve *cannabis sativa* dhe të opiumit të heroinës. Në aktin e ekspertimit kimik të materialit bimor, farave, të sekuestrua është konstatuar produkt herbal i bimës *cannabis sativa* dhe në 6 paketimet me pluhur është konstatuar prania e heroinës. Në vijim është kryer akti adiktologjik dhe toksikologjik, i cili ka konkluduar se i dyshuari, duke qenë se është përdorues i lëndës narkotike *cannabis sativa* dhe heroinës, sasinë e lëndës narkotike e ka përdorimin vetjak brenda tolerancës së organizmit, pa shkaktuar dëmtime serioze të shëndetit. Në këto kushte, me vendimin e datës 6.1.2015 është vendosur pushimi i hetimeve ndaj personit nën hetim L. T. për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

10. Gjatë hetimeve, shtetasi L. T. ka deklaruar se në të shumtën e rasteve drogën e llojit heroinë e ka blerë në Gramsh tek një person me emrin L.. Nga verifikimet e bëra nga DPQ Elbasan ka rezultuar se personi me emrin L. nga Gramshi është shtetasi L. B.. Në datën 24.8.2014, është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit D. B., ku gjatë kontrollit fizik i janë gjetur 4 qeska me lëndë pluhur që ngjason me lëndën narkotike të llojit heroinë dhe gjatë kontrollit të banesës iu gjetën 10 qeska plastike të mbushura me pluhur, të dyshuar si lëndë narkotike e llojit heroinë.

¹⁷³ Email datë 7.12.2023.

Më pas, ky shtetas është dërguar për gjykim me akuzën “Shitje e lëndës narkotike”, të kryer në bashkëpunim. Në dokumentin “Konkluzione përfundimtare” subjekti i rivlerësimit ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit D. B. për veprën penale “Mbajtje dhe shitje e narkotikëve” e kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, kërkesë e cila është pranuar nga të gjitha shkallët e gjykimit¹⁷⁴.

11. KLP-ja në raportin e analizimit të aftësive profesionale ka vlerësuar se: “...vendimmarrja për pushimin e hetimeve të shtetasit L. T. nuk është objektive... Pavarësisht se ky shtetas është përdorues i lëndës narkotike, gjetja dhe sekuestrimi njëkohësisht i sasisë së heroinës, kanabisit dhe farave të kanabisit tek ky shtetas, nga ana objektive, provojnë konsumimin nga ana e tij të elementeve të veprës penale “Mbajtje e lëndës narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal”.

12. Në vijim të analizës së KLP-së, Komisioni, bazuar në jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë¹⁷⁵, arsyeton se për zgjidhjen e çështjes që lidhet me sasinë e lëndës narkotike të nevojshme për përdorim vetjak duhen thirrur në çdo rast specialistë të fushës, por, për zgjidhjen përfundimisht të çështjes është i nevojshëm edhe sqarimi i rrethanave faktike të mbajtjes së sasisë konkrete të lëndës narkotike apo psikotrope nga personi i dyshuar¹⁷⁶.

13. Në dokumentin “Konkluzione përfundimtare” vërehet se subjekti i rivlerësimit, në marrjen e vendimit për pushimin e procedimit penal ndaj shtetasit L. T., është mbështetur vetëm në konkluzionet e aktit të ekspertimit toksikologjik, që ka përcaktuar se sasia e sekuestruar konsiderohet dozë e vogël, duke mosvlerësuar rrethanat e tjera faktike, sikurse janë posedimi i llojeve të ndryshme të lëndëve narkotike dhe dyshimeve se kryente aktivitet në shitjen e lëndës narkotike. Për pasojë, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në interpretimin e ligjit dhe analizimin e jurisprudencës.

14. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesit e aftësisë për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

15. Lidhur me dosjen nr. 2, që i përket procedimit penal nr. ***, i regjistruar në datën 16.12.2013, për veprën penale “Organizim i lotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Komisioni i kërkoj shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: (i) *Subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore pasi nuk ka kërkuar informacion nga shoqëria “***” nëse ka ushtruar aktivitetin në lokalit e shtetasit F. D., me qëllim qartësimin e faktit nëse organizimi i lojërave*

¹⁷⁴Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 16.12.2015 (të administruar nga sistemi gjykata.gov.al) ka vendosur deklarinimin fajtor të shtetasit D. B. për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve” të kryer në bashkëpunim dhe dënimin e tij me 7 vjet e 6 muaj burgim dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, duke i ulur 1/3 e dënimit, e ka dënuar përfundimisht me 5 vjet burgim. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 26.7.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me këtë ndryshim: Mosaplikimin e nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale mbi uljen e dënimit me 1/3 e dënimit të dhënë prej 7 vjet e 6 muaj burgim për të pandehurin D. B., pasi i pandehuri kishte hequr dorë nga gjykimi i shkurtuar në Gjykatën e Apelit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 5.4.2022 (të administruar nga gjykataelartë.gov.al) ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga i gjykuari D. B.

¹⁷⁵ Vendimin unifikues nr. 1, datë 27.3.2008.

¹⁷⁶ Po aty, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arsyetojnë: “...gjykata për zgjidhjen e çështjes që lidhet me sasinë e lëndës narkotike të nevojshme për përdorim vetjak duhet të thërrasë në çdo rast specialistë të fushës... Por, për zgjidhjen përfundimisht të çështjes, gjykata duhet të mbështetet edhe në kriterin tjetër, me të cilin lidhet ngushtësisht ai i pari, kriter ky, që konkretizohet nëpërmjet sqarimit të rrethanave faktike të mbajtjes së sasisë konkrete të lëndës narkotike apo psikotrope nga personi konkret...”.

*të fatit në ambientet e lokalit është kryer nga ky shtetas apo nga shoqëria “****”; nuk ka kërkuar informacion nga NJMLF se cilët janë personat/subjektet që i mbajnë apo duhet t’i mbajnë çelësat e memories fiskale të aparateve elektronike, me qëllim kryerjen e veprimeve të mëtejshme për administrimin e tyre dhe përcaktimin e periudhës së përdorimit të aparateve elektronike; nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga NJMLF lidhur me arsyet që ky institucion nuk është në gjendje të kontrollojë memorien fiskale të aparateve elektronike; (ii) Është i paqartë fakti që shtetasi F. D. nuk është marrë në përgjegjësi penale për vënin në dispozicion të lokalit për organizimin apo luajtjen e lojërave të fatit, në kundërshtim me dispozitat ligjore, sipas parashikimit të nenit 198 të Kodit Penal.*

16. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁷⁷, subjekti i rivlerësimit ka dhënë këto shpjegime:

*Lidhur me konstatimet e pikës (i), subjekti sqaron se ishte e panevojshme pyetja e përfaqësuesve të shoqërisë “****”, pasi përgjigja e NJMLF Tiranë për mospasjen e një marrëdhënieje kontraktuale midis shoqërisë “****” dhe shtetasit F. D. ishte shteruese në lidhje me individualizimin e përgjegjësive penale. Më pas shpjegon se nga përvoja lidhur me hetimin e çështjeve për të njëjtën vepër penale, çelësat fizikë dhe elektronikë mbahen nga poseduesit e makinave të lojërave të fatit dhe nga veprimet hetimore të kryera në vendngjarje çelësat nuk janë gjetur dhe nuk janë sekuestruar nga ana e policisë gjyqësore, gjë që ka vështirësuar hetimin e çështjes dhe individualizimin e përgjegjësive penale të autorit. Gjithashtu, shpjegon se nuk është provuar që mbajtja e pajisjeve ka qenë me qëllim ushtrimin e aktivitetit të paligjshëm në fushën e lojërave të fatit apo magazinimin e tyre me qëllim ruajtje. Mospërcaktimi i kohës, vijon subjekti, në të cilën të paktën tri prej këtyre aparateve që kanë qenë në gjendje të rregullt teknike, janë shfrytëzuar për ushtrimin e këtij aktiviteti, nuk mund të konkludohej me marrjen në përgjegjësi penale të shtetasit F. D. apo dikujt tjetër.*

Lidhur me konstatimin e pikës (ii), subjekti i rivlerësimit shpjegon se shtetasi F. D. nuk mund të merrej në përgjegjësi penale për veprën penale të parashikuar në nenin 198 të Kodit Penal, pasi referuar anës objektive, kusht i domosdoshëm që vepra penale të jetë e konsumuar duhet që në ambientet e lokalit të ushtrohet aktiviteti i paligjshëm në fushën e lojërave të fatit. Sa kohë që nga hetimi nuk u provua vepra penale e parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, nuk provohet as vepra penale e parashikuar nga neni 198 i Kodit Penal.

Analiza e Komisionit

17. Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal rezulton se në datën 18.10.2013 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan ka ushtruar kontroll në ambientet e lokalit të shtetasit F. D. në qytetin e ***, Librazhd. Nga kontrolli i ushtruar janë sekuestruar 10 makineta lojërash fati pa dokumentacionin përkatës. Shtetasi F. D. ka deklaruar se ka afro 10 muaj që i ka dhënë me qira lokalin shoqërisë “****”, pa kontratë noteriale dhe kjo shoqëri ka që në muajin maj që nuk i kanë dhënë qiranë. Në këto kushte, vijon deklaruesi, ka marrë çelësin e lokalit dhe ia ka dhënë vëllait të tij Y. D., duke pritur që ta likuidonte shoqëria. Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (NJMLF) ka konfirmuar se shoqëria “****” nuk ka aplikuar dhe nuk është pajisur me leje sekondare për hapjen e një pike në Përrenjas, në emër të shtetasit F. D. dhe se ky shtetas nuk rezulton të jetë kontraktuar nga shoqëritë e lojërave të fatit. Sipas aktit të ekspertimit teknik, ka rezultuar se aparatet elektronike kategorizohen për ushtrimin e aktivitetit në fushën e lojërave të fatit, nga

¹⁷⁷ Email datë 7.12.2023.

të cilat 3 janë në gjendje të rregullt teknike dhe 7 të tjerat nuk rezultuan në gjendje të rregullt teknike. Ekspertët kanë konstatuar se këto aparate nuk janë të certifikuara nga NJMLF-ja dhe se nuk mund të përcaktojnë periudhën e përdorimit dhe shumat e luajtura, pasi nuk i janë vënë në dispozicion çelësat fizikë dhe elektronikë të memories fiskale.

18. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 23.12.2014, ka vendosur pushimin e procedimit penal me arsyetimin se nga të dhënat e grumbulluara nuk provohet që shtetasi F. D. të ketë organizuar dhe ushtruar aktivitet të lojërave të fatit dhe lotarive të palejuara, pasi nuk provohet që makinetat e lojërave të fatit të jenë përdorur prej tij. Sipas vërtetimit të datës 24.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk rezulton që NJMLF-ja të ketë paraqitur ankim në këtë gjykatë.

19. Komisioni arsyeton se neni 197¹⁷⁸ i Kodit Penal është një dispozitë e bardhë (*blankete*), pasi në përcaktimin e kundërvajtjes penale “Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin” i referohet akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin e lojërave të fatit, lotarive dhe bixhozit. Nga ana objektive, vepra penale kryhet me veprime aktive të kundërligjshme, që konsistojnë në organizimin e lotarive, lojërave të fatit apo bixhozit në kundërshtim me ligjin që rregullon këtë veprimtari.

20. Në rastin konkret rezulton se shtetasi F. D. ka deklaruar se i ka dhënë me qira lokalin shoqërisë “****” pa kontratë noteriale. Sipas informacionit të administruar nga NJMLF-ja ka rezultuar se shoqëria “****” nuk është pajisur me leje për hapjen e një pike në *** në emër të shtetasit F. D. dhe se ky shtetas nuk është kontraktuar nga shoqëritë e lojërave të fatit. Nga shqyrtimi i dosjes penale nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë kërkuar informacion nga shoqëria “****” nëse ka ushtruar aktivitet në lokalin e shtetasit të mësipërm, por e ka marrë të mirëqenë deklarin e shtetasit F. D. se lokalin ia ka dhënë shoqërisë “****”.

21. Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se *është e panevojshme pyetja e përfaqësuesve të shoqërisë “****”, pasi përgjigjja e NJMLF Tiranë për mospasjen e një marrëdhënieje kontraktuale midis shoqërisë “****” dhe shtetasit F. D. ishte shteruese*, është jobindës, sepse vetëm pasi të merrte dëshminë e përfaqësuesve të shoqërisë “****” subjekti mund të sqaronte anën objektive të figurës së veprës penale, pasi nëse përfaqësuesi i shoqërisë do të konfirmonte marrjen me qira të lokalit të shtetasit F. D., atëherë i dyshuar për kryerjen e kësaj vepre penale, do të ishte shoqëria “****” dhe nëse kjo shoqëri do ta mohonte dhe nuk do të administroheshin prova të tjera, atëherë dyshimi për kryerjen e veprës penale do të binte mbi shtetasin F. D..

22. Në vijim, vërehet se në aktin e ekspertimit ekspertët e NJMLF-së kanë konkluduar se nuk mund të përcaktojnë periudhën e përdorimit dhe shumat e luajtura në aparatet elektronike, pasi nuk i janë vënë në dispozicion çelësat fizikë dhe elektronikë të memories fiskale. Nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit, në vijim të ndjekjes logjike të hetimit, të ketë kërkuar informacion shtesë nga NJMLF-ja lidhur me personat/subjektet që i mbajnë apo duhet t’i mbajnë çelësat fizikë e elektronikë të memories fiskale, me qëllim administrimin e tyre dhe përcaktimin e periudhës së përdorimit. Gjithashtu, nuk ka kërkuar informacion shtesë apo nuk ka kryer hetime të mëtejshme për sqarimin e faktit që institucioni shtetëror përgjegjës nuk është në gjendje të kontrollojë memorien fiskale të aparateve elektronike.

¹⁷⁸ Kodi Penal, neni 197 parashikon: “*Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet*”.

23. Lidhur me shpjegimin e subjektit se nga përvoja, çelësat fizikë dhe elektronikë mbahen nga poseduesit e makinetave të lojërave të fatit dhe kjo ka vështirësuar hetimin e çështjes dhe individualizimin e përgjegjësive penale të autorit, është jobindës, pasi, sipas logjikës së subjektit të rivlerësimit mjafton që personat e dyshuar të veprës penale të mos dorëzojnë çelësat e memories fiskale të makinerive elektronike të lojërave të fatit, të vëna në punë në mënyrë të paligjshme, atëherë mbetet e paprovuar ana objektive e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal.

24. Më tej, Komisioni arsyeton se edhe neni 198¹⁷⁹ i Kodit Penal që parashikon veprën penale “Vënia në dispozicion e lokaleve për lojëra të palejuara” është një dispozitë e bardhë (*blankete*), pasi i referohet akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin e lojërave të fatit, lotarive dhe bixhozit. Nga ana objektive kjo veprë penale kryhet me anë të veprimeve të drejtpërdrejta duke vënë në dispozicion lokalit për organizimin e basteve, që nuk janë pajisur me licencë për ushtrimin e kësaj veprimtarie, në kundërshtim me ligjin.

25. Lidhur me shpjegimin e subjektit se shtetasi F. D. nuk mund të merrej në përgjegjësi penale për veprën penale të parashikuar nga neni 198 i Kodit Penal, pasi kushti i domosdoshëm që në ambientet e një lokali të ushtrohet aktiviteti i paligjshëm në fushën e lojërave të fatit nuk mbështetet në situatën faktike, pasi nga informacioni i marrë nga organi shtetëror përgjegjës shoqëria “****” nuk është pajisur me leje sekondare për hapjen e një pike në Përrenjas, në emër të shtetasit F. D. dhe se ky shtetas nuk rezultoi të jetë kontraktuar nga shoqëritë e lojërave të fatit. Gjithashtu vërehet se shtetasi F. D. është marrë në pyetje nga OPGJ-ja si person që ka dijeni për veprën penale në datën 16.10.2013 dhe ka deklaruar se ka afro 10 muaj që lokalit ia ka dhënë shoqërisë “****”, e cila ka futur lojëra fati. Pra, i dyshuari ka pranuar se ka vënë në dispozicion lokalit për organizimin e lojërave të fatit që nuk ishin pajisur me licencë nga organet përgjegjëse shtetërore.

26. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe për të interpretuar ligjin, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe i janë caktuar gjithsej 723 çështje penale, nga të cilat ka përfunduar 688 çështje dhe ka mbartur 35. Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i tij ka qenë në përgjithësi brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Hektor Mushi, ka treguar profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

¹⁷⁹ Kodi Penal, neni 198 parashikon: “Vënia në dispozicion e lokaleve për organizimin apo luajtjen e lotarive, lojërave të fatit apo bixhozit, në kundërshtim me dispozitat ligjore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj”.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht dhe materialet të vendosura në rend kronologjik.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe nga dosjet e hedhura në short ka rezultuar se gjuha e përdorur në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Gjithashtu, nga verifikimi në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se për periudhën e rivlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Hektor Mushi, nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Hektor Mushi, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër, dhe në tri dokumentet e dorëzuara prej tij, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Hektor Mushi, nuk janë dorëzuar dokumente të tjera, sipas të cilave ai mund të ketë qenë pjesëmarrës në trajnime të tjera të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës jashtë periudhës së rivlerësimit apo në trajnime të kryera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

Të dhëna nga burimet arkivore të KLP-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme

27. Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme bën me dije se nga verifikimi i praktikave të trajtuara rezulton se për subjektin e rivlerësimit, z. Hektor Mushi, ka dy ankesa:

i) Praktika nr. *** prot., datë 21.12.2018, që ka të bëjë me ankesën e shtetasit M. M., drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, i cili ka kërkuar përjashtimin e prokurorit Hektor Mushi pasi nuk ka kryer detyrën konform ligjit procedural penal për të kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm në zbardhjen e të gjitha rrethanave e veprimeve të paligjshme që kanë kryer shtetasit, të cilët janë të panjohur nga ana e kallëzuesit. Prokurori ka zvarritur çështjen hetimore përtej afateve ligjore, duke i krijuar dyshimin e arsyeshem se ky prokuror është i njëanshëm dhe në konflikt interesi në hetimin e çështjes. Ankesa është marrë në shqyrtim nga sektori i burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës të Shqipërisë dhe është vendosur që kjo praktikë të arkivohet.

ii) Praktika nr. *** prot., datë 22.11.2018, ka të bëjë me ankesën e shtetasit H. Xh. drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, i cili ka shpjeguar se ka bërë një kallëzim penal ndaj shtetasit Sh. Gj., në shtëpinë e të cilit ka banuar 10 vjet me qira, vite për të cilat ky shtetas i ka vjedhur energjinë elektrike, pasi e paguante më së shumti ai, ndërsa shtetasi Sh. Gj. shumë pak. Prokurori Hektor Mushi, në bazë të vendimit datë 19.7.2017, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ankuesi ka paraqitur ankim në gjykatë dhe kjo ankesë është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan¹⁸⁰. Sektori i marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme me shpresën e datës 26.11.2018 i ka kthyer përgjigje ankuesit se Prokuroria e Përgjithshme nuk ka kompetenca të ndërhyjë në vendimmarrjen e gjykatave, pasi vendimet e gjykatës kontrollohen vetëm nga sistemi i konsoliduar gjyqësor nëpërmjet mjeteve dhe afateve të ankimit dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e tyre, për sa kohë ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë.

28. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka informuar se për subjektin e rivlerësimit Hektor Mushi ka dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë një kallëzim penal. Gjithashtu, rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 15.12.2008, për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Ekspertimi i rremë”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 309 të Kodit Penal, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Hektor Mushi dhe shtetasit A. K., ekspert mjekoligjor. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë me vendimin datë 30.4.2009 ka vendosur pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. ***, datë 15.12.2008.

Hetimi i Komisionit

29. Komisioni mori në shqyrtim aktet e procedimit penal nr. ***/2008 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe rezultoi si më poshtë:

30. Në datën 11.12.2008, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. *** mbi bazën e kallëzimit të depozituar nga shtetasi F. B. ndaj shtetasve Hektor Mushi, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe A. K., ekspert mjekoligjor për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe neni 309, paragrafi 2 “Ekspertimi i rremë” i Kodit Penal. Kallëzuesi ka pretenduar se në procedimin penal të filluar për shkak të aksidentit automobilistik të datës 28.5.2007, ku ka mbetur i dëmtuar, mjeku ligjor A. K. ka vlerësuar në mënyrë të gabuar, si dhe se ka falsifikuar për qëllime fitimi aktin mjekoligjor, duke u shprehur se dëmtimet e shkaktuara atij janë në kategorinë e dëmtimeve të lehta, ndërkohë që nga ekzaminimet e mëvonshme dhe trajtimi që ka bërë privatisht në një spital në Maqedoni, është vlerësuar si plagosje e rëndë, ku si pasojë pretendon

¹⁸⁰ Vendimi nr. ***, datë 1.11.2018.

se ka mbetur invalid nga njëra këmbë. Kallëzuesi hedh akuza edhe në drejtim të prokurorit të çështjes Hektor Mushi, pasi sipas tij, në bashkëpunim me K., ka falsifikuar aktin mjekoligjor për qëllime përfitimi. Përveç kësaj, kallëzuesi pretendon se është kërcënuar nga z. Mushi përpara zyrës së prokurorit të Prokurorisë së Rrethit Elbasan, kur ka shkuar për të bërë ankim ndaj tij.

31. Me vendimin e datës 11.12.2008, prokurori i çështjes ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore dhe kalimin e akteve hetimore Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Prokuroria e Rrethit Kavajë, pasi ka regjistruar procedimin penal, ka administruar dosjen penale që lidhet me pretendimet e kallëzuesit, konkretisht fashikullin e procedimit penal nr. ***, datë 29.5.2007, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në përfundim të hetimeve, prokurori i çështjes me vendimin e datës 30.4.2009 ka vendosur pushimin e çështjes, me arsyetimin se nuk ka rezultuar që subjekti të ketë kanosur kallëzuesin.

32. Pavarësisht faktit që veprimet e subjektit janë analizuar në kuadër të një procedimi penal, duke çmuar se të njëjtat fakte mund t'u shërbejnë në mënyrë të pavarur procedimeve të ndryshme, të cilat ndjekin qëllime të ndryshme¹⁸¹, Komisioni ka analizuar qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit të rivlerësimit si prokuror që ka ndjekur procedimin penal nr. ***, datë 29.7.2007, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

33. Lidhur me procedimin penal nr. *, datë 29.7.2007, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan,** Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: (i) *Subjekti nuk ka kontrolluar rregullsinë e aktit të ekspertimit mjekoligjor në kushtet kur eksperti nuk ka bërë këqyrjen e të dëmtuarit, por është mbështetur vetëm në kartelën ditore të spitalit;* (ii) *Subjekti nuk ka verifikuar vendimin e datës 28.5.2007 të oficerit të policisë gjyqësore për caktimin e shtetasit H. M. për kryerjen e aktit të ekspertimit autoteknik, në kushtet kur ky shtetas nuk është i regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në degën përkatëse, sipas parashikimeve të nenit 179, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale;* (iii) *Subjekti nuk e ka vlerësuar konkluzionin e aktit të ekspertimit autoteknik se “drejtuesi i automjetit nuk ka kryer shkelje të Kodit Rrugor”, në raport me dokumentin e referimit të veprës penale, ku pasqyrohet se “automjeti ka hyrë në drejtimin e lëvizjes së motoçikletës”.*

34. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁸², subjekti i rivlerësimit ka dhënë këto shpjegime: *Lidhur me konstatimin e pikës (i), shpjegon se nuk ka kryer verifikimin e aktit të ekspertimit mjekoligjor, pasi nuk ka pasur dyshime lidhur me objektivitetin e konkluzionit të ekspertit. Sipas tij, nga praktika, kartelat ditore të spitalit dhe ato të shtrimit spitalor plotësohen dhe përpilohen nga mjekë specialistë të fushës përkatëse, mbi të cilat konkludojnë edhe ekspertët mjekoligjorë.*

Lidhur me konstatimet e tjera, shpjegon se në vendimin për mosfillimin e procedimit penal i është referuar vetëm ekspertimit mjekoligjor dhe jo aktit të ekspertimit autoteknik, pasi pasoja e ardhur sipas konkluzioneve të aktit të ekspertimit mjekoligjor ishte ezaurues për vendimmarrjen.

Analiza e Komisionit

¹⁸¹ Vendimi nr. 30, datë 18.11.2019 (JR), pg. 52 i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

¹⁸² Email datë 7.12.2023.

35. Referuar akteve të procedimit penal rezulton se në datën 28.5.2007, në aksin rrugor Elbasan-***, automjeti i tipit “Opel”, me targë ***, i cili drejtohej nga shtetasi O. T., është përplasur me motoçikletën që drejtohej nga shtetasi F. B., i cili është dëmtuar dhe është dërguar në Spitalin e Elbasanit, ku ka rezultuar se ishte jashtë rrezikut për jetën. Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor të datës 30.5.2007, shtetasit F. B. i janë shkaktuar dëmtime, që hyjnë në kategorinë e atyre që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë. Sipas aktit të ekspertimit autoteknik të datës 7.6.2007, drejtuesi i automjetit nuk ka kryer shkelje të Kodit Rrugor, ndërsa drejtuesi i motoçikletës ka shkelur nenin 139, pika 2, dhe nenin 115, pika 1. Subjekti i rivlerësimit me vendimin e datës 8.6.2007 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor shtetasit F. B. i janë shkaktuar dëmtime që hyjnë në kategorinë që shkaktojnë paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë dhe, meqenëse pasoja e ardhur nga ky aksident është e lehtë, fakti nuk parashikohet si vepër penale dhe procedimi penal nuk duhet të fillojë.

36. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim në gjykatë i dëmtuari. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 27.11.2007, ka vendosur rrëzimin e ankesës. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 5.2.2007, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së rrethit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 7.1.2009, ka vendosur prishjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se: *“...Në vendim prokurori ka vendosur që t’u njoftojë të interesuarve vendimin e tij për mosfillim të procedimit penal. Në fashikullin penal nuk rezulton që ky vendim t’i jetë komunikuar të dëmtuarit F. B.. Për sa i përket vendimit të prokurorit për caktimin e ekspertit autoteknik, nga fashikulli penal rezultoi se ky vendim nuk është marrë konform nenit 179/1, 2, 3, 4 e 180 të Kodit të Procedurës Penale. Përpos kësaj, eksperti i caktuar jo vetëm që nuk është ekspert autoteknik, por në zbatim të nenit 183 të Kodit të Procedurës Penale nuk i është marrë deklaratë në lidhje me përgjegjësinë morale dhe juridike për detyrën që do të kryejë. ...Për aktin mjekoligjor edhe për këtë rast... për caktimin e ekspertit nuk janë zbatuar dispozitat procedurale të mësipërme. Në kompozimin e aktit të ekspertimit, mjeku ligjor A. K. është mbështetur, kjo sipas thënieve të tij, në kartelën ditore të datës 28.5.2007 të repartit të urgjencës së Spitalit Kirurgjikal Elbasan, pa këqyrur të dëmtuarin ...Nën dritën e provave të reja të paraqitura nga vetë i dëmtuari dhe të marra nga institucionet e specializuara, rezulton që shkalla e dëmtimeve tek ankuesi është e ndryshme nga ato të konstatuara nga eksperti dhe konkluzioni i tij në aktin e ekspertimit”.*

37. Referuar dispozitave ligjore të kohës kur ka ndodhur ngjarja, rezulton se Kodi Penal në nenin 290¹⁸³ parashikonte se shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar si pasojë vdekjen, plagosjen e rëndë të një personi ose plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 10 vjet. Komisioni arsyeton edhe një herë se për sqarimin e anës objektive të veprës penale, të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, kërkohet verifikimi i faktit nëse personat e përfshirë në ngjarje kanë kryer shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, si dhe verifikimi i pasojave të ardhura nga shkelja e këtyre rregullave, për të cilat kërkohen njohuri të posaçme në fushat përkatëse.

¹⁸³ Kodi Penal, neni 290 parashikon: *“Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen, plagosjen e rëndë të një personi ose plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet. Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose plagosja e rëndë e disa personave, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet”.*

38. Në rastin konkret, rezulton se sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor, shtetasit F. B. i janë shkaktuar dëmtime që hyjnë në kategorinë e atyre që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, ndërsa subjekti në vendimin për pushimin e çështjes pasqyron se sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor shtetasit të mësipërm i janë shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në nëntë ditë. Komisioni, duke marrë në konsideratë se vetëm kjo pasaktësi nuk do të ndikonte në vendimin përfundimtar të pushimit të çështjes¹⁸⁴, vëren se eksperti mjekoligjor për arritjen e konkluzionit është mbështetur në kartelën ditore të datës 28.5.2007 të repartit të urgjencës të spitalit dhe jo në këqyrjen e të dëmtuarit¹⁸⁵ e, për pasojë, akti i ekspertimit mjekoligjor nuk është i plotë, pasi eksperti nuk ka bërë këqyrjen e të dëmtuarit, por është mbështetur vetëm në kartelën ditore të spitalit.

39. Për sa i përket shpjegimit të subjektit të rivlerësimit se *ekspertët mjekoligjorë konkludojnë mbi kartelat ditore të spitalit dhe ato të shtrimit spitalor plotësohen dhe përpilohen nga mjekë specialistë të fushës përkatëse*, ky shpjegim nuk mbështetet në nenin 178 të Kodit të Procedurës Penale, pasi akti i ekspertimit mjekoligjor, si një nga dokumentet e nevojshme që ndihmon organin e akuzës për sqarimin e anës objektive të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, konkretisht të pasojave të ardhura, hartohet vetëm nga ekspertë, të cilët kanë njohuritë e nevojshme në fushën e mjekësisë ligjore.

40. Gjithashtu, vërehet se eksperti që ka hartuar aktin e ekspertimit autoteknik, është me detyrë specialist për aksidentet pranë sektorit të qarkullimit rrugor në Komisaratin e Policisë Elbasan. Për pasojë, ky shtetas nuk plotëson kushtet e parashikuara në pikën 1¹⁸⁶ të nenit 179 të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk mund të figurojë njëkohësisht i regjistruar në librat e ekspertëve të licencuar që kanë njohuri të posaçme në degën përkatëse.

41. Në vijim, sipas dokumentit “Informacion për referimin e veprës penale”, të datës 29.5.2007, dhe procesverbalit të datës 28.5.2007 të shtetasit O. T.¹⁸⁷, mjetet ishin me drejtime lëvizjeje të kundërta dhe automjeti ka hyrë në drejtimin e lëvizjes së motoçikletës e, për pasojë, konkluzioni i ekspertit autoteknik se drejtuesi i automjetit nuk ka kryer shkelje, nuk mbështetet në nenin 152¹⁸⁸ të Kodit Rrugor.

42. Për sa i përket shpjegimit të subjektit se *në vendimmarrjen e tij për mosfillimin e procedimit i është referuar vetëm ekspertimit mjekoligjor dhe jo aktit të ekspertimit autoteknik*, Komisioni çmon se ky shpjegim nuk ndikon në vlerësimin se vendimi i tij për caktimin e ekspertit

¹⁸⁴ Në rast se do të konstatohej se dëmtimi i ka shkaktuar paaftësi në punë deri në nëntë ditë, ky fakt nuk parashikohet nga neni 290 i Kodit Penal. Edhe nëse do të konstatohet paaftësia në punë për më tepër se nëntë ditë, në kushtet kur nuk janë plagosur disa persona, nuk konsiderohet si vepër penale.

¹⁸⁵ Në procesverbalin e datës 28.1.2009 të Prokurorisë së Rrethit Kavajë, eksperti mjekoligjor ka deklaruar se në kushtet kur pacienti nuk ndodhej në pavijon, ka marrë të dhënat nga kartela ditore e spitalit dhe ka hartuar aktin e ekspertimit.

¹⁸⁶ Kodi i Procedurës Penale, neni 179 parashikon: “1. Caktimi i ekspertit bëhet duke e zgjedhur atë ndërmjet personave që janë regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në degën përkatëse. Kur ekspertimi shpallet i pavlefshëm ose duhet të bëhet ekspertim i ri, organi procedues merr masa, kur është e mundshme, që detyra e re t’i besohet një eksperti tjetër”.

¹⁸⁷ Oficeri i policisë gjyqësore ka pasqyruar se automjeti që drejtohej nga shtetasi O. T., me drejtim lëvizjeje për në Elbasan, ndërkohë që tentonte të hynte në gomisteri, në parakalim të gabuar, ka humbur kontrollin e mjetit duke dalë në krahun e majtë të rrugës dhe është përplasur me motorin me drejtim lëvizjeje për në Gostimë, që drejtohej nga shtetasi F. B.. Në procesverbalin e datës 28.5.2007, shtetasi O. T. ka deklaruar se, pasi ka ndezur sinjalin dhe ka kontrolluar rrugën, ka kthyer majtas dhe ka parë motorin që i ka goditur pasqyrën e krahut të djathtë.

¹⁸⁸ Neni 152 i Kodit Rrugor, i pandryshuar, parashikon: “3. Drejtuesit e mjeteve duhet gjithashtu... b) për t’u kthyer nga e majta, si dhe për t’u futur në zona që nuk janë për kalim publik, të afrohen sa më shumë që të jetë e mundur në aksin e karrexhatës dhe, në rast kryqëzimi, të kryejnë kthimin pranë qendrës së kryqëzimit dhe në të majtë të tij, përveç rasteve kur ka sinjalizim tjetër, si dhe kur gjenden në një karrexhatë me një sens qarkullimi, të qëndrojnë sa më afër që të jetë e mundur me kufirin e majtë të karrexhatës. Në të dyja rastet, drejtuesit e mjeteve nuk duhet të hyjnë në rrugën tjetër në sens të kundërt dhe duhet të tregojnë kujdesin maksimal”.

autoteknik nuk është sipas dispozitave procedurale, pasi ky akt, bashkë me parregullsinë e aktit të ekspertimit mjekoligjor, ka sjellë si pasojë prishjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal nga gjykata.

43. Nga analizimi i rrethanave të mësipërme, Komisioni arsyeton se çmuarja e provës me ekspert bëhet duke nxjerrë vlerën e saj provuese, në koherencë me provat e tjera të procesit gjyqësor. Mendimet e ekspertit përbëjnë vetëm një këshillë për organet e ndjekjes penale, të cilat nuk janë aspak të detyruara që të pranojnë *a priori* këto mendime, përveçse kur i bindin. Pra, përfundimet e nxjerra nga ekspertët shqyrtohen në kontekstin e të gjitha rrethanave të tjera të çështjes¹⁸⁹. Në këtë kuptim, bazuar në nenin 24¹⁹⁰ të Kodit të Procedurës Penale, *subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin e kontrollit të rregullsisë së akteve të ekspertimit nëse janë të plota në raport me rrethanat e çështjes*.

44. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në aftësinë për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kriteret të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

DENONCIME

Në Komision, për subjektin e rivlerësimit Hektor Mushi janë administruar 4 denoncime nga publiku. Referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kërkoi shpjegime për 3 denoncime, si vijon:

45. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 9.5.2019,** të shtetasit A. E., i cili denoncon subjektin për moskryerjen e hetimeve, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: *Administrimi i provave për identifikimin e kryerjes së veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, nuk shfaq ndonjë kompleksitet të veçantë, që të mund të justifikojë kohëzgjatjen e hetimeve paraprake për një periudhë prej 4 vitesh e 5 muajsh (deri në momentin e administrimit të shkresës së Prokurorisë Elbasan).*

46. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit shpjegon se hetimet janë zgjatur për shkak të transferimeve të herëpashershme të oficerëve të policisë gjyqësore që janë ngarkuar me këtë çështje, kallëzimeve të vazhdueshme nga ana e shtetasit A. E. në prokurori, problematikave të krijuara nga ekspertët në lidhje me ekspertimin teknik të ndërtimit, si dhe për shkak të konflikteve civile dhe penale që ai ka me të kallëzuarin për pronësinë e hidrocentralit. Gjithashtu, sqaron se aktualisht është administruar akti i ekspertimit teknik i ndërtimit dhe ka rezultuar se nuk jemi përpara veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Më tej shpjegon se akti i ekspertimit do t’i komunikohet kallëzuesit A. E., i cili sipas të drejtave të tij procedurale ka të drejtën e prapësimeve dhe kërkesave që çmon të bëjë.

Analiza e Komisionit

47. Nga dokumentacioni i administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan¹⁹¹, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal

¹⁸⁹ Vendimi nr. 45, datë 23.7.2012, i Gjykatës Kushtetuese.

¹⁹⁰ Kodi i Procedurës Penale, neni 24 parashikon: “Prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake... në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod”.

¹⁹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 2.6.2023.

nr. ***, datë 20.12.2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal dhe se ky procedim penal vazhdon të jetë aktualisht në fazën e hetimit¹⁹².

48. Komisioni arsyeton se vepra penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a¹⁹³ i Kodit Penal, në paragrafin e parë dhe të dytë përfaqëson një vepër penale formale, e cila nuk kërkon domosdoshmërisht ardhjen e ndonjë pasojë konkrete, por mjafton prezenca materiale e një ndërtimi të realizuar në mungesë të lejes së dhënë nga organi përkatës administrativ, ndërsa sipas paragrafit të tretë kërkohet shkaktimi i pasojave të rënda ose kur ndërtimi pa leje kryhet për qëllim fitimi. Për pasojë, momenti kohor në të cilin subjekti i veprës penale do të përgjigjet penalisht për këtë figurë vepre penale, do të jetë kur vërtetohet objektivisht ndërtimi i realizuar, i cili plotëson nga ana objektive të gjitha elementet e parashikuara nga legjislacioni që rregullon veprimtarinë e ndërtimit. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, duket se administrimi i provave për identifikimin e kryerjes së veprës penale, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, nuk shfaq ndonjë kompleksitet të veçantë, që të mund të justifikojë kohëzgjatjen e hetimeve paraprake për një periudhë prej 4 vitesh e 5 muajsh (deri në momentin e administrimit të shkresës së Prokurorisë së Rrethit Elbasan).

49. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, krijohen dyshime të arsyeshme për zgjatjen e papërligjur të hetimeve për këtë procedim penal, duke prodhuar një perceptim negativ të publikut, matur nga syri i një vëzhguesi të zakonshëm, në drejtim të funksionimit të organit të akuzës.

50. Në përfundim, Komisioni vlerëson se evidentimi i mungesës së veprimtarisë hetimore të subjektit të rivlerësimit për periudha të gjata e pa arsye të përligjura demonstroi mungesë të angazhimit e përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksioneve, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.

51. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 27.11.2021,** të shtetasit M. P., i cili akuzon subjektin e rivlerësimit për mungesë profesionalizmi, duke shkaktuar pavlefshmërinë në akte të hetimeve, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: *(i) Subjekti i ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë të pandehurit si një nga elementet e rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42, pika 2 e Kushtetutës, pasi nuk i ka njoftuar vendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve dhe vendimin për caktimin e ekspertit për vlerësimin e dëmeve; (ii) Subjekti i ka mohuar të akuzuarit të drejtën të paraqesë deklaratime në interes të tij pas marrjes së cilësisë si i pandehur, duke mos zbatuar parashikimet e neneve 34/a, pika 1, shkronja “gj” dhe 332/c, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale.*

52. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit shpjegon se vendimi për zgjatjen e afateve të hetimeve për tre muaj i është komunikuar personit nën hetim nga oficeri i policisë gjyqësore pranë IEVP Elbasan, i cili ka bërë shënimin që refuzon firmën dhe, në rastin e njoftimit të akuzës dhe njoftimit për përfundimin e hetimeve, i pandehuri ka refuzuar të nënshkruajë aktet, pavarësisht se është njohur me to dhe nuk ka bërë të ditur emrin e mbrojtësit me të cilin kërkonte të realizonte mbrojtjen. Sipas subjektit të rivlerësimit, këto veprime ishin strategji e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, me qëllim ngritjen e pretendimeve jo të bazuara në prova dhe ligj dhe për zëvendësimin e tij si prokuror të çështjes, pasi ai kishte kundërshtuar

¹⁹² Deri në datën e administrimit të shkresës së prokurorisë.

¹⁹³ Kodi Penal, neni 199/a parashikon: “Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit. Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur ka sjellë pasojë të rënda apo e kryer për qëllime fitimi, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet”.

në gjykatë kërkesën e të pandehurit për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest në burg” në një masë më të butë.

53. *Për sa i përket mosnjoftimit të mbrojtësit apo të pandehurit në lidhje me caktimin e ekspertit vlerësues*, shpjegon se konkluzioni i aktit të ekspertimit nuk ka sjellë pasoja rënduese tek i pandehuri, pasi nuk i është njoftuar akuzë e re dhe njoftimi i akuzës është bërë jo mbi bazën e konkluzionit të aktit të ekspertimit vlerësues. Gjithashtu, sqaron se kryerja e riekspertimit të ri sipas detyrave të lëna nga gjykata nuk ka sjellë ndryshim të akuzës ndaj të pandehurit nga ajo që ai ka ngritur.

54. Në përfundim, sqaron se me vendimin nr. ***, datë 3.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i cili ka marrë formë të prerë në datën 21.3.2023, është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal dhe dënimi i tij me 3 vite burgim.

Analiza e Komisionit

55. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura nga denoncuesi, si dhe të administruara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan¹⁹⁴, rezulton se i pandehuri K. D. i ka marrë viktimit O. K. dy automjete tip “Range Rover”, njëri në pronësi të vjehrrit të tij, shtetasit G. Sh. dhe tjetri në pronësi të shtetasit O. K.. Këto automjete i pandehuri i ka marrë me pretekstin për t’i blerë, por në fakt ai ka mashtruar, duke mos i dhënë shumën për të cilën ata kishin rënë dakord, vlera e të cilave shkonte në 26.000 euro. Po ashtu, i pandehuri jo vetëm që i ka marrë të dyja automjetet pa paguar kundërvlerën e tyre, por as nuk i ka kthyer me vullnetin e tij. Për të bindur viktimit se e kishte kryer derdhjen e parave në bankë, i pandehuri i ka dërguar viktimit foto me dy dokumente bankare: një derdhje parash në llogarinë e shtetasit O. K. në shumën 15.000 euro dhe një derdhje parash në llogarinë e shtetasit G. Sh. në shumën 11.000 euro. Më pas është provuar se dokumentet kanë rezultuar të falsifikuara, pasi në llogaritë e shtetasve të mësipërm nuk ishin bërë këto transfera. Në vijim ka rezultuar se automjetin në pronësi të shtetasit G. Sh. e ka lënë në Pogradec tek shtetasi M. Sh. për t’ia shitur atij, pasi i detyrohej një shumë të madhe parash, ndërsa automjetin tjetër e ka shitur në Fushë-Krujë për pjesë këmbimi në shumën 5.000 euro.

56. Në përfundim të hetimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur përpara gjyqtarit të seancës paraprake kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me vendimin e datës 1.11.2021 ka vendosur kthimin e çështjes dhe deklarimin e pavlefshëm të akteve procedurale të përpiluara nga prokurori në fazën e hetimit, si: (a) vendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve të datës 17.5.2021; (b) vendimin për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit të datës 15.5.2021; (c) aktin e ekspertimit autoteknik dhe urdhërimin për përsëritjen e akteve të mësipërme procedurale brenda dy muajve nga dita që vendimi merr formë të prerë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 23.11.2021, pa u ankimuar.

57. Komisioni arsyeton se për të garantuar jo vetëm qenien aktive të organit të prokurorisë në ndjekjen penale dhe dënimin e personave të dyshuar si autorë të veprave penale, por edhe respektimin e të drejtave dhe lirive të individëve, ndaj të cilëve ngrihet akuza ose janë dëmtuar si pasojë e veprës penale konkrete, ligjvënësi ka parashikuar në disa dispozita të Kodit të Procedurës Penale mundësinë që palët në proces për çdo veprim që ata mendojnë se cenojnë të

¹⁹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 18.7.2023.

drejtat dhe liritë e tyre, t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës për kontroll. Në këtë frymë, neni 278 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: *“Gjatë hetimeve paraprake për rastet e parashikuara nga ligji mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit dhe të dëmtuarit vendos gjykata”*. Më tej, në dispozitat e tjera të Kodit të Procedurës Penale, janë specifikuar disa nga rastet kur lejohet ankimi gjyqësor i vendimeve të prokurorit gjatë hetimeve paraprake¹⁹⁵.

58. Kodi i Procedurës Penale, në nenin 324, pika 3¹⁹⁶, parashikon se prokurori është i detyruar që vendimin për zgjatjen e hetimeve t'ia komunikojë të pandehurit dhe viktimës, të cilët, sipas nenit 325, pika 1¹⁹⁷, kanë të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj këtij vendimi. Në vijim, edhe neni 179, pika 2¹⁹⁸, parashikon se: *“Organi procedues është i detyruar t'i njoftojë vendimin për caktimin e ekspertit të pandehurit ose mbrojtësit të tij, duke i bërë të ditur se ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e tij. Procedimi i personit të akuzuar për kryerjen e një veprë penale përfshin hetimin e plotë nga organi i akuzës, mbi bazën e të cilit gjykata do të vendosë fajësinë ose pafajësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës penale. Elemente të këtij procesi janë: caktimi i masave të sigurimit, njoftimi i akuzës dhe pyetja e të pandehurit, këqyrja dhe kontrolli i personit ose i banesës, sekuestrime, marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe mbledhja e provave të tjera¹⁹⁹”*. Neni 37²⁰⁰ i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: *“Një person, që nuk është marrë si i pandehur përpara organit procedues, bën deklaratime, nga të cilat dalin të dhëna për inkriminimin në ngarkim të tij, atëherë organi procedues ndërpret pyetjen, duke e paralajmëruar se pas këtyre deklaratimeve mund të zhvillohen hetime ndaj tij dhe e fton të caktojë një mbrojtës”*. Vlen të theksohet se deklaratimet e mëparshme nuk shfrytëzohen kundër tij. Duke marrë në konsideratë edhe parashikimet e nenit 34/a, pika 1, shkronja “gj”²⁰¹ dhe nenit 332/c, pika 3²⁰², Komisioni arsyeton se i pandehuri gëzon të drejtën që në çdo gjendje të procedimit të kërkojë të pyetet në prani të avokatit të tij.

59. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit gjyqësor konstatohet se subjekti, në prapësim të pretendimeve të avokatit të të akuzuarit për pavlefshmërinë e akteve procedurale, ka arsyetuar se në lidhje me vendimin për zgjatjen e afateve të hetimeve, aktin nuk ia ka komunikuar mbrojtësit, por sipas tij mbrojtësi ka marrë dijeni dhe nuk e ka kundërshtuar këtë akt dhe se ky vendim i është komunikuar të pandehurit në përfundim të hetimeve. Në lidhje me vendimin për caktim, eksperti ka parashtruar se vendimi për caktimin e ekspertimit nuk i është komunikuar të pandehurit dhe as mbrojtësit, pasi janë në favor të të pandehurit dhe akti i është komunikuar bashkë me përfundimin e hetimeve. Në lidhje me pyetjen e të pandehurit në prani të avokatit, është shprehur se nuk është bërë, pasi kështu është çmuar nga ana e tij, pasi në bazë të provave

¹⁹⁵ Vendimi nr. 5, datë 6.3.2009, i Gjykatës Kushtetuese.

¹⁹⁶ Neni 324 parashikon: *“...3. Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve i njoftohet të pandehurit dhe viktimës”*.

¹⁹⁷ Neni 325 parashikon: *“1. I pandehuri dhe viktimja kanë të drejtë, brenda dhjetë ditëve nga njoftimi, të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit kundër vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve...”*.

¹⁹⁸ Neni 179 parashikon: *“2. Vendimi i organit procedues për caktimin e ekspertit i njoftohet të pandehurit ose mbrojtësit të tij, duke i bërë të ditur se ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e ekspertit, të propozojë ekspertë të tjerë, të marrë pjesë vetë në ekspertim, kur është e mundur, dhe të parashtrtojë pyetje për ekspertin”*.

¹⁹⁹ Kreu VII i Kodit të Procedurës Penale.

²⁰⁰ Neni 37 parashikon: *“Kur para autoritetit procedues një person, që nuk është marrë si i pandehur, bën deklaratime, nga të cilat dalin të dhëna për inkriminimin në ngarkim të tij, autoriteti procedues ndërpret pyetjen, duke e paralajmëruar se pas këtyre deklaratimeve mund të zhvillohen hetime ndaj tij dhe e fton të caktojë një mbrojtës. Deklarimet e mëparshme nuk mund të shfrytëzohen kundër personit që i ka bërë”*.

²⁰¹ Neni 34/a parashikon: *“1. Personi nën hetim ose i pandehuri ka të drejtë: ...gj) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod”*.

²⁰² Neni 332/c parashikon: *“3. I pandehuri mund të parashtrtojë kërkesa për pavlefshmërinë e akteve të hetimeve paraprake, papërdorshmërinë e provave, nevojën për marrjen e provave të tjera, kërkesë për gjykimin e shkurtuar, si dhe mund të bëjë deklaratimet që i çmon të nevojshme ose të kërkojë që të pyetet, duke zbatuar rregullat e parashikuara nga nenet 38 dhe 39 të këtij Kodi”*.

të mbledhura çështja ishte shumë e qartë. Sa më sipër, rezulton që subjekti i rivlerësimit në procesin gjyqësor i ka pranuar haptazi shkeljet procedurale, gjë që ka sjellë edhe pavlefshmërinë e akteve procedurale të përpiluara në fazën e hetimit paraprak.

60. Në këto rrethana, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit jo vetëm që ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, por ka demonstruar gjatë ndjekjes së çështjes e, më pas, në gjykim, mungesë të përgjegjshmërisë në funksion.

61. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi: (i) në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të marrë urdhra dhe vendime, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe për të interpretuar ligjin, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) në aspektin e etikës në punë të magjistratit lidhur me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.

62. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 11.6.2019,** të shtetasit A. H., i cili ka parashtruar se *...në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme gjendet informacioni lidhur me një incident ndërmjet subjektit dhe një shtetaseje bullgare gjatë kohës që subjekti ushtronte detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Pogradec*²⁰³, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: *Mbetet i paqartë fakti se në cilat dispozita ligjore subjekti i ka mbështetur veprimet e tij për ndalimin e makinës së shtetases bullgare e, më pas, shoqërimin e saj në Komisaratin e Policisë Librazhd.*

63. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit shpjegon se fakti ka ndodhur në territorin juridiksional të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Librazhd dhe shoqërimi i kësaj shtetaseje, bashkë me automjetin e saj, është kryer nga prokurori i rrethit Librazhd, I. Gj.. Në rastin konkret, vijon subjekti i rivlerësimit, ai ka mbajtur rol pasiv gjatë shoqërimit të saj në polici, por edhe gjatë verifikimeve që janë kryer nga Komisarati i Policisë Librazhd, pasi nuk ka pasur të drejta juridiksionale për t'u marrë me rastin në fjalë.

64. Më tej sqaron se shkaqet e shoqërimit të kësaj shtetaseje jashtë Komisarimit të Policisë Librazhd janë shpjeguar në aktet e procedimit penal të hetuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe nuk e mohon faktin që ka qenë i pranishëm, por ka mbajtur pozicion neutral dhe joaktiv.

65. Në përfundim sqaron se kallëzimin kjo shtetase e ka bërë në Drejtorinë e Policisë Elbasan, kur në atë kohë marrëdhëniet midis drejtuesit të Policisë Elbasan dhe Prokurorisë në përgjithësi kanë qenë tej mase të acaruar, fakt i ditur publikisht, dhe beson se ky ka qenë shkak edhe i përfshirjes së tij në kallëzimin e shtetases bullgare.

Analiza e Komisionit

66. Nga shqyrtimi i dosjes së procedimit penal nr. ***/2002, të administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan²⁰⁴, rezulton se në datën 26.9.2001 prokurorët e rretheve Librazhd e Pogradec, përkatësisht I. Gj. dhe Hektor Mushi, po ktheheshin nga shërbimi me automjetin që drejtohej nga shoferi i Prokurorisë së Rrethit Librazhd, duke udhëtuar në itinerarin Pogradec-Elbasan. Rreth orës 22:00, automjeti i tyre është parakaluar me një shpejtësi të madhe nga një automjet me targa të huaja. Të dy

²⁰³ Pretendimi i denoncuesit se subjekti i rivlerësimit shoqërohet me shtetasit Sh. dhe M. Q., persona të njohur në Elbasan për shkak të së shkuarës kriminale dhe me shtetasin Th. B., një individ që ka krijuar pasuri nga trafiku i drogës, është trajtuar në kreun "Kontrolli i figurës" të vendimit.

²⁰⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 11.9.2023.

prokurorët kanë konstatuar se në automjet ndodhej vetëm drejtuesi i tij dhe, duke parë shpejtësinë e madhe të lëvizjes së mjetit, faktin se ishte me targa të huaja dhe po lëvizte në orët e vona të natës, u ka lindur dyshimi se automjeti mund të ishte i vjedhur ose në të mund të kishte lëndë narkotike. Në këto rrethana, ata kanë urdhëruar shoferin e tyre të rriste shpejtësinë e lëvizjes, me qëllim që ta ndalonin atë. Pasi kanë ecur për disa kilometra, i kanë bërë shenjë makinës dhe e kanë ndaluar. Aty kanë konstatuar se mjeti drejtohej nga shtetasja bullgare P. Z. dhe në makinën e saj nuk kishte asnjë person tjetër. Fillimisht, të dy prokurorët i kanë kërkuar shpjegime se përse lëvizte me shpejtësi në orët e vona të natës dhe se nga vinte dhe kush ishte, si dhe dokumentacionin e saj për qëndrim në Shqipëri dhe atë të mjetit. Shtetasja bullgare, pasi ka sqaruar se ishte me kombësi e shtetësi bullgare, nuk ka pranuar që t'u jepte dokumentacionin, por me insistimin e prokurorëve ajo është shoqëruar në ambientet e jashtme të Komisarariatit të Policisë Librazhd, ku, pasi prokurorët kanë bërë verifikimin e dokumenteve të shtetases bullgare dhe të mjetit të saj, në orën 2:30 të datës 27.9.2001 e kanë lejuar të vazhdojë rrugën në drejtim të Tiranës.

67. Më pas, shtetasja Proletina Zlatonova, pasi ka dalë nga ambientet e Komisarariatit të Policisë Librazhd, i është drejtuar Drejtorisë së Policisë të Qarkut Elbasan dhe ka bërë kallëzim për dy prokurorët, duke pretenduar se ata e kishin fyer në rrugë, kur e kishin ndaluar, dhe në ambientet e Komisarariatit të Policisë Librazhd, dhe se subjekti i rivlerësimit e ka goditur me grushte në fytyrë, në bark, prapa në kurriz dhe e ka shtyrë tek shkallët. Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor të datës 28.9.2001, në trupin e kallëzueses janë konstatuar ekimoza dhe ënjtje në regjionin e barkut dhe në kokë nga ana e djathtë sipër veshit, të cilat janë shkaktuar me mjete të forta mprehëse dhe kanë shkaktuar humbjen e aftësisë së përkohshme deri në 9 ditë. Rezulton se hetimet janë ndjekur nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila, në përfundim të hetimeve, me vendimin e datës 7.1.2002 ka vendosur pushimin e hetimeve, me arsyetimin se pavarësisht nga kallëzimi dhe ekspertimi mjekoligjor, nuk provohet që shtetasit Hektor Mushi e I. Gj. të kenë kryer veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare apo ndonjë vepër tjetër penale.

68. Lidhur me konstatimin e rezultateve të hetimeve se në cilat dispozita ligjore i ka mbështetur veprimet e tij për ndalimin e makinës së shtetases bullgare e, më pas, shoqërimin e saj në Komisariatin e Policisë, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti shpjegime.

69. *Për sa i përket pretendimit se ka mbajtur qëndrim pasiv në këtë ngjarje*, Komisioni vëren se ky pretendim nuk mbështetet në aktet e dosjes penale, pasi: (i) kallëzuesja në kallëzimin e saj ka pretenduar se subjekti e ka fyer dhe goditur; (ii) në procesverbalin e datës 27.9.2001, oficeri i shërbimit në Komisariatin e Policisë Librazhd, M. B., ka deklaruar se ka parë prokurorin I. Gj. dhe dy persona të tjerë që ishin të nxehur dhe po e pyesnin shtetasen bullgare duke bërtitur në oborrin e komisarariatit dhe jo në zyrë; (iii) në procesverbalin e datës 25.10.2001, gjatë marrjes në pyetje nga OPGJ-ja, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se së bashku me prokurorin I. Gj., pasi e kanë ndaluar, kanë zbritur nga makina për të komunikuar me drejtuesen e mjetit dhe i kanë kërkuar të zbriste nga makina, si dhe i kanë bërë disa pyetje. Gjithashtu, ka shpjeguar se bashkë me I. kanë biseduar me këtë shtetase në oborrin e komisarariatit dhe në këto biseda nuk ka marrë pjesë ndonjë person tjetër dhe, meqenëse ishte e revoltuar, janë munduar të komunikojnë korrekt me të. Më tej ka sqaruar se bashkë me prokurorin I. Gj. kanë verifikuar dokumentacionin identifikues të shtetases bullgare dhe të makinës. Gjithashtu, konstatohet se në të gjithë përmbajtjen e procesverbalit subjekti i rivlerësimit për të gjitha veprimet e kryera

është shprehur në vetën e tretë shumës, duke sqaruar se veprimet me këtë shtetase janë bërë nga ai dhe prokurori I. Gj..

70. Sa më lart, Komisioni, duke marrë në konsideratë parashikimet e ligjit nr. 84/2016, i cili në nenin 40²⁰⁵ parashikon se vlerësimi i veprimtarisë etike përfshihet brenda objektit të vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe parashikimin e pikës 4²⁰⁶ të nenit 41, që përcakton periudhën e vlerësimit të aftësive profesionale, mund të shtrihet nga data 1.1.2006 e në vazhdim, çmon se konstatimet e mësipërme janë vlerësuar në kuadër të sjelljes së vazhdueshme profesionale, etike që ka shfaqur subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të funksionit të magjistratit.

KONSTATIME TË TJERA

Komisioni, pasi u njoh nëpërmjet mediave elektronike²⁰⁷ lidhur me ankesën e shtetasit B. B. ndaj subjektit Hektor Mushi, administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan²⁰⁸ procedimin penal nr. *** të vitit 2016.

71. Lidhur me procedimin penal nr. * të vitit 2016,** Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: *(i) Veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti në procedimin penal nr. ***/2016 janë të shkëputura në kohë, duke sjellë si pasojë zgjatjen e paarsyeshme të hetimeve paraprake; (ii) Subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për mbledhjen e provave të nevojshme për zbulimin e autorit/autorëve të veprës penale, pasi: (a) nuk rezulton që subjekti të ketë urdhëruar marrjen në pyetje të oficerit të policisë, që ka komunikuar me të dëmtuarin; (b) nuk rezulton që subjekti të ketë urdhëruar verifikimin e alibive të personave të marrë në pyetje, të cilët janë përmendur nga i dëmtuari si autorë të veprës penale; (iii) Subjekti nuk ka kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore pasi: (a) veprimet hetimore janë të shkëputura në kohë; (b) nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për zbulimin e autorit/autorëve të veprës penale; (iv) Takimi i subjektit me të dëmtuarin nga vepra penale në ambientet publike duke diskutuar për çështjen konkrete, duke i thënë se nëse dëshironte mund të bënte vetëgjyqësi, si dhe vënia në dijeni e të dëmtuarit për veprimet procedurale hetimore, nuk janë në përputhje me rregullat e etikës dhe sjelljen e prokurorit.*

72. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit shpjegon se në momentin kur është ngarkuar me drejtimin e hetimeve, kishin kaluar gati 16 muaj nga ndodhja e ngjarjes, gjë që sipas tij e ka bërë shumë të vështirë gjetjen e provave të reja, me qëllim identifikimin e autorëve të veprës penale. Sipas tij, çështja penale konsistonte në të dhëna sipërfaqësore dhe *indicie* jo të verifikuara dhe, për pasojë, arriti në konkluzionin që e vetmja mënyrë e mundshme për të bërë të mundur identifikimin e autorëve, ishte kryesisht nëpërmjet përgjimeve telefonike. Për këtë arsye, vijon subjekti i rivlerësimit, i është kërkuar oficerit të policisë gjyqësore identifikimi i numrave personalë telefonikë celularë të personave të pretenduar nga kallëzuesi, por pas identifikimit përcjellja e tyre nuk ka qenë në formën e kërkuar nga ligji. Sipas tij, të gjitha këto shkaqe kanë sjellë vonesa në lidhje me përfundimin e hetimeve dhe pakënaqësi tek personat e dëmtuar nga vepra penale.

²⁰⁵ Neni 40 parashikon: “Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve...”.

²⁰⁶ Neni 41 parashikon: “4. Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale...”.

²⁰⁷ https://***/2019/05/20/***_skandali-i-prokurorise-3-vjet-asnje-hetim-per-grabitjen-e-13-milione-lekeve/

²⁰⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 26.6.2023.

73. Më pas, shpjegon se për shkak të pakënaqësisë së shprehur në mënyrë të vazhdueshme nga i dëmtuari ka marrë disa herë kontakte dhe takime me të, duke u përpjekur ta sqarojë dhe njëkohësisht ta qetësojë lidhur me ecurinë e hetimit. Për sa i përket shprehjes për përdorimin e vetëgjyqësisë, të shfaqur në emisionin “****”, sqaron se këtë shprehje e ka përdorur në mënyrë ironike, pasi shtetasi B. B. gjatë gjithë takimeve që ka bërë me të, e ka përdorur vazhdimisht se do të kryente vetëgjyqësi nëse prokuroria nuk do të arrestonte personat që ai pretendonte se ishin autorë të ngjarjes.

74. Për sa i përket faktit se ka nxjerrë sekretin hetimor, subjekti i rivlerësimit shpjegon se ky konstatim nuk qëndron, pasi nuk e ka vënë në dijeni për emra personash dhe për numrat telefonikë që do të vihen në përgjim dhe komunikimin në lidhje me çështjen e personit të dëmtuar, nuk e konsideron shkelje etike, për shkak se ai ishte personi i dëmtuar dhe i interesuar për zbardhjen e çështjes.

75. Në përfundim, sqaron se transmetimi në emisionin “****” u bë shkak që të mos realizohen me sukses përgjimet që kishin nisur e ishin në vazhdim, me afat 15-ditor të caktuar nga gjykata dhe se procedimi penal në fjalë ndodhet i pezulluar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan për moszbulim të autorit të veprës penale, vendim i marrë nga një tjetër prokuror pas zëvendësimit të tij.

Analiza e Komisionit

76. Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal rezulton se në datën 12.11.2016, në fshatin ***, Elbasan, është vjedhur banesa e shtetasit B. B., i cili ka pretenduar si i janë vjedhur rreth 900.000 lekë. Nga hetimet e zhvilluara nuk është bërë i mundur identifikimi i autorëve e, për pasojë, prokurorja e çështjes E. S. me vendimin e datës 11.4.2017 ka vendosur pezullimin e hetimeve. Më pas, i dëmtuari ka gjetur një letër anonime në banesën e tij, në të cilën autori i paidentifikuar ka deklaruar se ka parë komshiun e B. me triko e kapuç, çizme dhe çekiç në dorë nga dritat e një makine. Gjithashtu, i dëmtuari në datën 23.1.2018 ka deklaruar para policisë gjyqësore se nga biseda që ka pasur me punonjës in e policisë së zonës dhe duke mbledhur informacion nga shokë e miq, ka arritur në konkluzionin se autorë të vjedhjes janë disa shtetas, të cilët ai i ka identifikuar duke dhënë edhe emrat përkatës.

77. Me vendimin e datës 16.2.2018, prokurorja E. S. ka vendosur rifillimin e hetimeve. Me kërkesë të të dëmtuarit, drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur zëvendësimin e prokurores së çështjes me prokurorin Hektor Mushi. Pas rifillimit të hetimeve janë marrë në pyetje disa shtetas, si dhe është marrë informacion nga kompanitë telefonike lidhur me numrat e disa personave të dyshuar. Me kërkesë të oficerit të policisë gjyqësore, subjekti i rivlerësimit ka proceduar me lejimin e përgjimit të bisedave dhe ka kërkuar nga gjykata vleftësimin e vendimit të përgjimit telefonik. Gjkata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin e datës 16.5.2019 ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit. Nga dëgjimi dhe transkriptimi i bisedave nuk ka rezultuar ndonjë bisedë me interes për hetimin.

78. Në datën 20.5.2019, emisioni investigativ satirik “****” në televizionin “****” ka transmetuar një regjistrim bisede të bërë nga shtetasi B. B. me oficerin e policisë gjyqësore S. Sh. dhe prokurorin Hektor Mushi. Gjatë regjistrimit të bisedës rezulton se prokurori Hektor Mushi ka marrë kontakt me të dëmtuarin, shtetasin B. B., jashtë ambienteve të Prokurorisë dhe gjatë bisedës me të, në përgjigje të pohimit të qytetarit se “*Dua me i dalë në fund se s’bën kësaj pune*”, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur “*Po gjeje more burrë, po deshe bëje dhe me*

vetëgjyqësi”. Më pas ka vijuar biseda dhe e ka sqaruar qytetarin se “Janë marrë ato numrat... do vihen në përgjim. Javën që vjen do bëhet kërkesa në gjykatë”, si dhe është shprehur se “...ndihem fajtor në një farë mënyre, sepse duhej të isha marrë më shumë me këtë punë”. Pas transmetimit të regjistrimit të mësipërm, drejtuesi i Prokurorisë me vendimin e datës 22.5.2019 ka vendosur zëvendësimin e prokurorit Hektor Mushi nga ushtrimi i mëtejshëm i ndjekjes penale, në kuadër të procedimit penal nr. *** të vitit 2016, si dhe zëvendësimin e oficerit të policisë gjyqësore nga kryerja e veprimeve të mëtejshme hetimore, duke pasqyruar edhe mangësitë e konstatuara në kryerjen e hetimeve paraprake nga subjekti i rivlerësimit²⁰⁹.

79. Referuar rrethanave të mësipërme, Komisioni vëren se: *Së pari*, nga analizimi i veprimeve hetimore konstatohet se: (i) i dëmtuari ka deklaruar se nga biseda që ka pasur me punonjësën e policisë së zonës, ka arritur në konkluzionin se autorë të vjedhjes janë disa shtetas, të cilët ai i ka identifikuar duke dhënë edhe emrat përkatës. Nuk rezulton që subjekti të ketë urdhëruar marrjen në pyetje të oficerit të policisë; (ii) personat e përmendur nga i dëmtuari si autorë të veprës penale janë marrë në pyetje nga oficeri i policisë gjyqësore gjatë kohës që procedimi ndiqej nga prokurori i mëparshëm dhe, në vijim të ndjekjes logjike të hetimit, nuk rezulton që subjekti të ketë urdhëruar verifikimin e alibive të tyre. Lidhur me këto konstatime, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shpjegime. Në këto kushte, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për mbledhjen e provave të nevojshme për zbulimin e autorit/autorëve të veprës penale, duke shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kritere të përcaktuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

80. *Së dyti*, vërehet se subjekti i rivlerësimit është caktuar në ndjekjen e çështjes në datën 23.2.2018 dhe në datën 20.3.2018 ka nxjerrë urdhrin për delegimin e veprimeve hetimore oficerit të policisë gjyqësore, duke i përcaktuar edhe veprimet hetimore²¹⁰. Në datën 26.4.2018 është marrë në pyetje shtetasi B. P. dhe në datën 28.12.2018 është marrë në pyetje shtetasi A. Gj.. Gjithashtu, rezulton se oficeri i policisë gjyqësore ka kërkuar informacion nga kompanitë e telefonisë lidhur me përdoruesit e numrave telefonikë në datën 21.9.2018 dhe përgjigjet e tyre janë protokolluar në datat 5.10.2018 dhe 22.11.2018. Në vijim, oficeri i policisë gjyqësore ka paraqitur kërkesë për lejimin e përgjimit telefonik në datën 17.12.2018, si dhe e ka përsëritur kërkesën në datën 5.2.2019. Subjekti me vendimin e datës 14.5.2019 ka vendosur lejimin e përgjimit telefonik e, më pas, në datën 15.5.2019 ka paraqitur në gjykatë kërkesën për vleftësim të ligjshëm të vendimit, duke sjellë si pasojë vonesë në kryerjen e këtij veprimi procedural. Sa më sipër, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore, pasi veprimet hetimore për zbulimin e autorit/autorëve të veprës penale

²⁰⁹ “...nga ana e prokurorit Hektor Mushi, megjithëse është përpiluar urdhri për kryerjen e veprimeve hetimore që në datën 20.5.2018, rezulton se veprimet hetimore janë kryer të shkëputura në kohë, duke i sjellë hetimit moskonsistencë. Vlerësohet se nga të dhënat e administruara deri më tani nuk ka një linjë të qartë të planit hetimor. Në datën 20.5.2019, emisioni investigativ satirik “***” ka transmetuar një regjistrim bisede të bërë nga shtetasi B. B., ndërmjet të tjerëve edhe me oficerin e policisë gjyqësore S. Sh.dhe me prokurorin Hektor Mushi. Gjatë regjistrimit të bisedës rezulton se prokurori Hektor Mushi ka marrë kontakt me të dëmtuarin, shtetasin B. B., jashtë ambienteve të Prokurorisë dhe ka konsumuar me të... detaje mbi veprimet hetimore që mendon se do të kryejë... Gjendur në këto kushte, vlerësohet se gjendemi para rastit të ekzistencës së arsyeve serioze që lidhen me detyrën, si në rastin e oficerit të policisë gjyqësore dhe të prokurorit Hektor Mushi... Për më tepër, rezulton se hetimet janë të zgjatura në kohë, pa shkaqe të justifikuar...”

²¹⁰ Thirrjen dhe pyetjen e shtetasit A. Gj.; identifikimin e numrave telefonikë të shtetasve B. P., A. P., G. L., D. H. dhe E. Gj.; pyetjen e personave të përmendur nga kallëzuesi dhe verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit në lidhje me ta; si dhe të bëhet ballafaqimi i të dëmtuarit me shtetasin B. P..

janë të shkëputura në kohë, duke shfaqur mangësi në aspektin e aftësive organizative, kriter që parashikohet nga neni 74 i ligjit nr. 96/2016.

81. *Së treti*, rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve²¹¹, që ka qenë në fuqi në kohën kur është bërë regjistrimi nga emisioni televiziv, parashikonin se prokurorët duhet të ruajnë sekretin e hetimeve, duke mos u dhënë të tjerëve informacion lidhur me hetimin. Në vijim, lidhur me marrëdhëniet e tyre me subjektet e procedimit penal, ku përfshihet edhe i dëmtuari, parashikohej se duhet shmangur dhënia e mendimeve personale ose deklaratave lidhur me mënyrën e përfundimit të çështjes. Gjithashtu, referuar edhe parimeve të Bangalores për sjelljen e gjyqtarëve, parashikohet se sjellja e gjyqtarit duhet të ripohojë besimin e qytetarëve në integritetin e gjyqësorit. Bazuar në këto parashikime, duket se takimi i subjektit të rivlerësimit me të dëmtuarin e veprës penale në ambientet publike, duke diskutuar për çështjen konkrete, duke i thënë se nëse dëshironte mund të bënte vetëgjyqësi, si dhe vënia në dijeni e të dëmtuarit për veprimet procedurale hetimore në vijim, nuk janë në përputhje me rregullat e etikës dhe sjelljen e prokurorit.

82. Për sa i përket shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit se nuk i ka përmendur emrat e personave të cilëve do u bëhet përgjimi telefonik, Komisioni arsyeton se fakti që ai i ka bërë me dije të dëmtuarit për veprimin e ardhshëm procedural dhe kjo bisedë është transmetuar në televizion, sikurse shpjegon edhe vetë, është bërë shkak që të mos realizohen me sukses përgjimet që kishin filluar, pasi prezumohet që autorët e veprës penale mund të jenë treguar më të kujdesshëm gjatë bisedimeve telefonike apo ambientale.

83. Sa më lart, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e etikës së magjistratit në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, kriter të parashikuara nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016.

84. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e: (i) njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kriter të përcaktuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) aftësive organizative, kriter që parashikohet nga neni 74 i ligjit nr. 96/2016; (iii) etikës së magjistratit në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, kriter të parashikuara nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016.

Përfundimet e Komisionit në lidhje me rivlerësimin e aftësive profesionale

85. Në përfundim të rivlerësimit të aftësive profesionale, duke marrë në konsideratë dyshimet e arsyeshme të ngritura në çështjet penale të trajtuara si pasojë e informacioneve të organeve ndihmëse, për favorizim të të dyshuarit/personit nën hetim²¹², shkeljet e përsëritura në mënyrë të vazhdueshme për sa i përket njohurive ligjore në praktikën e regjistruara për kryerjen e veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuara nga neni 290 i Kodit Penal²¹³; mangësitë e konstatuara në praktikën e tjera, si dhe shkeljet e përsëritura në aspektin e etikës së magjistratit²¹⁴, trupi gjyqësor, në përputhje me interpretimin pajtues të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese²¹⁵, në vlerësimin tërësor të fakteve dhe rrethanave, vlerëson se shkeljet e

²¹¹ Të miratuar me urdhrin nr. ***, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm.

²¹² Procedimet penale nr. *** të vitit 2022 dhe nr. *** të vitit 2022.

²¹³ Procedimet penale nr. ***, datë 29.7.2007, nr. ***, viti 2022 dhe nr. ***, viti 2022.

²¹⁴ Procedimi penal nr. ***, viti 2022; denoncimi nr. *** prot., datë 27.11.2021; procedimi penal nr. ***, viti 2016.

²¹⁵ “54. Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ

konstatuara përfshihen në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe këto mangësi nuk përfshihen në kategorinë e atyre që plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, por janë shkelje që kanë cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë e, për pasojë, arrin në konkluzionin për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijimin e funksionit të tij.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit Hektor Mushi gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, të cilat, të vlerësuara së bashku, të çojnë në konkluzionin se duhet zbatuar neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke e vënë në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, si një shkak ligjor për zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit (i) ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar duke u gjendur në kushtet e pikës 3, të nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “ç”, të pikës 4, të nenit 38, të ligjit nr.84/2016; (ii) nuk ka plotësuar saktësisht, plotësisht dhe me vërtetësi formularin për kontrollin e figurës dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, pasi nuk ka deklaruar kontaktin e papërshtatshëm që është konstatuar nga prova të besueshme, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “a” të pikës 6 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016 dhe në kushtet e nenit DH, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se problematikat e konstatuara në kriterin e figurës të ndërthurura me mangësitë profesionale janë të tilla që kanë cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë e, për pasojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si një shkak ligjor për zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe në bindjen e brendshme, vendosi që subjekti i rivlerësimit Hektor Mushi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shkarkohet nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 58, si dhe në pikat 2, 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Hektor Mushi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)”.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 15.12.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ

Kryesues

Etleđa ÇIFTJA

Relatore

Brunilda BEKTESHI

Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj